

DORACAK MBI MBROJTJEN E PERSONAVE PA SHTETËSI

**SIPAS KONVENTËS SË VITIT 1954 LIDHUR ME
STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI
GJENEVË, 2014**

DORACAK MBI MBROJTJEN E PERSONAVE PA SHTETËSI

**SIPAS KONVENTËS SË VITIT 1954 LIDHUR ME
STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI
GJENEVË, 2014**

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	1
HYRJE.....	2
A. HISTORIKU I KONVENTËS SË VITIT 1954.....	3
B. UNHCR-ja DHE PASHTETËSIA	4
C. FUSHËVEPRIMI I DORACAKUT	4
D. PASHTETËSIA DHE PASHTETËSIA <i>DE FACTO</i>.....	5
E. PËRCAKTIMI SE KUSH ËSHTË PA SHTETËSI.....	6
F. STATUSI I PASHTETËSISË	7
PJESA E PARË: KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E PASHTETËSISË	9
A. PËRKUFIZIMI	9
B. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME	10
C. INTERPRETIMI I TERMAVE	11
(1) “nga asnjë shtet”	11
(a) Cilat shtete duhet të shqyrtohen?.....	11
(b) Çfarë është një "shtet"?	11
(2) “nuk konsiderohet si shtetas ... sipas veprimit të ligjit të tij”	12
(a) Kuptimi i “ligji”	12
(b) Kur një person "nuk konsiderohet si shtetas" sipas ligjit dhe praktikës së një shteti?	12
(i) Mënyrat automatike dhe joautomatike të fitimit ose heqjes së shtetësisë	13
(ii) Identifikimi i autoriteteve kompetente	13
(iii) Vlerësimi i provave të autoriteteve kompetente në mënyrat jo automatike të fitimit dhe heqjes së shtetësisë	14
(iv) Vlerësimi i provave të autoriteteve kompetente në mënyrat automatike të fitimit të nënshtetësisë ose humbjes së shtetësisë	15
(v) Konsideratat ku praktika shtetërore bie ndesh me mënyrat automatike të fitimit të shtetësisë	16
(vi) Vlerësimi i shtetësisë në mungesë të provave për pozicionin e autoriteteve kompetente	16

(vii) Roli i autoriteteve konsullore	17
(viii) Kërkesat për informacion nga autoritetet kompetente.....	17
(ix) Trajtimi jo konsistent nga autoritetet kompetente	18
(x) Shtetësia e fituar me gabim ose keqbesim.....	18
(xi) Ndikimi i procedurave të ankimimit/shqyrtimit	19
(xii) Çështjet e përkohshme	20
(xiii) Heqja dorë vullnetare nga shtetësia	21
(xiv) Koncepti i shtetësisë	21

PJESA E DYTË: PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E PASHTETËSISË..... 25

A. TË PËRGJITHSHME 25

(1) Pasqyrë e përgjithshme	25
(2) Përcaktimi i pashtetësisë dhe i së drejtës për një shtetësi	25

B. VENDOSJA E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIM..... 27

(1) Hartimi dhe vendndodhja e procedurave të përcaktimit	27
(2) Qasja në procedurat	28
(3) Garancitë procedurale	28

C. KOORDINIMI I PËRCAKTIMEVE TË STATUSIT TË REFUGJATIT DHE TË PASHTETËSISË..... 31

D. VLERËSIMI I PROVAVE..... 32

(1) Llojet e provave	32
(2) Çështjet e provës	34
(3) Barra e provës	34
(4) Standardi i provës.....	34
(5) Peshimi i provave.....	35
(6) Pasaportat	36
(7) Kërkesat për informacion dhe përgjigjet nga autoritetet e huaja	36
(8) Intervistat	37
(9) Çështjet e besueshmërisë	37

E. KONSIDERATAT SHITESË PROCEDURALE 39

(1) Përcaktimi grupor	39
(2) Ndalimi	40
(3) Roli i UNHCR-së	42
(4) Eksplorimi i zgjidhjeve jashtë vendit.....	42

(5) Masat mbrojtëse shtesë procedurale dhe provash për grupe të veçanta	42
F. PËRCAKTIMI I PASHTETËSISË KU NUK ZBATOHET	
KONVENTA E VITIT 1954.....	44
PJESA E TRETË: STATUSI I PERSONAVE PA SHTETËSI	
NË NIVEL KOMBËTAR.....	45
A. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE STATUSI I PERSONAVE PA SHTETËSI	45
(1) Paralelet midis statusit të refugjatëve dhe personave pa shtetësi	45
(2) Pasqyrë e standardit të trajtimit të kërkuar nga Konventa e 1954-ës.....	46
(a) Të drejtat në një shkallë graduale, të kushtëzuar	47
(3) E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut	50
B. INDIVIDËT NË NJË KONTEKST MIGRATOR.....	52
(1) Individët që presin përcaktimin e pashtetësisë	52
(2) Individët e përcaktuar si pa shtetësi – e drejta e qëndrimit.....	52
(3) Kur mbrojtja është e disponueshme në një shtet tjetër.....	54
(a) Kur pashtetësia rezulton nga humbja/privimi ose heqja dorë vullnetare nga shtetësia me mirëbesim	55
(b) Kur pashtetësia rezulton nga heqja dorë vullnetare nga shtetësia si një çështje lehtësie ose zgjedhje	56
(c) Konsiderimi i lidhjeve lokale.....	57
C. INDIVIDËT NË “VENDIN E VET”	57
D. STATUSI PËR PERSONAT PA SHTETËSI QË NUK MBULOHEN	
NGA KONVENTA E VITIT 1954	58
SHTOJCA I – KONVENTA E VITIT 1954 LIDHUR	
ME STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI*	61
SHTOJCA II - 1961 KONVENTA MBI REDUKTIMIN E PASHTETËSISË *	77
SHTOJCA III - LISTA E SHTETEVE PALË TË KONVENTËS SË VITIT 1954	
LIDHUR ME STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI DHE TË KONVENTËS	
SË VITIT 1961 MBI REDUKTIMIN E PASHTETËSISË	85
SHTOJCA IV - FRAGMENTE NGA REZOLUTAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME	88
SHTOJCA V - FRAGMENTE NGA KONKLuzionet E KOMITETIT EKZEKUTIV	
TË UNHCR-së	90
INDEKSI	94

PARATHËNIE

Në dekadën e fundit ka pasur një shtysë të përtërirë nga ana e komunitetit ndërkombëtar, e mbështetur nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), për të trajtuar gjendjen e vështirë të personave pa shtetësi. Siç e bën të qartë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, çdokush ka të drejtën për një shtetësi. Pa shtetësi, individët përballen me një ekzistencë të karakterizuar nga pasiguria dhe marginalizimi. Personat pa shtetësi janë ndër më të cenueshmit në botë, të cilëve shpesh u mohohet gëzimi i të drejtave të tilla si barazia para ligjit, e drejta për punë, arsimim apo kujdes shëndetësor. Megjithë veprimet e shumë shteteve për të parandaluar ose zvogëluar pashtetësinë përmes masave të tilla si reforma e ligjeve të tyre të shtetësisë, raste të reja të pashtetësisë vazhdojnë të shfaqen. Personat pa shtetësi mund të gjenden pothuajse në çdo vend. Në të vërtetë, disa familje kanë qenë pa shtetësi për breza të tërë.

Konventa e vitit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi qëndron në bërthamën e regjimit ndërkombëtar për mbrojtjen e personave pa shtetësi. Ajo përcakton përkufizimin universal të "personit pa shtetësi" dhe ofron një grup thelbësor parimesh për trajtimin e tyre. Korniza e Konventës është po aq e rëndësishme sot sa ishte në kohën e miratimit të traktatit dhe është plotësuar nga zhvillimet në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndërsa Konventa e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë ofron një grup gjithëpërfshirës të mjeteve për çrrënjosjen e pashtetësisë, Konventa e vitit 1954 siguron që ata që janë pa shtetësi nuk duhet t'i nënshtrohen një jete pa dinjitet dhe siguri. Në vitin e 60-vjetorit të Konventës, UNHCR-ja ka kënaqësinë të nxjerrë këtë Doracak.

Në kohën e publikimit, 80 shtete janë palë në Konventën e vitit 1954, me aderime të shumta në tre vitet e fundit të nxitura nga Fushata e UNHCR-së për pashtetësinë. Rritja e fokusit në pashtetësinë mund të shihet gjithashtu në rritjen e numrit të vendeve që vendosin procedura për përcaktimin e pashtetësisë.

Ndonëse procedura të tilla mund të jenë të përshtatshme vetëm për pakicën e personave pa shtetësi në botë që janë në një situatë migrimi, ato janë megjithatë kritike, duke ofruar një rrugë drejt një statusi në përputhje me standardet si të Konventës së 1954-ës, ashtu edhe me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Një qasje e ndryshme kërkohet në rastin e personave pa shtetësi që ndodhen në vetë vendin e tyre, duke njohur lidhjen e tyre të thellë me atë shtet, për shembull, në bazë të lindjes ose banimit afatgjatë. Shtetet janë gjithnjë e më të vetëdijshme për përfitimet, jo vetëm për individët në fjalë, por për stabilitetin dhe kohezivitetin e shoqërive të tyre në përgjithësi, nga ndërmarrja e reformave të ligjit dhe politikave për t'u dhënë shtetësinë këtyre personave.

UNHCR-ja nxjerrë këtë doracak në përputhje me përgjegjësitë e mandatit të tij për të trajtuar pashtetësinë. Këto përgjegjësi fillimisht ishin të kufizuara në personat pa shtetësi që ishin refugjatë siç përcaktohet në paragrafin 6 (A) (II) të Statutit të UNHCR-së dhe nenin 1 (A) (2) të Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve. Ky mandat që atëherë është zgjeruar

me një sërë rezolutash të Asamblesë së Përgjithshme, në veçanti Rezolutat 50/152 të vitit 1995 dhe 61/137 të vitit 2006, duke i besuar UNHCR-së përgjegjësinë për personat pa shtetësi në përgjithësi. Përgjegjësitë e UNHCR-së shtrihen në identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi.

Përmbajtja e këtij Doracaku u publikua për herë të parë në vitin 2012 në formën e tre Udhëzuesve të UNHCR-së, që kanë të bëjnë me përkufizimin e personit pa shtetësi, përkatësisht procedurat për përcaktimin e pashtetësisë dhe statusin e personave pa shtetësi sipas të drejtës kombëtare.* Duke zëvendësuar këta Udhëzues, teksti i Doracakut përsërit përmbajtjen e tyre, ku janë bërë vetëm ndryshime minimale, kryesisht për të adresuar duplikimin dhe për të përditësuar referencat ndaj publikimeve të UNHCR-së. Boshllëqet e vogla të identifikuar që nga publikimi i Udhëzuesve janë adresuar gjithashtu. Ky Doracak, ashtu si Udhëzuesit, rezulton nga një sërë konsultimesh ekspertësh të kryera në kontekstin e 50-vjetorit të Konventës së vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë.[†] Ai nuk merr parasysh parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë; këto trajtohen në vend të kësaj në udhëzues të veçantë.

Ky Doracak synon të udhëzojë zyrtarët qeveritarë, gjyqtarët dhe profesionistët, si dhe stafin e UNHCR-së dhe të tjerë të përfshirë në trajtimin e pashtetësisë. Shpresohet që Doracaku do të ofrojë një burim të vlefshëm si për përcaktimin e pashtetësisë ashtu edhe për zhvillimin dhe zbatimin e ligjit dhe politikave në lidhje me mbrojtjen e personave pa shtetësi.

Volker Türk

Drejtor

Divizioni i Mbrojtjes Ndërkombëtare

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët Gjenevë, qershor 2014

* Ju lutemi shihni UNHCR, *Udhëzues mbi Pashtetësinë nr. 1: Përkufizimi i "Personit pa shtetësi"* në Nenin 1(1) të Konventës së vitit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 20 shkurt 2012, HCR/GS/12/01, <http://www.refworld.org/docid/4f4371b82.html>; UNHCR, *Udhëzues mbi Pashtetësinë nr. 2: Procedurat për përcaktimin nëse një individ është person pa shtetësi*, 5 prill 2012, HCR/GS/12/02, <http://www.refworld.org/docid/4f7dafb52.html>; dhe UNHCR, *Udhëzues mbi Pashtetësinë nr. 3: Statusi i personave pa shtetësi në nivel kombëtar*, 17 korrik 2012, HCR/GS/12/03, <http://www.refworld.org/docid/5005520f2.html>

† Ju lutemi shihni UNHCR, *Takimi i Ekspertëve - Koncepti i personave pa shtetësi sipas të drejtës ndërkombëtare ("Konkluzionet e Prato")*, maj 2010, <http://www.refworld.org/docid/4ca1ae002.html>; dhe UNHCR, *Takimi i ekspertëve - Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë dhe statusi i personave pa shtetësi ("Konkluzionet e Gjenevës")*, dhjetor 2010, <http://www.refworld.org/docid/4d9022762.html>

A. HISTORIKU I KONVENTËS SË VITIT 1954

1. Pashtetësia lind në një sërë kontekstesh. Ndodh në situata migrimi, për shembull, në mesin e disa emigrantëve që humbasin ose privohen nga shtetësia e tyre pa e fituar shtetësinë e një vendi të banimit të zakonshëm. Megjithatë, shumica e personave pa shtetësi nuk i kanë kaluar kurrë kufijtë dhe janë në “vendin e vet”.¹ Gjendja e tyre e vështirë ekziston in situ, pra në vendin e banimit afatgjatë, në shumë raste në vendin e lindjes. Për këta individë, pashtetësia është shpesh rezultat i problemeve në hartimin dhe zbatimin e ligjeve mbi shtetësinë.
2. Pas Luftës së Dytë Botërore doli në pah nevoja për veprim ndërkombëtar për mbrojtjen e personave pa shtetësi dhe refugjatëve. Në këtë mënyrë, Konventa e vitit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi (“Konventa e 1954-ës”) ka të njëjtën prejardhje sikurse Konventa e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve (“Konventa e 1951-ës”). Ajo fillimisht u konceptua si një projekt-protokoll i traktatit të refugjatëve. Megjithatë, kur u miratua Konventa e vitit 1951, protokollu i la në formë drafti dhe iu referua një konference të veçantë negociuese ku u shndërrua në një traktat mëvete në lidhje me personat pa shtetësi. Teksti i Konventës së vitit 1954 dhe lista e shteteve palë mund të gjenden në Shtojcën I, përkatësisht III.
3. Konventa e vitit 1954 mbetet i vetmi traktat ndërkombëtar që synon në mënyrë specifike rregullimin e standardeve të trajtimit për personat pa shtetësi.² Prandaj, Konventa ka një rëndësi kritike në garantimin e mbrojtjes së këtij grupi të cënueshëm.

¹ Shprehja “vendin e vet” është marrë nga neni 12(4) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe përdoret në përputhje me interpretimin e tij nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

² Konventa e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë ka të bëjë me shmangien e pashtetësisë kryesisht nëpërmjet masave mbrojtëse në ligjet e shtetësisë, duke reduktuar kështu fenomenin me kalimin e kohës. Protokollu special i vitit 1930 në lidhje me pashtetësinë, i cili hyri në fuqi në vitin 2004, nuk adreson standardet e trajtimit, por ka të bëjë me detyrimet specifike të shtetit të mëparshëm të shtetësisë. Ky Protokoll ka shumë pak shtete palë.

B. UNHCR-ja DHE PASHTETËSIA

4. UNHCR-ja publikon këtë Doracak në përputhje me përgjegjësitë e mandatit të saj për të trajtuar pashtetësinë. Përgjegjësitë e UNHCR-së fillimisht ishin të kufizuara në personat pa shtetësi që ishin refugjatë, siç përcaktohet në paragrafin 6 (A) (II) të Statutit të UNHCR-së dhe nenin 1 (A) (2) të Konventës së vitit 1951. Në këtë cilësi, UNHCR-ja u përfshi në hartimin e Konventës së vitit 1954. Për të ndërmarrë funksionet e parashikuara nga nenet 11 dhe 20 të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë ("Konventa e vitit 1961") mandati i UNHCR-së u zgjerua për të mbuluar personat që binin nën termat e asaj Konvente me Rezolutat 3274 (XXIX) të Asamblesë së Përgjithshme dhe të vitit 1974 dhe 31/36 të vitit 1976. Zyrës iu besuan përgjegjësitë për personat pa shtetësi në përgjithësi me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 50/152 të vitit 1995, e cila miratoi Konkluzionin 78 të Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së. Më pas, në Rezolutën 61/137 të vitit 2006, Asambleja e Përgjithshme miratoi konkluzionin 106 të Komitetit Ekzekutiv, i cili përcakton katër fusha të gjera të përgjegjësisë për UNHCR-në: identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi. Ekstrakte nga rezolutat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme dhe Konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv gjenden në Shtojcën IV, përkatësisht V.

C. FUSHËVEPRIMI I DORACAKUT

5. Dispozitat e Konventës së vitit 1954 ndahen në tre kategori: ato që vendosin përkufizimin e "personit pa shtetësi"; ato që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e tyre; dhe dispozitat përfundimtare që rregullojnë çështje të tilla si aderimi në Konventë dhe bashkëpunimi i shteteve palë me UNHCR-në. Ky doracak jep udhëzime për dispozitat që i përkasin dy të parave të këtyre kategorive.
6. Ky doracak synon të ndihmojë qeveritë, politikëbërësit, gjyqtarët administrativë, gjyqësorin, OJQ-të, profesionistët ligjorë, stafin e UNHCR-së dhe aktorë të tjerë në interpretimin dhe zbatimin e Konventës së 1954-ës në mënyrë që të lehtësohet identifikimi dhe trajtimi i duhur i përfituesve të saj. Për më tepër, ky doracak do të jetë i rëndësishëm në një sërë rrethanash të tjera, si për shembull interpretimi i instrumenteve të tjera ndërkombëtare që u referohen, por nuk përkufizojnë, "personat pa shtetësi", "pashtetësisë" ose termat e lidhur. Në këtë aspekt, vihet re se Konventa e vitit 1954 nuk ka tërhequr ende të njëjtin nivel ratifikimesh/aderimesh si Konventa e vitit 1951 dhe traktatet e tjera të të drejtave të njeriut. Prandaj, ekziston një praktikë e kufizuar shtetërore, duke përfshirë jurisprudencën e gjykatave kombëtare, për zbatimin e Konventës së 1954-ës, veçanërisht në lidhje me interpretimin e nenit 1(1). Megjithatë, udhëzimi në këtë doracak merr në konsideratë praktikën ekzistuese të shteteve palë në Konventën e 1954-ës dhe rezulton nga një sërë konsultimesh ekspertësh të mbajtura nga UNHCR-ja.

D. PASHTETËSIA DHE PASHTETËSIA *DE FACTO*

7. Konventa e vitit 1954 vendos përkufizimin universal të "personit pa shtetësi" në nenin 1(1) të saj. Personat që përfshihen brenda fushës së nenit 1(1) quhen nganjëherë si persona pa shtetësi "*de jure*" edhe pse ky term nuk përdoret në vetë Konventën. Për dallim nga kjo, në Aktin Final të Konventës së vitit 1961 iu referohet personave pa shtetësi "*de facto*" dhe ka një referencë të nënkuptuar në Aktin Final të Konventës së vitit 1954.³ Ndryshe nga termi "person pa shtetësi" siç përcaktohet në nenin 1(1), termi "pa shtetësi *de facto*" nuk është përcaktuar në asnjë instrument ndërkombëtar dhe nuk ka asnjë regjim traktati specifik për këtë kategori personash (referenca në Aktin Final të Konventës së vitit 1961 është e kufizuar dhe jo detyruese nga natyra).⁴ Duhet pasur kujdes që ata që kualifikohen si "persona pa shtetësi" sipas nenit 1(1) të Konventës së 1954-ës, të njihen si të tillë dhe të mos referohen gabimisht si "persona pa shtetësi *de facto*", pasi përndryshe ata mund të dështojnë të marrin mbrojtjen e garantuar sipas Konventës së 1954-ës. Ky doracak trajton një sërë çështjesh në lidhje me identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi siç përcaktohet në nenin 1(1) të Konventës, megjithatë shmang kualifikimin e tyre si "persona pa shtetësi *de jure*" pasi ky term nuk shfaqet askund në vetë traktatin.

³ Paragrafi 3 i Aktit Final të Konventës së vitit 1954 u hartua posaçërisht për të trajtuar pozicionin e pashtetësisë *de facto*. Ky rekomandim kërkon që përfitimet e Konventës të shtrihen tek individët të cilët shtetet i konsiderojnë se kanë pasur arsye të vlefshme për të hequr dorë nga mbrojtja e shtetit të tyre të shtetësisë. Sa i përket Aktit Final të Konventës së vitit 1961, ndonëse nuk përkufizon "pashtetësinë *de facto*", ajo paraqet një rekomandim që personat e tillë të përfitojnë nga dispozitat e Konventës së vitit 1961 në mënyrë që të marrin një "shtetësi efektive".

⁴ Për "pashtetësinë *de facto*", ju lutemi shihni, për shembull, Seksionin II.A. i UNHCR-së, *Takimi i Ekspertëve - Koncepti i Personave pa Shtetësi sipas të Drejtës Ndërkombëtare ("Konkluzionet e Prato")*, maj 2010, <http://www.refworld.org/docid/4ca1ae002.html> : (1) "Pashtetësia *de facto*" ka qenë tradicionalisht e lidhur me nocionin e shtetësisë efektive dhe disa pjesëmarrës ishin të mendimit se shtetësia e një personi mund të ishte joefektive brenda si dhe jashtë vendit të tij ose të saj të shtetësisë. Rrjedhimisht, një person mund të jetë "pa shtetësi *de facto*" edhe nëse ndodhet brenda vendit të tij/saj të shtetësisë. Megjithatë, pati mbështetje të gjerë nga pjesëmarrësit e tjerë për qasjen e përcaktuar në dokumentin e diskutimeve të përgatitur për takimin, i cili përcakton një "person pa shtetësi *de facto*" në bazë të njërit nga funksionet kryesore të shtetësisë në të drejtën ndërkombëtare, pra sigurimin e mbrojtjes nga një shtet për shtetasit e tij jashtë vendit. (2) Përkufizimi është si vijon: "personat pa shtetësi *de facto*" janë persona jashtë shtetit të shtetësisë së tyre, të cilët nuk janë në gjendje ose, për arsye të vlefshme, nuk janë të gatshëm të përfitojnë nga mbrojtja e atij shteti.

Mbrojtja në këtë kuptim i referohet të drejtës së mbrojtjes diplomatike të ushtruar nga një shtet i shtetësisë me qëllim korrigjimin e një akti të padrejtë ndërkombëtarisht kundër një shtetasi të tij, si dhe mbrojtjes dhe ndihmës diplomatike dhe konsullore në përgjithësi, duke përfshirë në lidhje me kthimin në shtetin e shtetësisë.

E. PËRCAKTIMI SE KUSH ËSHTË PA SHTETËSI

8. Ndërsa Konventa e vitit 1954 përcakton përkufizimin ligjor ndërkombëtar të "personit pa shtetësi" dhe standardet e trajtimit për të cilat këta individë kanë të drejtë, ajo nuk parashikon asnjë mekanizëm për të identifikuar personat pa shtetësi si të tillë. Megjithatë, Konventa e vitit 1954 lë të nënkuptohet që shtetet duhet të identifikojnë personat pa shtetësi brenda juridiksioneve të tyre në mënyrë që t'u ofrojnë atyre trajtimin e duhur në mënyrë që të përmbushin angazhimet e tyre të Konventës.⁵ Ky doracak këshillon mbi modalitetet e krijimit të procedurave të përcaktimit të pashtetësisë, duke përfshirë çështjet e provave që lindin në mekanizma të tillë. Duke vepruar kështu, doracaku trajton procedurat që synojnë në mënyrë specifike, nëse jo ekskluzivisht, përcaktimin nëse një individ është pa shtetësi. Për më tepër, fokusi është në njohjen e personave pa shtetësi siç përcaktohet në Konventën e 1954-ës dhe në detyrimet e shteteve që janë palë në këtë Konventë. Disa konsiderata i kushtohen shteteve që nuk janë të detyruara nga ky traktat dhe identifikimit të personave pa shtetësi *de facto*.
9. Vetëm një numër relativisht i vogël vendesh kanë vendosur procedura për përcaktimin e pashtetësisë, ku jo të gjitha janë shumë të rregulluara. Ka një interes në rritje për futjen e mekanizmave të tillë. Pashtetësia është një fakt juridikisht i rëndësishëm sipas ligjit ndërkombëtar. Kështu, njohja e pashtetësisë luan një rol të rëndësishëm në rritjen e respektit për të drejtat e njeriut të personave pa shtetësi, veçanërisht përmes qasjes në një status të sigurt ligjor dhe gëzimit të të drejtave që u jepen personave pa shtetësi sipas Konventës së vitit 1954.
10. Është gjithashtu në interesin e shteteve të vendosin procedura për përcaktimin e pashtetësisë. Një veprim i tillë rrit aftësinë e shteteve për të respektuar detyrimet e tyre sipas Konventës së 1954-ës. Në vendet ku pashtetësia lind midis lëvizjeve të përziera migratore, procedurat e përcaktimit të pashtetësisë ndihmojnë gjithashtu qeveritë të vlerësojnë madhësinë dhe profilin e popullatave pa shtetësi në territorin e tyre dhe në këtë mënyrë të përcaktojnë shërbimet e nevojshme qeveritare. Përveç kësaj, identifikimi i pashtetësisë mund të ndihmojë në parandalimin e pashtetësisë duke zbuluar shkaqet rrënjësore dhe trendet e reja të pashtetësisë.

5 Shtetet e kanë njohur këtë në lidhje me vendosjen e procedurave të përcaktimit të statusit të refugjatit, pavarësisht se Konventa e vitit 1951 është e heshtur për këtë çështje. Ju lutemi shihni Konkluzionin e Komitetit Ekzekutiv nr. 8 (XXVIII) të vitit 1977, paragrafi a; Konkluzioni i Komitetit Ekzekutiv nr. 11 (XXIX) i vitit 1978, paragrafi h; Konkluzioni i Komitetit Ekzekutiv nr.14 (XXX) i vitit 1979, paragrafi f; dhe Konkluzioni i Komitetit Ekzekutiv nr. 16 (XXXI) i vitit 1980, paragrafi h. Ju lutemi shihni UNHCR, *Konkluzionet e Miratuara nga Komiteti Ekzekutiv mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare të Refugjatëve, 1975-2009 (Konkluzioni nr.1 – 109)*, 2009, <http://www.refworld.org/docid/4b28bf1f2.html>.

F. STATUSI I PASHTETËSISË

11. Personave pa shtetësi në përgjithësi u mohohet gëzimi i një sërë të drejtave të njeriut dhe nuk lejohen të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Konventa e 1954-ës trajton këtë marginalizim duke u dhënë personave pa shtetësi një grup thelbësor të drejtash. Dispozitat e saj, së bashku me standardet e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet minimale të personave pa shtetësi në shtetet palë të Konventës së 1954-ës. Statusi i dhënë një personi pa shtetësi në një shtet palë, pra të drejtat dhe detyrimet e personave pa shtetësi sipas ligjit kombëtar, duhet të pasqyrojë këto standarde ndërkombëtare.
12. Ky doracak synon të ndihmojë shtetet që të sigurojnë që personat pa shtetësi të marrin një status të tillë në juridiksionet e tyre. Ai trajton si trajtimin e personave të përcaktuar si pa shtetësi nga një shtet sipas Konventës së 1954-ës, ashtu edhe pozicionin e individëve që presin rezultatin e një procedure për përcaktimin e pashtetësisë. Doracaku shqyrton gjithashtu pozicionin e personave pa shtetësi në vendet që nuk janë palë në Konventën e 1954-ës, si dhe ata që konsiderohen si pa shtetësi *de facto*. Ndërsa të gjithë personat pa shtetësi duhet të trajtohen në përputhje me standardet ndërkombëtare, trajtimi i tyre mund të ndryshojë për të pasqyruar kontekstin në të cilin lind pashtetësia. Prandaj, ky doracak fillimisht trajton standardet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare dhe më pas shqyrton veçmas fushën e statusit të personit pa shtetësi për individët në një kontekst migrimi dhe për ata në "vendin e vet".⁶ Gjithashtu, merret parasysh marrëdhënia ndërmjet refugjatëve dhe personave pa shtetësi. Megjithëse një individ mund të jetë edhe pa shtetësi sipas Konventës së 1954-ës dhe refugjat sipas Konventës së vitit 1951, të paktën një refugjat pa shtetësi duhet të përfitojë nga mbrojtja e Konventës së vitit 1951 dhe e drejta ndërkombëtare për refugjatët.

⁶ Paragrafi 142 më poshtë shqyrton natyrën e të drejtës së një individi për të qëndruar në "vendin e vet" në vijim të nenit 12(4) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

PJESA E PARË: KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E PASHTETËSISË

A. PËRKUFIZIMI

13. Neni 1(1) i Konventës së 1954-ës përcakton përkufizimin e një personi pa shtetësi si më poshtë:

Për qëllimin e kësaj Konvente, termi "person pa shtetësi" nënkupton një person, i cili nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet sipas veprimit të ligjit të tij.

Konventa nuk lejon rezerva për nenin 1(1) dhe kështu ky përkufizim është i detyrueshëm për të gjitha shtetet palë në traktat. Për më tepër, Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare ka arritur në përfundimin se përkufizimi në nenin 1(1) është pjesë e së drejtës ndërkombëtare zakonore.⁷ Ky doracak nuk trajton nenin 1(2) të Konventës së 1954-ës, i cili përcakton rrethanat në të cilat personat që përfshihen në përkufizimin e "personit pa shtetësi" janë megjithatë të përjashtuar nga mbrojtja e këtij traktati.

⁷ Ju lutemi shihni faqen 49 të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, *Nenet mbi Mbrojtjen Diplomatike me komentarin*, 2006, ku thuhet se përkufizimi i nenit 1 mund "pa dyshim të konsiderohet se ka marrë një natyrë zakonore". Komenti është i qasshëm në <http://www.refworld.org/docid/525e7929d.html>. Teksti i nenit 1(1) të Konventës së 1954-ës përdoret në Nenet mbi Mbrojtjen Diplomatike për të dhënë një përkufizim të personit pa shtetësi.

B. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

14. Neni 1(1) i Konventës së 1954-ës duhet të interpretohet në përputhje me kuptimin e zakonshëm të tekstit, të lexuar në kontekst dhe duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e traktatit.⁸ Siç tregohet në preambulën e saj dhe në "*Travaux Préparatoires*", objekti dhe qëllimi i Konventës së 1954-ës është të sigurojë që personat pa shtetësi të gëzojnë ushtrimin sa më të gjerë të të drejtave të tyre të njeriut.⁹ Hartuesit synonin të përmirësonin pozitën e personave pa shtetësi duke rregulluar statusin e tyre. Në këtë mënyrë, si rregull i përgjithshëm, posedimi i një shtetësie është i preferueshëm kundrejt njohjes dhe mbrojtjes si person pa shtetësi. Prandaj, në përpjekje për t'u siguruar që të gjithë ata që përfshihen në fushën e Konventës së 1954-ës të përfitojnë nga dispozitat e saj, është e rëndësishme të kujdesemi që individët me një shtetësi të njihen si të tillë dhe të mos identifikohen gabimisht si pa shtetësi.
15. Neni 1(1) zbatohet si në kontekstin e migrimit ashtu edhe në atë jo të migrimit. Një person pa shtetësi mund të mos ketë kaluar kurrë një kufi ndërkombëtar, pasi ka jetuar në të njëjtin vend gjatë gjithë jetës së tij/saj. Megjithatë, disa persona pa shtetësi mund të jenë gjithashtu refugjatë ose persona të kualifikuar për mbrojtje plotësuese.¹⁰ Ata persona pa shtetësi që përfshihen në fushën e Konventës së vitit 1951 do të kenë të drejtën e mbrojtjes sipas këtij instrumenti, një çështje kjo e diskutuar më tej në pjesën e tretë më poshtë.
16. Një individ është një person pa shtetësi që nga momenti që plotësohen kushtet në nenin 1(1) të Konventës së 1954-ës. Kështu, çdo konstatim i një shteti ose i UNHCR-së që një individ plotëson testin në nenin 1(1) është me natyrë deklarative dhe jo konstitutive.¹¹

⁸ Ju lutemi shihni nenin 31(1) të Konventës së Vjenës të vitit 1969 mbi të drejtën e traktateve, i cili përcakton këtë rregull parësor interpretimi. Neni 31 vazhdon me përcaktimin e faktorëve të tjerë që janë të rëndësishëm në interpretimin e dispozitave të traktateve, ndërsa metodat plotësuese të interpretimit renditen në nenin 32.

⁹ Ju lutemi shihni paragrafin e dytë dhe të katërt të Preambulës:

Duke pasur parasysh se Kombet e Bashkuara, në raste të ndryshme, kanë shfaqur shqetësimin e tyre të thellë për personat pa shtetësi dhe janë përpjekur t'u garantojnë personave pa shtetësi ushtrimin sa më të gjerë të këtyre të drejtave dhe lirive themelore,...

Duke marrë parasysh se është e dëshirueshme që statusi i personave pa shtetësi të rregullohet dhe përmirësohet me një marrëveshje ndërkombëtare,...

(Referenca për "të drejtat dhe liritë themelore" është një referencë ndaj Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila përmendet në paragrafin e parë të Preambulës).

¹⁰ Për shembull, ato mund të bien brenda regjimit të mbrojtjes plotësuese të Bashkimit Evropian të përcaktuar në Direktivën e Këshillit 2004/83/KE të 29 prillit 2004 mbi standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë ndryshe për mbrojtjen ndërkombëtare dhe pëmbajtjen e mbrojtjes së dhënë. Ju lutemi shihni, në përgjithësi, Konkluzionin e Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së nr.103 (LVI) të vitit 2005 mbi format plotësuese të mbrojtjes, <http://www.unhcr.org/43576e292.html>

¹¹ Implikimet e kësaj, për sa i përket efektit pezullues të procedurave të përcaktimit dhe trajtimit të individëve që presin një rezultat të një përcaktimi të pashtetësisë së tyre, trajtohen në pjesën e dytë dhe të tretë më poshtë.

17. Neni 1(1) mund të analizohet duke e zbërthyer përkufizimin në dy elementë përbërës: “nuk konsiderohet si shtetas...sipas veprimit të ligjit të tij” dhe “nga asnjë shtet”. Kur përcaktohet nëse një individ është pa shtetësi sipas nenit 1(1), është shpesh më praktike të shikohet fillimisht çështja e “nga asnjë shtet”, pasi kjo jo vetëm që do të ngushtojë fushën e hetimit në shtetet me të cilat një individ ka lidhje, por gjithashtu mund të përjashtojë nga shqyrtimi që në fillim subjektet që nuk përmbushin konceptin e “Shtetit” sipas së drejtës ndërkombëtare. Në të vërtetë, në disa raste shqyrtimi vetëm i këtij elementi në vetvete do të jetë vendimtar, si p.sh kur i vetmi subjekt me të cilin një individ ka lidhje përkatëse nuk është një shtet.

C. INTERPRETIMI I TERMAVE

(1) “nga asnjë shtet”

(a) Cilat shtete duhet të shqyrtohen?

18. Megjithëse përkufizimi në nenin 1(1) është formuluar në trajtën negative (“nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet”), një hetim mbi atë nëse dikush është pa shtetësi kufizohet në shtetet me të cilat një person ka një lidhje përkatëse, veçanërisht në bazë të lindjes në territorin, prejardhjes, martesës, birësimit ose vendbanimit të zakonshëm. Në disa raste kjo mund të kufizojë fushën e hetimit vetëm në një shtet (ose në të vërtetë në një subjekt që nuk është shtet).¹²

(b) Çfarë është një “shtet”?

19. Përkufizimi i “Shtetit” në nenin 1(1) është i informuar nga mënyra se si termi ka evoluar përgjithësisht në të drejtën ndërkombëtare. Kriteret në Konventën e Montevideos të vitit 1933 mbi të drejtat dhe detyrat e shteteve mbeten të rëndësishme në këtë drejtim. Sipas kësaj Konvente, një shtet krijohet kur një subjekt ka një popullsi të përhershme, territor të përcaktuar, qeveri dhe kapacitet për të hyrë në marrëdhënie me shtete të tjera. Faktorë të tjerë të shtetësisë që janë shfaqur më pas në diskursin juridik ndërkombëtar përfshijnë efektivitetin e subjektit në fjalë, të drejtën e vetëvendosjes, ndalimin e përdorimit të forcës dhe pëlqimin e shtetit që ka ushtruar më parë kontroll mbi territorin në fjalë.¹³

12 Çështja se çfarë përbën një lidhje të rëndësishme trajtohet më tej në pjesën e dytë të këtij doracaku në kontekstin e standardit të provës që kërkohet për të konstatuar pashtetësinë.

13 Kur një subjekt pretendon të jetë një shtet i ri, por mënyra në të cilën ai është shfaqur përfshinte një shkelje të një norme *jus cogens*, kjo do të ngrinte pyetje në lidhje me kualifikueshmërinë e tij për shtetësi. Një normë *jus cogens* është një parim i së drejtës ndërkombëtare zakonore që konsiderohet të jetë urdhëruese nga natyra, domethënë ka përparësi ndaj çdo detyrimi tjetër (qoftë zakonor apo traktat nga natyra), është e detyrueshme për të gjitha shtetet dhe mund të anashkalohet vetëm nga një normë tjetër urdhëruese. Shembuj të normave *jus cogens* përfshijnë ndalimin e përdorimit të forcës dhe të drejtën për vetëvendosje.

20. Që një subjekt të jetë një "shtet" për qëllimet e nenit 1(1), nuk është e nevojshme që ai të ketë fituar njohje universale ose në shkallë të gjerë të shtetësisë së tij nga shtete të tjera ose të jetë bërë një shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, njohja ose pranimi do të jetë dëshmi e fortë e shtetësisë.¹⁴ Mund të lindin dallime në opinione brenda komunitetit ndërkombëtar nëse një subjekt i caktuar ka arritur shtetësinë. Pjesërisht, kjo pasqyron kompleksitetin e disa prej kritereve të përfshira dhe zbatimin e tyre. Edhe kur një subjekt duket se përmbush objektivist kriteret e përmendura në paragrafin e mësipërm, mund të ketë shtete që për arsye politike zgjedhin të mos e njohin, ose në mënyrë aktive të mos e njohin atë si shtet. Në bërjen e një përcaktimi të nenit 1(1), një vendimmarrës mund të priret të shikojë qëndrimin zyrtar të shtetit të tij/saj mbi personalitetin juridik të një subjekti të caktuar. Megjithatë, një qasje e tillë mund të çojë në vendime të ndikuara më shumë nga pozicioni politik i qeverisë së shtetit që bën përcaktimin sesa nga pozicioni i subjektit në të drejtën ndërkombëtare.
21. Pasi të jetë etabluar një shtet, ekziston një prezumim i fortë në të drejtën ndërkombëtare për vazhdimësinë e tij, pavarësisht nga efektiviteti i qeverisë së tij. Prandaj, një shtet që humb një qeverisje qendrore efektive për shkak të konfliktit të brendshëm megjithatë mund të mbetet një "shtet" për qëllimet e nenit 1(1).

(2) "nuk konsiderohet si shtetas ... sipas veprimit të ligjit të tij"

(a) Kuptimi i "ligjit"

22. Referenca ndaj "ligjit" në nenin 1(1) duhet të lexohet gjerësisht se përfshin jo vetëm legjislacionin, por edhe dekretet e ministrave, rregulloret, urdhëresat, praktikën gjyqësore (në vendet me traditë precedenti) dhe, sipas rastit, praktikën zakonore.¹⁵

(b) Kur një person "nuk konsiderohet si shtetas" sipas ligjit dhe praktikës së një shteti?

23. Përcaktimi mbi atë nëse një individ nuk konsiderohet si shtetas sipas veprimit të ligjit të tij kërkon një analizë të kujdesshme të mënyrës se si një shtet i zbaton ligjet e tij për shtetësinë në rastin e një individi në praktikë dhe çdo vendim rishikimi/apelimi që mund të ketë pasur ndikim në statusin e individit.¹⁶ Kjo është një çështje e kombinuar e fakteve dhe ligjit.

¹⁴ Ju lutemi vini re, megjithatë, debatin e kahmotshëm mbi natyrën konstituive kundrejt asaj deklarative të njohjes së shteteve. Doktrina e parë e konsideron aktin e njohjes si një parakusht për shtetësinë, ndërsa e dyta e trajton njohjen thjesht si dëshmi të këtij statusi sipas të drejtës ndërkombëtare. Këto qasje të ndryshme kontribuojnë gjithashtu në kompleksitetin e disa raste të përcaktimit të shtetësisë së një subjekti.

¹⁵ Një qasje e ngjashme është marrë në nenin 2(d) të Konventës Evropiane mbi Shtetësinë e vitit 1997.

¹⁶ Kjo qasje pasqyron parimin e përgjithshëm të ligjit të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të Konventës së Hagës të vitit 1930 mbi çështje të caktuara që lidhen me konfliktin e ligjeve të shtetësisë.

24. Zbatimi i kësaj qasjeje të shqyrtimit të pozicionit të një individi në praktikë mund të çojë në një konkluzion të ndryshëm nga ai që rrjedh nga një analizë thjesht formaliste e zbatimit të ligjeve të shtetësisë së një vendi në rastin e një individi. Një shtet mund të mos ndjekë në praktikë ligjin "në letër", madje të shkojë aq larg sa të injorojë thelbin e tij. Prandaj, referimi ndaj "ligjit" në përkufizimin e pashtetësisë në nenin 1(1) mbulon situatat kur ligji i shkruar është modifikuar thelbësisht kur bëhet fjalë për zbatimin e tij në praktikë.

(i) Mënyrat automatike dhe joautomatike të fitimit ose heqjes së shtetësisë

25. Shumica e shteteve kanë një kombinim mënyrash automatike dhe joautomatike për të bërë ndryshime në shtetësinë, duke përfshirë fitimin, heqjen dorë, humbjen ose privimin e shtetësisë.¹⁷ Kur përcaktohet nëse dikush konsiderohet si shtetas i një shteti ose është pa shtetësi, është e dobishme të përcaktohet nëse statusi i shtetësisë së një individi është ndikuar nga mekanizmat ose mënyrat automatike ose jo automatike.
26. Mënyrat automatike janë ato ku një ndryshim i statusit të shtetësisë bëhet sipas fuqisë së ligjit (*ex lege*).¹⁸ Sipas mënyrave automatike, shtetësia fitohet sapo të plotësohen kriteret e përcaktuara me ligj, si lindja në një territor ose lindje nga shtetas të një shteti. Për dallim nga kjo, në mënyrat jo automatike kërkohet një akt i individit ose i një autoriteti shtetëror përpara se të ndodhë ndryshimi i statusit të shtetësisë.

(ii) Identifikimi i autoriteteve kompetente

27. Për të përcaktuar nëse një shtet e konsideron një individ si shtetas të tij, është e nevojshme të identifikohet se cili institucion(e) është/janë autoriteti(et) kompetent për çështjet e shtetësisë në një vend të caktuar me të cilin ai ose ajo ka lidhje përkatëse. Kompetenca në këtë kontekst lidhet me autoritetin përgjegjës për dhënien ose heqjen e shtetësisë nga individët, ose për sqarimin e statusit të shtetësisë kur shtetësia fitohet ose hiqet automatikisht. Autoriteti ose autoritetet kompetente ndryshojnë nga shteti në shtet dhe në shumë raste përfshihet më shumë se një autoritet kompetent.¹⁹

17 Ju lutemi vini re se termat humbje dhe privim përdoren këtu në të njëjtën mënyrë si në Konventën e vitit 1961: "humbja" i referohet heqjes së shtetësisë me anë të veprimit të ligjit (sipas fuqisë së ligjit) (*ex lege*) dhe "privimi" i referohet heqjes së shtetësisë të iniciuar nga autoritetet e shtetit.

18 Ju lutemi vini re në lidhje me këtë se fraza "sipas veprimit të ligjit të tij" (ang. under the operation of its law) në nenin 1(1) nuk është sinonim i "sipas fuqisë së ligjit" (ang. by operation of law). Ky i fundit është një "term arti" [term i specializuar] (i përdorur, për shembull, në Konventën e vitit 1961) që nënkupton një mekanizëm që ka natyrë automatike. Përkufizimi i personit pa shtetësi përfshin shtetësinë që mund të jetë fituar ose tërhequr nëpërmjet mekanizmave joautomatikë, si dhe automatikë.

19 Nga sa më sipër rezultojnë se pikëpamjet e një organi shtetëror që nuk është kompetent të prononcohet për statusin e shtetësisë janë të parëndësishme.

28. Disa shtete kanë një organ të vetëm dhe të centralizuar që rregullon çështjet e shtetësisë që do të përbënin autoritetin kompetent për qëllimet e një analize të statusit të shtetësisë. Shtetet e tjera, megjithatë, kanë disa autoritete që mund të përcaktojnë shtetësinë, secili prej të cilave mund të konsiderohet autoritet kompetent në varësi të rrethanave. Kështu, nuk është e nevojshme që një autoritet kompetent të jetë një organ shtetëror qendror. Një organ administrativ lokal ose rajonal mund të jetë një autoritet kompetent siç mund të jetë një zyrtar konsullor²⁰ dhe në shumë raste zyrtarët e nivelit të ulët të qeverisjes lokale përbëjnë autoritetin kompetent. Thjesht mundësia që vendimi i një zyrtari të tillë mund të anulohet më vonë nga një zyrtar i lartë nuk e përjashton në vetvete të parën nga trajtimi si autoritet kompetent për qëllimet e një analize të nenit 1(1).
29. Identifikimi i autoritetit ose autoriteteve kompetente përfshin përcaktimin se cilat dispozita ligjore në lidhje me shtetësinë mund të jenë të rëndësishme në rastin e një individi dhe cili (at) autoritet (e) janë të mandatuara për t'i zbatuar ato. Izolimi i dispozitave ligjore përkatëse kërkon një vlerësim të historisë personale të një individi, si dhe një kuptim të ligjeve të shtetësisë së një shteti, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin, ose moszbatimin në disa raste, të ligjeve të shtetësisë në praktikë.
30. Identiteti dhe numri i autoriteteve kompetente në një rast të veçantë do të varet, në veçanti, nga faktorët e mëposhtëm:
- nëse duhet të merren parasysh mënyrat automatike ose jo automatike për fitimin, heqjen dorë ose heqjen e shtetësisë; dhe
 - nëse duhet të shqyrtohen më shumë se një ngjarje në lidhje me nënshtetësinë.
- (iii) Vlerësimi i provave të autoriteteve kompetente në mënyrat jo automatike të fitimit dhe heqjes së shtetësisë*
31. Identifikimi i autoritetit kompetent ku përfshihet një mënyrë joautomatike e ndryshimit të statusit të shtetësisë mund të jetë relativisht e thjeshtë. Për mekanizmat që varen nga një akt ose vendim të një organi shtetëror, ai organ do të jetë autoriteti kompetent.
32. Për shembull, departamenti qeveritar që vendos për aplikimet për natyralizim do të jetë autoriteti kompetent në lidhje me këtë mekanizëm. Pozicioni i këtij autoriteti është përgjithësisht vendimtar. Disa mënyra joautomatike që përfshijnë një akt të shtetit nuk përfshijnë ndonjë diskrecion në anën e zyrtarëve në fjalë; nëse një individ plotëson kërkesat

²⁰ Ju lutemi shihni më poshtë paragrafët 39-40.

e përcaktuara në ligj, zyrtarit do t'i kërkohet të kryejë një akt specifik që jep ose heq shtetësinë.²¹

33. Në mënyrat joautomatike ku kërkohet një akt i shtetit për fitimin e shtetësisë, në përgjithësi do të ketë një dokument që regjistron atë akt, si për shembull një certifikatë e nënshtetësisë. Një dokumentacion i tillë do të jetë vendimtar në vërtetimin e shtetësisë. Në mungesë të provave të tilla, mund të supozohet se nuk është ndërmarrë veprimi i nevojshëm dhe shtetësia nuk është fituar.²² Ky supozim i mos nënshtetësisë mund të lihet mënjanë nga deklaratat, veprimet ose provat pasuese nga autoriteti kompetent që tregojnë se shtetësia faktikisht ishte dhënë.

(iv) Vlerësimi i provave të autoriteteve kompetente në mënyrat automatike të fitimit të nënshtetësisë ose humbjes së shtetësisë

34. Në rastet kur fitimi ose humbja e shtetësisë ndodh automatikisht, asnjë organ shtetëror nuk përfshihet aktivisht në ndryshimin e statusit dhe nuk kërkohet asnjë hap aktiv nga një individ. Një ndryshim i tillë ndodh me veprimin e ligjit (*ex lege*) kur plotësohen kriteret e përcaktuara. Në shumicën e vendeve, shtetësia fitohet automatikisht qoftë nëpërmjet lindjes në territorin ose prejardhjes. Shtetësia fitohet gjithashtu automatikisht nga shumica e individëve të prekur nga suksesioni i shtetit.²³ Disa ligje parashikojnë humbje automatike të shtetësisë kur plotësohen disa kushte, të tilla si periudhat e përcaktuara të qëndrimit jashtë vendit, ose dështimi për t'u regjistruar ose bërë një deklaratë brenda një periudhe të caktuar.
35. Kur shtetësia fitohet automatikisht, dokumentet zakonisht nuk lëshohen nga shteti si pjesë e mekanizmit. Në raste të tilla, në përgjithësi është regjistrimi i lindjes ai që siguron dëshminë e vendit të lindjes dhe prindërve dhe në këtë mënyrë siguron dëshmi të fitimit të shtetësisë, qoftë nëpërmjet *jus soli* ose *jus sanguinis*, dhe jo duke qenë baza formale për fitimin e shtetësisë.²⁴
36. Kur janë në shqyrtim mënyrat automatike të fitimit ose humbjes së shtetësisë, autoriteti kompetent është çdo institucion shtetëror që është i autorizuar të bëjë një përcaktim të statusit të shtetësisë së një individi në kuptimin e qartësisë së atij statusi, dhe jo vendosjes nëse do të jepet apo të tërhiqet. Shembuj të organeve të tilla janë autoritetet e pasaportave ose, në një numër të kufizuar shtetesh, zyrtarët e regjistrimit civil (ku shtetësia tregohet në

21 Ju lutemi vini re se nuk mund të konkludohet se një individ është shtetas (ose i është hequr shtetësia) derisa të përfundojë një procedurë e tillë, ju lutemi shihni paragrafin 50 më poshtë.

22 Kërkesat për natyralizim ose dokumente të tjera të paraqitura përmes një procedure jo automatike të shtetësisë nuk kualifikohen si prova të mjaftueshme në lidhje me përcaktimin e një shteti për statusin e shtetësisë së atij individi.

23 Megjithatë, në disa raste të suksesionit të shtetit, nënshtetësia e një shteti pasardhës nuk është automatike dhe në vend të tyre përdoren mënyra joautomatike të fitimit të shtetësisë. Ju lutemi shikoni Komisionin e së Drejtës Ndërkombëtare, *Nenet mbi Shtetësinë e Personave Fizik në lidhje me Suksesionin e Shteteve me komentar*, 3 prill 1999, <http://www.refworld.org/docid/4512b6dd4.html>, për një pasqyrë të praktikës shtetërore.

24 Jus soli dhe jus sanguinis u referohen dy parimeve kryesore që rregullojnë fitimin e shtetësisë në sistemet juridike të shteteve, në bazë të vendit të lindjes, përkatësisht prejardhjes nga një shtetas.

aktet e regjistrimit civil, veçanërisht në regjistrimin e lindjes). Është e mundur që, në një rast të veçantë, të dalin më shumë se një autoritet kompetent pasi një numër organesh mund të marrin qëndrime në mënyrë legjitime në lidhje me shtetësinë e një individi gjatë aktiviteteve të tyre të caktuara.

(v) Konsideratat ku praktika shtetërore bie ndesh me mënyrat automatike të fitimit të shtetësisë

37. Kur autoritetet kompetente trajtojnë një individ si joshtetas edhe pse ai ose ajo duket se i plotëson kriteret për fitimin automatik të shtetësisë sipas veprimit të ligjeve të një vendi, është pozicioni i tyre dhe jo ligji në letër që është përcaktues në konkludimin se një shtet nuk e konsideron një individ të tillë si shtetas. Ky skenar lind shpesh kur diskriminimi kundër një grupi të caktuar është i përhapur në departamentet qeveritare ose ku, në praktikë, ligji që rregullon fitimin automatik të shtetësisë në lindje shpërfilllet sistematikisht dhe individëve u kërkohet të provojnë lidhje shtesë me një shtet.²⁵

(vi) Vlerësimi i shtetësisë në mungesë të provave për pozicionin e autoriteteve kompetente

38. Mund të ketë raste kur një individ nuk ka pasur kurrë kontakt me autoritetet kompetente të një shteti, ndoshta sepse fitimi i shtetësisë ka qenë automatik në lindje dhe një person ka jetuar në një rajon pa shërbime publike dhe nuk ka aplikuar kurrë për dokumente identiteti ose pasaportë. Në raste të tilla, është e rëndësishme të vlerësohet qëndrimi i përgjithshëm i shtetit për sa i përket statusit të shtetësisë së personave që ndodhen në situatë të ngjashme. Nëse shteti ka një histori të mirë për sa i përket njohjes, në mënyrë jodiskriminuese, të statusit të shtetësisë së të gjithë atyre që duket se përfshihen në objektin e ligjit përkatës, për shembull në mënyrën se si trajtohen kërkesat për karta identiteti, kjo mund të tregojë se personi në fjalë konsiderohet si shtetas nga shteti. Megjithatë, nëse individi i përket një grupi, anëtarëve të të cilit u mohohen rregullisht dokumentet e identifikimit të lëshuara vetëm për shtetasit, kjo mund të tregojë se ai ose ajo nuk konsiderohet si shtetas nga shteti.

²⁵ Kur ligjet e një shteti parashikojnë fitimin automatik të shtetësisë, por në praktikë një shtet vendos kërkesa shtesë për individët për të fituar shtetësinë, kjo nuk e mohon natyrën automatike të ligjit të shtetësisë. Përkundrazi, tregon se shteti në praktikë nuk i konsideron ata që nuk plotësojnë kërkesat ekstra-ligjore si shtetas, duke i bërë ata potencialisht pa shtetësi sipas përkufizimit të nenit 1(1).

(vii) Roli i autoriteteve konsullore

39. Roli i autoriteteve konsullore meriton një shqyrtim të veçantë. Një konsullatë mund të jetë autoriteti kompetent përgjegjës për kryerjen e hapit të nevojshëm në një mekanizëm joautomatik. Kjo ndodh, për shembull, kur ligjet e një vendi kërkojnë që fëmijët e lindur nga shtetasit e tyre jashtë shtetit të regjistrohen në një konsullatë si një parakusht për marrjen e shtetësisë së prindërve. Në këtë mënyrë, konsullata në vendin e lindjes së një fëmije të tillë do të jetë autoriteti kompetent dhe pozicioni i saj mbi shtetësinë e tij/saj do të jetë vendimtar, duke supozuar se nuk duhet gjithashtu të merret parasysh asnjë mekanizëm pasues. Nëse një individ i refuzohet një regjistrim i tillë ose pengohet të aplikojë për të, ai ose ajo nuk konsiderohet si shtetas për qëllimet e nenit 1(1).
40. Konsullatat mund të identifikohen si autoritete kompetente në aspekte të tjera. Kur individët kërkojnë ndihmë nga një konsullatë, për shembull për të rinovuar një pasaportë ose për të marrë sqarime të statusit të shtetësisë së tyre, një konsullatë kërkohet në mënyrë legjitime të marrë një pozicion për statusin e shtetësisë së atij individ brenda kompetencave të saj të mbrojtjes konsullore. Duke vepruar kështu, ajo vepron si autoritet kompetent. Ky është gjithashtu rasti kur ajo i përgjigjet kërkesave nga shtete të tjera në lidhje me statusin e shtetësisë së një individ. Kur një konsullatë është i vetmi autoritet kompetent për të marrë një pozicion për statusin e shtetësisë së një individ, pozicioni i saj është zakonisht vendimtar. Kur autoritetet e tjera kompetente kanë marrë gjithashtu pozicione për statusin e shtetësisë së një individ, pozicionet e tyre duhet të peshohen kundrejt çdo pozicioni të marrë nga autoritetet konsullore.²⁶

(viii) Kërkesat për informacion nga autoritetet kompetente

41. Në disa raste, një individ ose një shtet mund të kërkojë sqarim të statusit të shtetësisë së atij individ nga autoritetet kompetente. Kjo nevojë zakonisht lind kur përfshihet një mënyrë automatike e fitimit ose humbjes së shtetësisë ose kur një individ mund të ketë fituar ose të jetë privuar nga shtetësia nëpërmjet një mekanizmi jo automatik, por i mungon ndonjë provë dokumentare për këtë. Kërkime të tilla informacioni mund të përballen me heshtje ose me refuzim për t'u përgjigjur nga autoriteti kompetent. Përfundimet në lidhje me mungesën e përgjigjes duhet të nxirren vetëm pas një periudhe të arsyeshme kohore. Nëse një autoritet kompetent ka një politikë të përgjithshme për të mos iu përgjigjur kurrë kërkesave të tilla, nuk mund të nxirren përfundime nga ky dështim për t'u përgjigjur bazuar vetëm në mospërgjigjen. Në të kundërt, kur një shtet i përgjigjet në mënyrë rutinore kërkesave të tilla, mungesa e përgjigjes në përgjithësi do të sigurojë konfirmim të fortë se individ nuk është shtetas. Kur një autoritet kompetent lëshon një përgjigje pro forma ndaj një kërkesë për informacion dhe është e qartë se autoriteti nuk ka shqyrtuar rrethanat e

²⁶ Ju lutemi shihni paragrafin 44 mbi peshën relative që duhet t'u jepet organeve të ngarkuara me lëshimin e dokumenteve të identitetit që përmendin statusin e shtetësisë.

veçanta të pozicionit të një individi, përgjigja e tillë ka pak peshë. Në çdo rast, pozicioni i autoritetit kompetent për një hetim të statusit të shtetësisë do të duhet të peshohet kundrejt pozicionit të marrë nga çdo autoritet ose autoritete tjera kompetente, të përfshira në çështjen e një individi.²⁷

(ix) Trajtimi jo konsistent nga autoritetet kompetente

42. Vlerësimi i pozicioneve të autoriteteve kompetente bëhet kompleks kur një individ është trajtuar nga aktorë të ndryshëm shtetërorë në mënyrë jokonsistente. Për shembull, një individ mund të jetë lejuar të marrë përfitime publike, të cilat me ligj dhe në praktikë janë të rezervuara për shtetasit, por me arritjen e moshës madhore i mohohet pasaporta. Në varësi të fakteve specifike të çështjes, trajtimi jo konsistent mund të jetë një shembull i shkeljes së të drejtave të një shtetasi, pasojë e faktit se ai person nuk ka fituar kurrë shtetësinë e atij shteti, ose rezultat i asaj se individ është privuar ose ka humbur shtetësinë.
43. Në rastet kur ka prova se një individ ka fituar shtetësinë nëpërmjet një mekanizmi jo automatik të varur nga një akt i një organi shtetëror, mohimi i mëvonshëm nga organet e tjera shtetërore të të drejtave që u jepen përgjithësisht shtetasve tregon se të drejtat e tij/saj janë shkelur. Në këtë mënyrë, në rrethana të caktuara natyra e trajtimit të mëvonshëm mund të tregojë se shteti ka ndryshuar qëndrimin e tij për statusin e shtetësisë së atij individi, ose se shtetësia është hequr.
44. Edhe kur fitimi ose heqja e shtetësisë mund të ketë ndodhur automatikisht ose nëpërmjet aktit formal të një individi, autoritetet shtetërore megjithatë shpesh më pas konfirmojnë se shtetësia është fituar ose hequr. Kjo përgjithësisht ndërmerret nëpërmjet procedurave për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Në lidhje me mekanizmat për fitimin ose humbjen e shtetësisë, automatikisht ose nëpërmjet aktit formal të një individi, një peshë më e madhe jepet në lidhje me pikëpamjen e autoriteteve kompetente përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve të identitetit që përbëjnë dëshmi të shtetësisë, si pasaportat, certifikatat e shtetësisë dhe, kur ato lëshohen vetëm për shtetasit, kartat e identitetit.²⁸

(x) Shtetësia e fituar me gabim ose keqbesim

45. Kur veprimi i autoritetit kompetent në një mekanizëm jo automatik ndërmerret gabimisht (për shembull, për shkak të një keqkuptimi të ligjit që duhet zbatuar) ose në keqbesim, kjo në vetvete nuk e zhvleftëson statusin e shtetësisë së individit të fituar në këtë mënyrë. Kjo rrjedh nga kuptimi i zakonshëm i termave në nenin 1(1) të Konventës së 1954-ës. E njëjta gjë vlen nëse statusi i shtetësisë së individit ndryshon si rezultat i një aplikimi mashtrues

²⁷ Ju lutemi vini re se në rastet e një ndryshimi jo automatik të statusit të shtetësisë që kërkon një akt të një shteti, ekzistenca (ose mungesa) e dokumenteve të lëshuara normalisht si pjesë e veprimit të shtetit do të jetë vendimtare në përcaktimin e shtetësisë. Ju lutemi shihni paragrafin 33.

²⁸ Në fakt, autoritetet e tjera mund të konsultohen me këtë autoritet kompetent kur marrin një pozicion për shtetësinë e individit.

nga individi ose i një aplikimi që përmbante pa dashje gabime në lidhje me faktet materiale. Për qëllimet e përkufizimit, dhëniet e shtetësisë sipas një mekanizmi joautomatik duhet të konsiderohen të vlefshme edhe nëse nuk ka bazë ligjore për një dhënie të tillë.²⁹ Megjithatë, në disa raste shteti, me zbulimin e gabimit ose keqbesimit të përfshirë në procedurën e shtetësisë në fjalë, më pas do të ketë ndërmarre veprime për të privuar individin nga shtetësia dhe kjo do të duhet të merret parasysh në përcaktimin e pozicionit të shtetit për statusin aktual të individit.

46. Ndikimi i mashtrimit ose gabimit në fitimin e shtetësisë duhet të dallohet nga fitimi mashtrues i dokumenteve të cilat mund të paraqiten si dëshmi e shtetësisë. Këto dokumente nuk do të mbështesin domosdoshmërisht një konstatim të shtetësisë pasi në shumë raste ato nuk do të jenë të lidhura me asnjë mekanizëm të shtetësisë, automatik ose jo automatik, i cili në fakt është aplikuar në lidhje me individin.

(xi) Ndikimi i procedurave të ankimimit/shqyrtimit

47. Në rastet kur statusi i shtetësisë së një individi ka qenë objekt i procesit të rishikimit ose ankimimit, qoftë nga një organ gjyqësor apo një organ tjetër, vendimi i tij duhet të merret parasysh. Në shtetet që përgjithësisht respektojnë sundimin e ligjit,³⁰ vendimi i organit të apelit/shqyrtimit zakonisht do të përbënte pozicionin e shtetit në lidhje me shtetësinë e individit për qëllimet e nenit 1(1) nëse sipas ligjit vendor vendimet e tij janë të detyrueshme për ekzekutivin.³¹ Kështu, kur autoritetet e kanë trajtuar më pas një individ në një mënyrë jokonsistente me konstatimin e shtetësisë nga një organ shqyrtues, kjo përfaqëson një shembull të mosrespektimit të të drejtave të një shtetasi dhe jo të mos qenit të individit shtetas.
48. Një qasje e ndryshme mund të justifikohet në vendet ku ekzekutivi është në gjendje të injorojë qëndrimet e organeve gjyqësore ose të organeve të tjera shqyrtuese (edhe pse këto janë të detyrueshme si çështje ligjore) me pandëshkueshmëri. Ky mund të jetë rasti, për shembull, në shtetet ku një praktikë e diskriminimit të një grupi të caktuar është e përhapur në institucionet shtetërore. Në raste të tilla, pozicioni i autoriteteve shtetërore se

29 Kjo situatë duhet të dallohet nga ajo ku një joshtetas trajtohet thjesht me privilegjet e shtetësisë.

30 Sundimi i ligjit” përkrahur në një raport të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të vitit 2004 si:

... një parim qeverisjeje në të cilin të gjithë personat, institucionet dhe subjektet, publike dhe private, duke përfshirë edhe vetë shtetin, janë përgjegjës ndaj ligjeve që janë shpallur publikisht, zbatohen në mënyrë të barabartë dhe gjykojnë në mënyrë të pavarur dhe që janë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut...

Ju lutemi shihni, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, *Sundimi i Ligjit dhe Drejtësia Tranzicionale në Shoqëritë e Konfliktëve dhe Postkonfliktëve: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, 23 gusht 2004, S/2004/616, <http://www.refworld.org/docid/45069c434.html>, paragrafi 6.

31 Përfundimisht do të ishte rasti kur sipas ligjit vendor, konstatimi gjyqësor është vetëm një rekomandim dhe nuk është detyrues nga natyra për autoritetet.

grupe të tilla nuk janë shtetas do të ishte vendimtar dhe jo pozicioni i autoriteteve gjyqësore që mund të mbështesin të drejtat e shtetësisë të grupeve të tilla.

49. Mund të ketë situata kur vendimi i një gjykate në një rast që nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me individin, megjithatë ka implikime ligjore për statusin e shtetësisë së atij personi. Nëse vendimi ndryshon, si çështje e ligjit të brendshëm, statusin e shtetësisë së një personi të tillë, kjo në përgjithësi do të jetë konkluzive sa i përket shtetësisë së tij ose të saj (në varësi të kualifikimit në lidhje me sundimin e ligjit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm). Kjo mund të lindë, për shembull, kur në një rast të veçantë interpretimi i një dispozite që rregullon një mekanizëm për fitimin automatik të shtetësisë ka efektin e sjelljes së një grupi të tërë njerëzish brenda kuadrit të asaj dispozite pa u kërkuar ndonjë veprim nga ana e tyre ose e qeverisë.³²

(xii) Çështjet e përkohshme

50. Shtetësia e një individi duhet të vlerësohet si në kohën e përcaktimit të pranueshmërisë sipas Konventës së 1954-ës. Nuk është as një ushtrim historik dhe as parashikues. Pyetja së cilës duhet ofruar përgjigje është nëse, në pikën e bërjes së një përcaktimi sipas nenit 1(1), një individ është shtetas i vendit ose vendeve në fjalë. Prandaj, nëse një individ është në proces e sipër për fitimin e shtetësisë, por këto procedura nuk janë përfunduar ende, ai ose ajo nuk mund të konsiderohet si shtetas për qëllimet e nenit 1(1) të Konventës së 1954-ës.³³ Në mënyrë të ngjashme, kur kërkesat ose procedurat për humbjen, privimin ose heqjen dorë nga shtetësia janë përmbushur ose përfunduar vetëm pjesërisht, individi është ende shtetas për qëllimet e përkufizimit të personit pa shtetësi.

³² Për shembull, ky do të ishte rasti kur një gjykatë vendos që një dispozitë e legjisllacionit të shtetësisë që rregullon fitimin automatik të shtetësisë nga individë të lindur në territor para një date specifike zbatohet për një grup të tërë etnik, pavarësisht deklaratave për të kundërtën nga qeveria.

³³ E njëjta qasje zbatohet kur individi nuk ka ndjekur ose ezauruar një mjet juridik në lidhje me mohimin ose heqjen e shtetësisë.

(xiii) Heqja dorë vullnetare nga shtetësia

51. Heqja dorë vullnetare lidhet me një akt të vullnetit të lirë ku një individ heq dorë nga statusi i tij/saj i shtetësisë. Kjo zakonisht merr formën e një deklarate me gojë ose me shkrim. Heqja pasuese shtetësisë mund të jetë automatike ose në diskrecionin e autoriteteve.³⁴ Në disa shtete, heqja dorë vullnetare nga shtetësia trajtohet si bazë për përjashtimin e një individi nga mbulimi i nenit 1(1). Megjithatë, kjo nuk lejohet nga Konventa e vitit 1954. Objekti dhe qëllimi i traktatit, pra lehtësimi i gëzimit nga personat pa shtetësi të të drejtave të tyre të njeriut, është po aq i rëndësishëm si në rastet e heqjes vullnetare ashtu edhe jovullnetare të shtetësisë. Në të vërtetë, në shumë raste heqja dorë mund të ketë ndjekur një objektiv legjitim, për shembull plotësimin e kushteve për fitimin e një shtetësie tjetër, dhe individ mund të ketë pritur vetëm një periudhë shumë të shkurtër si person pa shtetësi. Çështja e zgjedhjes së lirë të një individi nuk është e rëndësishme kur përcaktohet pranueshmëria për t'u njohur si pa shtetësi sipas nenit 1(1); megjithatë, mund të jetë e rëndësishme për çështjen e trajtimit të marrë më pas. Ata që kanë hequr dorë vullnetarisht nga shtetësia e tyre mund të jenë në gjendje ta rifitojnë këtë shtetësi, ndryshe nga personat e tjerë pa shtetësi. Disponueshmëria e mbrojtjes në një shtet tjetër mund të ketë ndikim në statusin që do të jepet në njohje dhe, si e tillë, kjo çështje shqyrtohet në pjesën e tretë.

(xiv) Koncepti i shtetësisë

52. Në vlerësimin e ligjeve të shtetësisë së një shteti, është e rëndësishme të kihet parasysh se terminologjia e përdorur për të përshkruar një "shtetas" ndryshon nga vendi në vend. Për shembull, etiketat e tjera që mund të aplikohen për atë status përfshijnë "nënshtetas"[citizen], "subjekt", "national" në frëngjisht dhe "nacional" në spanjisht. Për më tepër, brenda një shteti mund të ketë kategori të ndryshme të shtetësisë me emra të ndryshëm dhe të drejta të ndërlidhura. Konventa e 1954-ës ka të bëjë me përmirësimin e efektit negativ, për sa i përket dinjitetit dhe sigurisë, të një individi që nuk plotëson një aspekt themelor të sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ekzistenca e marrëdhënies shtetas-shtet. Në këtë mënyrë, përkufizimi i personit pa shtetësi në nenin 1(1) përfshin një koncept të shtetasit që pasqyron një lidhje formale, të një karakteri politik dhe juridik, midis individit dhe një shteti të caktuar. Ky është i ndryshëm nga koncepti i "kombësisë" (nacionalitetit) që ka të bëjë me të qenit anëtar i një grupi fetar, gjuhësor ose etnik.³⁵ Si i tillë, koncepti i traktatit për shtetasin është në përputhje me kuptimin tradicional të këtij termi sipas së drejtës ndërkombëtare; Pra personat mbi të cilët një shtet konsideron se ka juridiksion në bazë të shtetësisë, duke përfshirë të drejtën për të ngritur pretendime kundër shteteve të tjera për keqtrajtimin e tyre.

³⁴ Heqja dorë vullnetare duhet të dallohet nga humbja e shtetësisë nga mospërmbyshja e formaliteteve, duke përfshirë kur individ është i vetëdijshëm për kërkesat përkatëse dhe prapëseprap zgjedh t'i shpërfillë ato.

³⁵ Ky kuptim i "kombësisë" mund të gjendet, për shembull, në përkufizimin e refugjatit në nenin 1A(2) të Konventës së vitit 1951 në lidhje me shprehjen "frika e bazuar nga të qenit i persekutuar për arsye të racës, fesë, kombësisë..." (theksimi i shtuar).

53. Kur shtetet u japin një status ligjor grupeve të caktuara të njerëzve mbi të cilët ata konsiderojnë se kanë juridiksion mbi bazën e lidhjes së shtetësisë dhe jo të një forme rezidence (qëndrimi), atëherë një person që i përket kësaj kategorie do të jetë një "shtetas" për qëllimet e Konventës së vitit 1954. Në përgjithësi, të paktën, një status i tillë do të shoqërohet me të drejtën e hyrjes, rihyrjes dhe qëndrimit në territorin e shtetit, por mund të ketë situata ku, për arsye historike, hyrja lejohet vetëm në një territor jometropolitan që i përket një shteti. Fakti që kategori të ndryshme të shtetësisë brenda një shteti kanë të drejta të ndryshme që lidhen me to, nuk i pengon mbajtësit e këtyre të drejtave që të trajtohen si "shtetas" për qëllimet e nenit 1(1). As fakti që në disa vende të drejtat e lidhura me shtetësinë janë më të pakta se ato që gëzojnë shtetasit e shteteve të tjera ose në të vërtetë janë më të mangëta se ato që kërkohen në kuptimin e detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.³⁶ Edhe pse çështja e të drejtave të pakësuar mund të ngrejë çështje në lidhje me efektivitetin e shtetësisë dhe shkeljet e detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kjo nuk ka të bëjë me aplikimin e përkufizimit të personit pa shtetësi në Konventën e vitit 1954.³⁷
54. Nuk ka kërkesë për një lidhje "të vërtetë" ose "efektive" të nënkuptuar në konceptin e "shtetasit" në nenin 1(1).³⁸ Shtetësia, nga natyra e saj, pasqyron një lidhje midis shtetit dhe individit, shpesh në bazë të lindjes në territor ose prejardhjes nga një shtetas dhe kjo shpesh është e evidente në kriteret për fitimin e shtetësisë në shumicën e vendeve. Megjithatë, një person mund të jetë ende një "shtetas" për qëllimet e nenit 1(1) pavarësisht se nuk ka lindur ose nuk banon zakonisht në shtetin e shtetësisë së supozuar.
55. Sipas të drejtës ndërkombëtare, shtetet kanë diskrecion të gjerë në dhënien dhe heqjen e shtetësisë. Ky diskrecion mund të kufizohet me traktat. Në veçanti, ekzistojnë ndalime të shumta në traktatat globale dhe rajonale të të drejtave të njeriut në lidhje me diskriminimin mbi baza të tilla si raca, të cilat zbatohen në lidhje me dhënien, humbjen dhe privimin e shtetësisë.³⁹

36 Ju lutemi vini re se janë të drejtat që lidhen *përgjithësisht* me shtetësinë ato që janë të rëndësishme, jo nëse të drejta të tilla respektohen në të vërtetë në përvojën specifike të një individi.

37 Historikisht, sipas të drejtës ndërkombëtare nuk duket se ka pasur ndonjë kërkesë që shtetësia të ketë një përmbajtje specifike për sa i përket të drejtave të individëve, në krahasim me krijimin e disa detyrimeve ndërshtetërore.

38 Këto koncepte kanë lindur në fushën e mbrojtjes diplomatike, që është fusha e së drejtës ndërkombëtare zakonore që rregullon të drejtën e një shteti për të ndërmarrë veprime diplomatike dhe të tjera kundër një shteti tjetër në emër të shtetasit të tij, të drejtat dhe interesat e të cilit janë dëmtuar nga shteti tjetër. Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare kohët e fundit nënvizoi pse këto koncepte nuk duhet të zbatohen përtej një grupi të ngushtë rrethanash; ju lutemi shihni faqen 33 të *Neneve të tij mbi Mbrojtjen Diplomatike me komentar*, shënimi 7 më sipër.

39 Një shembull është neni 9 i Konventës së vitit 1979 mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, i cili garanton se të gjitha gratë duhet të kenë të drejta të barabarta si burrat në aftësinë e tyre për t'u dhënë shtetësinë fëmijëve të tyre dhe në lidhje me fitimin, ndryshimin ose mbajtjen e shtetësisë së tyre (zakonisht pas martesës me një të huaj).

Ndalimet në aspektin e së drejtës ndërkombëtare zakonore nuk janë aq të qarta, megjithëse një shembull do të ishte privimi për shkak të racës.

56. Dhënia, refuzimi ose heqja e shtetësisë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare nuk duhet të pranohet. Megjithatë, paligjshmëria në nivel ndërkombëtar është përgjithësisht jo relevante për qëllimet e nenit 1(1). Alternativa do të nënkuptonte që një individ të cilit i është hequr shtetësia në një mënyrë që nuk është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare do të konsiderohet sidoqoftë si "shtetas" për qëllimet e nenit 1(1); një situatë në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e Konventës së 1954-ës.⁴⁰

⁴⁰ Përrjashtim nga qasja e përgjithshme mund të jenë situatat kur shkelja e së drejtës ndërkombëtare përbën shkelje të një norme detyruese të së drejtës ndërkombëtare. Në rrethana të tilla, shtetet mund të jenë të detyruara të mos njohin si të ligjshme situatat që rrjedhin nga kjo shkelje. Kjo mund të përfshijë mosnjohjen e statusit të shtetësisë, duke përfshirë, ndoshta, mënyrën se si ky status trajtohet në një përcaktim të nenit 1 (1). Shtrirja e saktë e këtij detyrimi sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare mbetet një çështje debati.

PJESA E DYTË: PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E PASHTETËSISË

A. TË PËRGJITHSHME

(1) Pasqyrë e përgjithshme

57. Zyrtarët qeveritarë mund të ndeshen me pyetjen nëse një person është pa shtetësi në një sërë kontekstesh, duke reflektuar rolin kritik që luan shtetësia në jetën e përditshme. Për shembull, marrja në konsideratë e statusit të shtetësisë është e rëndësishme kur individët aplikojnë për pasaporta ose dokumente identiteti, kërkojnë qëndrim të ligjshëm ose punësim në sektorin publik, duan të ushtrojnë të drejtat e tyre të votës, të kryejnë shërbimin ushtarak ose përpiqen të kenë qasje në shërbimet qeveritare. Çështja e shtetësisë dhe pashtetësisë mund të lindë kur e drejta e një individ për të qenë në një vend sfidohet në procedurat e largimit. Në përcaktimin e statusit të refugjatit, shtetësia është shpesh çelësi për identifikimin e vendit (ose vendeve) në lidhje me të cilat duhet të vlerësohen pretendimet e një individ për një frikë të bazuar nga persekutimi. Një vlerësim i pashtetësisë do të jetë i nevojshëm kur një individ kërkon zbatimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në Konventën e 1961-shit. Këta shembuj ilustrojnë se përcaktimi i pashtetësisë është i nevojshëm në një sërë procedurash gjyqësore dhe administrative. Megjithatë, ky doracak ka të bëjë me procedurat që synojnë në mënyrë specifike, nëse jo ekskluzivisht, në përcaktimin nëse një individ është pa shtetësi.

(2) Përcaktimi i pashtetësisë dhe i së drejtës për një shtetësi

58. Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë përgjithësisht ndihmojnë shtetet në përmbushjen e angazhimeve të tyre sipas Konventës së 1954-ës. Megjithatë, përdorimi i tyre mund të mos jetë i përshtatshëm në lidhje me popullata të caktuara pa shtetësi. Pashtetësia mund të lindë si në një kontekst migrator ashtu dhe jo migrator dhe profili i pashtetësisë në një vend të caktuar mund të përshtatet me njërin ose tjetrin skenar ose mund të jetë i përzier. Disa popullata pa shtetësi në një kontekst jo migrator mbeten në "vendin e vet" dhe mund të quhen si popullata *in situ*.⁴¹ Për këto grupe, procedurat e përcaktimit për qëllimin e

marrjes së statusit të personave pa shtetësi nuk janë të përshtatshme për shkak të lidhjeve të tyre të krijuara prej kohësh me këto vende. Bazuar në standardet ekzistuese

41 Fraza "vendi i vet" është marrë nga neni 12(4) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe interpretimi i tij nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

ndërkombëtare dhe praktikën e shteteve në fushën e reduktimit të pashtetësisë, lidhje të tilla përfshijnë banimin e zakonshëm afatgjatë ose banimin në kohën e suksesionit të shtetit. Në varësi të rrethanave të popullatave në shqyrtim, shtetet mund të këshillohen të ndërmarrin fushata të shënjestruara të shtetësisë ose përpjekje për verifikimin e shtetësisë në vend të procedurave të përcaktimit të pashtetësisë.⁴²

59. Fushatat e shënjestruara të shtetësisë ndërmerren me objektivin e zgjidhjes së situatës së pashtetësisë nëpërmjet dhënies së shtetësisë, në vend të identifikimit të personave si pa shtetësi për t'u siguruar atyre një status si të tillë. Një numër shtetesh kanë ndërmarrë fushata të tilla shtetësie në lidhje me popullatat që janë pa shtetësi prej një kohe të gjatë në territorin e tyre, në disa raste me ndihmën e UNHCR-së. Edhe kur shtetet ndërmarrin fushata të shtetësisë, është ende e dobishme të vendosen procedura për përcaktimin e pashtetësisë për individët pa shtetësi që nuk bëjnë pjesë në popullatën in situ pasi profili i personave pa shtetësi në një vend të caktuar mund të jetë i përzier ose mund të ndryshojë me kalimin e kohës.
60. Procedurat e verifikimit të shtetësisë ndihmojnë individët në një territor ku ata kanë vështirësi në marrjen e dëshmive për statusin e tyre të shtetësisë. Procedura të tilla shpesh përfshijnë një proces të arritshëm, të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë për dokumentimin e shtetësisë ekzistuese, duke përfshirë shtetësinë e një shteti tjetër.
61. Kërkesat procedurale si për fushatat e shtetësisë ashtu edhe për procedurat e verifikimit të shtetësisë do të jenë të ngjashme me ato të përdorura në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë në praktikë, pasi ato duhet të pasqyrojnë format e provave të disponueshme në një vend dhe vështirësitë me të cilat përballen aplikantët për të provuar statusin e tyre të shtetësisë. Nganjëherë mund të lihen mënjane provat dokumentare dhe në vend të kësaj mund të mjaftojë dëshmia nën betim e anëtarëve të komunitetit se një individ plotëson kriteret përkatëse sipas ligjeve të shtetësisë, si lindja në territor ose prejardhja nga një prind që ishte shtetas.

⁴² Ju lutemi shihni paragrafin 50 të UNHCR-së, Veprimi i UNHCR-së për të adresuar pashtetësinë: Një dokument strategjik, mars 2010, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4b9e0c3d2.html>:

... burimet nuk duhet t'i dedikohen një përcaktimi formal të pashtetësisë ku një qëllim realist, imediat është fitimi, rifitimi ose konfirmimi i shtetësisë nga një popullatë e tillë. Ky zakonisht do të jetë rasti për ato situata të stërzgjitura në të cilat një popullatë e tërë ka lidhje të rëndësishme vetëm me shtetin në të cilin ata janë banorë.

B. VENDOSJA E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIM

(1) Hartimi dhe vendndodhja e procedurave të përcaktimit

62. Shtetet kanë diskrecion të gjerë në hartimin dhe funksionimin e procedurave të përcaktimit të pashtetësisë pasi Konventa e 1954-ës hesht për çështje të tilla. Faktorët lokalë, të tillë si madhësia e vlerësuar dhe diversiteti i popullatës pa shtetësi, si dhe kompleksiteti i çështjeve ligjore dhe të provave që do të shqyrtohen, do të ndikojnë në qasjen e ndërmarrë. Megjithatë, që procedura të tilla të jenë efektive, përcaktimi i pashtetësisë duhet të jetë një objektiv specifik i mekanizmit në fjalë, megjithëse jo domosdoshmërisht i vetmi.
63. Praktika aktuale e shteteve është e ndryshme në lidhje me vendndodhjen e procedurave të përcaktimit të pashtetësisë brenda strukturave administrative kombëtare, duke reflektuar konsiderata specifike të vendit. Shtetet mund të zgjedhin ndërmjet një procedure të centralizuar ose asaj që kryhet nga autoritetet lokale. Procedurat e centralizuara janë të preferueshme pasi ato kanë më shumë gjasa të zhvillojnë ekspertizën e nevojshme midis zyrtarëve që marrin përsipër përcaktimin e statusit. Sigurimi i qasjes së lehtë për aplikantët e vendosur në pjesë të ndryshme të një vendi mund të lehtësohet nëpërmjet masave të ndryshme: për shembull, lejimi i aplikimeve me shkrim që të dorëzohen në zyrat lokale për t'i transmetuar më tej organit qendror të përcaktimit, i cili mund të koordinojë dhe drejtojë ekzaminimin e duhur të fakteve përkatëse në nivel lokal, duke përfshirë intervistën personale me aplikantin.
64. Përcaktimi nëse një person është pa shtetësi mund të jetë kompleks dhe sfidues, por është në interes si të shteteve edhe personave pa shtetësi që procedurat e përcaktimit të jenë sa më të thjeshta, të drejta dhe efikase. Për këtë qëllim, disa shtete mund të konsiderojnë përshtatjen e procedurave ekzistuese administrative për të përfshirë përcaktimin e pashtetësisë. Faktorët që duhen marrë parasysh përfshijnë kapacitetin administrativ, ekspertizën ekzistuese për çështjet e pashtetësisë, si dhe madhësinë dhe profilin e pritshëm të popullatës pa shtetësi. Në çdo procedurë të kombinuar, është thelbësore që përkufizimi i personit pa shtetësi të kuptohet qartë dhe të zbatohet siç duhet dhe të respektohen masat mbrojtëse procedurale dhe standardet e provave.
65. Disa shtete mund të zgjedhin të integrojnë procedurat e përcaktimit të pashtetësisë brenda kompetencës së autoriteteve të imigracionit. Shtetet e tjera mund të vendosin përcaktimin e pashtetësisë brenda organit përgjegjës për çështjet e shtetësisë, për shembull aplikimet për natyralizim ose verifikimin e kërkesave për shtetësi. Kjo do të ishte veçanërisht e përshtatshme kur individët në fjalë ka të ngjarë të jenë banorë prej kohësh të shtetit.
66. Meqenëse disa persona pa shtetësi mund të jenë gjithashtu refugjatë, shtetet mund të marrin në konsideratë kombinimin e përcaktimit të pashtetësisë dhe të refugjatit në të njëjtën procedurë. Kërkesat e konfidencialitetit për aplikimet nga azili kërkuesit dhe refugjatët

duhet të respektohen pavarësisht nga forma apo vendndodhja e procedurës së përcaktimit të pashtetësisë.⁴³

67. Konsideratat e burimeve, si financiare ashtu edhe njerëzore, do të jenë të rëndësishme në planifikimin e procedurave të përcaktimit të pashtetësisë. Vendet me procedura të përcaktimit të pashtetësisë kanë përjetuar një numër të ulët aplikantësh. Kostot e përfshira mund të balancohen kundrejt kursimeve të bëra nga lirimi i mekanizmave të tjerë administrativë të cilëve mund t'u drejtohen përndryshe personat pa shtetësi, të tilla si kërkesat për forma të tjera të statusit të imigracionit.

(2) Qasja në procedurat

68. Që procedurat të jenë të drejta dhe efikase, duhet të sigurohet qasja në to. Shpërndarja e informacionit, duke përfshirë përmes fushatave informative të shënjestruara, aty ku është e përshtatshme dhe këshillimit mbi procedurat, lehtëson qasjen në mekanizmin për personat pa shtetësi. Duke pasur parasysh se individët ndonjëherë nuk janë në dijeni të procedurave të përcaktimit të pashtetësisë ose hezitojnë të aplikojnë për statusin e pashtetësisë, procedurat mund të përmbajnë në mënyrë të dobishme masa mbrojtëse që lejojnë autoritetet shtetërore të fillojnë një procedurë.
69. Çdokush në territorin e një shteti duhet të ketë qasje në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë. Nuk ka asnjë bazë në Konventë për të kërkuar që aplikantët për përcaktimin e pashtetësisë të jenë ligjërisht brenda një shteti. Një kërkesë e tillë është veçanërisht e padrejtë duke pasur parasysh se mungesa e shtetësisë u mohon shumë personave pa shtetësi vetë dokumentacionin që është i nevojshëm për të hyrë ose për të qëndruar ligjërisht në ndonjë shtet.
70. Nuk ka gjithashtu asnjë bazë në Konventë për të vendosur afate kohore për individët për të kërkuar statusin e pashtetësisë. Afate të tilla mund të përjashtojnë në mënyrë arbitrare individët nga marrja e mbrojtjes së Konventës së 1954-ës.

(3) Garancitë procedurale

71. Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të formalizohen në ligj. Vendosja e procedurave përmes legjislacionit siguron drejtësi, transparencë dhe qartësi. Garancitë procedurale janë elemente themelore të procedurave të përcaktimit të pashtetësisë. Garancitë e procesit të rregullt ligjor që do të integrohen në procedurat e së drejtës administrative, duke përfshirë procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit, janë të nevojshme në këtë kontekst. Prandaj, shtetet inkurajohen të përfshijnë masat mbrojtëse të mëposhtme:

43 Për më shumë detaje mbi koordinimin e procedurave të përcaktimit të refugjatëve dhe të pashtetësisë, ju lutemi shihni paragrafët 78-82.

- informacioni mbi kriteret e pranueshmërisë, procedurën e përcaktimit dhe të drejtat që lidhen me njohjen e pashtetësisë shpërndahet gjerësisht nga autoritetet në një sërë gjuhësh; këshillimi në lidhje me procedurat u ofrohet të gjithë aplikantëve në një gjuhë që ata e kuptojnë;
 - ekziston e drejta për intervistë me një zyrtar vendimmarrës;
 - aplikimet dorëzohen me shkrim dhe ofrohet ndihmë për këtë nëse është e nevojshme;
 - ofrohet asistencë për përkthim/interpretim në lidhje me aplikimet me shkrim dhe intervistat;
 - është e drejta e çdo anëtari të familjes të bëjë një aplikim të pavarur;
 - një i rritur mund të bëjë një aplikim në emër të një fëmije në ngarkim dhe garanci të veçanta procedurale për fëmijët e pashoqëruar janë gjithashtu të disponueshme;
 - një fëmijë ka të drejtë të dëgjohet aty ku ai ose ajo ka aftësinë për të krijuar dhe shprehur një pikëpamje;
 - aplikantët duhet të kenë qasje tek këshilltari ligjor; kur ofrohet ndihma juridike falas, ajo duhet t'u ofrohet aplikantëve pa mjete financiare;
 - bëhen përcaktimet në bazë të meritave individuale të pretendimit duke iu referuar informacionit të vendit në lidhje me ligjin e shtetësisë dhe praktikën në shtetet përkatëse, duke përfshirë informacionin në lidhje me ligjin dhe praktikën gjatë periudhave në të kaluarën të cilat janë të rëndësishme për rastin në shqyrtim;
 - nëse përcaktimi bëhet në një mjedis gjyqësor, procesi është inkuizitor dhe jo kundërshtues;
 - vendimet merren me shkrim me arsyetim;
 - vendimet merren dhe komunikohen brenda një kohe të arsyeshme;
 - ekziston e drejta e ankimit; dhe
 - Qasja në UNHCR është e garantuar.
72. Për të siguruar që procedurat janë të drejta dhe efektive, shtetet duhet të përmbahen nga largimi i një individi nga territori i tyre në pritje të rezultatit të procesit të përcaktimit.
73. E drejta për një intervistë individuale dhe ndihma e nevojshme me përkthim/interpretim gjatë gjithë procesit, janë thelbësore për të siguruar që aplikantët të kenë mundësinë të paraqesin plotësisht çështjet e tyre dhe të japin dhe sqarojnë informacionin që është material për pretendimin. Këto garanci procedurale gjithashtu i lejojnë vendimmarrësit të eksplorojnë çdo paqartësi në një rast individual.

74. Është në interes të të gjitha palëve që përcaktimi i pashtetësisë të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, me kusht që të jetë në dispozicion një kohë e arsyeshme për mbledhjen e provave. Disa vende kanë vendosur afate kohore brenda të cilave autoritetet e përcaktimit duhet të marrin një vendim për një aplikim për pashtetësinë. Në aplikimet ku provat e disponueshme të menjëhershme janë të qarta dhe pretendimi për pashtetësinë është qartazi i bazuar, procedurat e drejta dhe efikase mund të kërkojnë vetëm disa muaj për të arritur një përcaktim përfundimtar.
75. Në përgjithësi, është e padëshirueshme që një vendim i shkallës së parë të jepet më shumë se gjashtë muaj nga paraqitja e një aplikimi pasi kjo zgjat periudhën e kaluar nga një aplikant në një pozicion të pasigurt. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme mund të jetë e përshtatshme të lejohet që procedimi të zgjasë deri në 12 muaj për të siguruar kohë që hetimet në lidhje me statusin e shtetësisë së individit të ndiqen me një shtet tjetër, ku ka të ngjarë që një përgjigje substantive të vijë në atë periudhë.⁴⁴
76. Një e drejtë efektive për ankim kundër një vendimi negativ të shkallës së parë është një garanci thelbësore në një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë. Procedura e ankimit i takon një organi të pavarur. Aplikanti duhet të ketë qasje te këshilltari ligjor dhe, kur ka ndihmë juridike falas, ajo duhet t'u ofrohet aplikantëve pa mjete financiare.
77. Ankimet duhet të jenë të mundshme si në bazë të fakteve ashtu edhe në bazë ligjore, pasi ekziston mundësia që të ketë pasur një vlerësim të gabuar të provave në shkallën e parë. Nëse një organ apeli mund të japë si zëvendësim gjykimin e tij mbi pranueshmërinë sipas Konventës së 1954-ës ose nëse ai thjesht mund të anulojë vendimin e shkallës së parë dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim nga autoriteti përcaktues, kjo është në diskrecionin e shtetit. Zgjedhja do të priret të pasqyrojë qasjen e përgjithshme ndaj çështjeve të tilla në sistemin e tij ligjor/administrativ. Përveç kësaj, shtetet mund të lejojnë një rishikim të mëtejshëm gjyqësor, i cili trajton vetëm çështjet e ligjit dhe mund të kufizohet nga rregullat procedurale të sistemit gjyqësor në fjalë.

⁴⁴ Kjo nënvizon rëndësinë që aplikantët të marrin një standard të përshtatshëm trajtimi gjatë procesit të përcaktimit. Ju lutemi shihni, më tej, pjesën e tretë më poshtë.

C. KOORDINIMI I PËRCAKTIMEVE TË STATUSIT TË REFUGJATIT DHE TË PASHTETËSISË

78. Kur një aplikant ngre një pretendim për të dyja, refugjat dhe pashtetësi, është e rëndësishme që çdo pretendim të vlerësohet dhe që të dy llojet e statusit të njihen në mënyrë eksplicite. Kjo është për shkak se mbrojtja sipas Konventës së vitit 1951 në përgjithësi krijon një grup më të madh të drejtash në nivel kombëtar sesa ajo sipas Konventës së 1954-ës. Megjithatë, mund të ketë raste kur statusi i refugjatit pushon pa e pas fituar personi shtetësinë, gjë që kërkon mbrojtje ndërkombëtare si person pa shtetësi.
79. Meqenëse një person pa shtetësi mund të jetë gjithashtu refugjat ose të ketë të drejtë për një formë plotësuese të mbrojtjes,⁴⁵ Shtetet duhet të sigurojnë që kërkesat e konfidencialitetit për refugjatët që mund të jenë gjithashtu pa shtetësi të respektohen në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë. Çdo aplikant në një procedurë të përcaktimit të pashtetësisë duhet të informohet që në fillim për nevojën për të ngritur shqetësime lidhur me çështjen e refugjatit, nëse ato ekzistojnë.⁴⁶ Identiteti i një refugjati ose i një azilkërkuar nuk duhet t'u zbulohet autoriteteve të vendit të origjinës të individit. Siç diskutohet më poshtë në paragrafët 96-99, zyrtarëve të përcaktimit të pashtetësisë mund t'u kërkohej të bëjnë hetime me autoritetet e huaja në lidhje me aplikantët, gjë që mund të rrezikojë konfidencialitetin për të cilin kanë të drejtë refugjatët dhe azilkërkuarët. Kur ky është rasti, përcaktimi i statusit të refugjatit duhet të vazhdojë dhe shqyrtimi i kërkesës për pashtetësinë të pezullohet.
80. Kur përcaktimet e statusit të refugjatit dhe të pashtetësisë kryhen në procedura të veçanta dhe përcaktimi i pashtetësisë mund të bëhet pa kontaktuar autoritetet e vendit të origjinës, të dyja procedurat mund të vazhdojnë paralelisht. Megjithatë, për të maksimizuar efikasitetin, ku gjetjet e fakteve nga një procedurë mund të përdoren në tjetrën, mund të jetë e përshtatshme që fillimisht të kryhen intervista dhe të mblidhen dhe vlerësohen informacionet e vendit për procedurën e përcaktimit të refugjatit.
81. Në mënyrë të ngjashme, në një procedurë që kombinon përcaktimin e refugjatit dhe të pashtetësisë dhe një aplikant ngre të dyja pretendimet, është e rëndësishme që ekzaminuesi të kryejë së bashku përcaktimin e refugjatit dhe të pashtetësisë.⁴⁷ Nëse nuk ka

45 Ju lutemi shihni Konkluzionin e Komitetit Ekzekutiv nr.103 (LVI) të vitit 2005 mbi format plotësuese të mbrojtjes, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/43576e292.html>

46 Në mënyrë të ngjashme, aplikantët për statusin e refugjatit duhet të informohen për mundësinë e aplikimit për njohje si person pa shtetësi.

47 Përcaktimi i statusit të refugjatit kërkon identifikimin ose të vendit të shtetësisë së një individi ose, për personat pa shtetësi, të vendit të banimit të mëparshëm të zakonshëm për qëllime të vlerësimit të frikës së një individi nga persekutimi. Ju lutemi shihni paragrafët 87-93 dhe 101-105, UNHCR, *Doracak dhe Udhëzime mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit*, HCR/1P/4/ENG/REV.3, Dhjetor 2011, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/4f33c8d92.html>

informacion të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se një individ është pa shtetësi pa kontaktuar autoritetet e një shteti të huaj, do të vazhdojë përcaktimi i statusit të refugjatit.

82. Si në procedurat e veçanta ashtu edhe në ato të kombinuara, në rrethana të caktuara duhet të jetë e mundur që një individ të riaktivizojë një pretendim të pezulluar për pashtetësinë. Kërkesa për pashtetësinë mund të riaktivizohet në rast se:

- pretendimi për refugjatat dështon;
- statusi i refugjatit njihet por më pas pushon;
- statusi i refugjatit anulohet sepse kriteret e përfshirjes të nenit 1A(2) të Konventës së vitit 1951 nuk janë përmbushur;⁴⁸ ose
- nëse dalin prova shtesë se një individ është pa shtetësi.

Konsiderata të ngjashme vlejnë për individët me pretendime si për statusin e pashtetësisë ashtu edhe për një formë plotësuese të mbrojtjes.

D. VLERËSIMI I PROVAVE

(1) Llojet e provave

83. Përcaktimi i pashtetësisë kërkon një vlerësim të përzier të faktit dhe ligjit. Raste të tilla nuk mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet analizës së ligjeve të shtetësisë pasi përkufizimi i një personi pa shtetësi kërkon një vlerësim të zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë, duke përfshirë masën në të cilën vendimet gjyqësore respektohen nga zyrtarët qeveritarë.⁴⁹ Llojet e provave që mund të jenë relevante mund të ndahen në dy kategori: prova që kanë të bëjnë me rrethanat personale të individit dhe prova në lidhje me ligjet dhe rrethanat e tjera në vendin në fjalë.

84. Provat në lidhje me historinë personale ndihmojnë në identifikimin e shteteve dhe procedurave të shtetësisë që duhet të merren parasysh në përcaktimin e statusit të shtetësisë së një aplikanti.⁵⁰ Në çdo rast, lista e mëposhtme jo shëruese e llojeve të provave mund të jetë relevante:

- dëshmia e aplikantit (p.sh. aplikimi me shkrim, intervista);
- përgjigje(t) nga një autoritet i huaj ndaj pyetjeve (kërkim informacioni) në lidhje me statusin e shtetësisë së një individ;
- dokumentet e identitetit (p.sh. çertifikata e lindjes, ekstrakti nga regjistri civil, karta e identitetit kombëtare, dokumenti i regjistrimit të votuesit);

⁴⁸ Ju lutemi shihni UNHCR, *Note on the Cancellation of Refugee Status* (Dokument mbi Anulimin e Statusit të Refugjatit), 22 Nëntor 2004, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/41a5dfd94.html>

⁴⁹ Kjo është diskutuar në paragrafin 48 më sipër.

⁵⁰ Ju lutemi shihni paragrafin 92 më poshtë.

- dokumentet e udhëtimit (përfshirë ato të skaduara);
- dokumentet në lidhje me aplikimet për fitimin e shtetësisë ose marrjen e dëshmisë së shtetësisë;
- certifikata e natyralizimit;
- certifikata e heqjes dorë nga shtetësia;
- përgjigjet e mëparshme nga shtetet ndaj pyetjeve mbi shtetësinë e aplikantit;
- certifikata e martesës;
- Dëshmia e shërbimit ushtarak/certifikata e lirimit;
- certifikatat e shkollës;
- certifikatat/regjistrat mjekësorë (p.sh. vërtetimet e lëshuara nga spitali për lindjen, librezat e vaksinimit);
- Dokumentet e identitetit dhe të udhëtimit të prindërve, bashkëshortit dhe fëmijëve;
- dokumentet e imigracionit, të tilla si lejet e qëndrimit të vendit(eve) të banimit të zakonshëm;
- dokumente të tjera që kanë të bëjnë me vendet e banimit (për shembull, dokumentet e punësimit, aktet e pronës, marrëveshjet e qirasë, evidenca shkollore, certifikatat e pagëzimit); dhe
- procesverbali i dëshmisë gojore nën betim të fqinjëve dhe anëtarëve të komunitetit.

85. Informacioni në lidhje me rrethanat në vendin ose vendet në shqyrtim mbulon provat në lidhje me ligjin për shtetësinë dhe ligjet e tjera përkatëse, zbatimin e tyre dhe praktikën e shteteve përkatëse, si dhe mjedisin e përgjithshëm ligjor në ato juridiksione në lidhje me respektimin nga dega ekzekutive për vendimet gjyqësore. Mund të merret nga burime të ndryshme, qeveritare dhe joqeveritare. Kompleksiteti i ligjit të shtetësisë dhe praktikës në një shtet të caktuar mund të justifikojë përdorimin e provave të ekspertëve në disa raste.

86. Që një informacion i tillë në lidhje me vendin të trajtohet si i saktë, ai duhet të merret nga burime të besueshme dhe të paanshme, mundësisht më shumë se një. Kështu, preferohet informacioni i marrë nga organet shtetërore të përfshira drejtpërdrejt në mekanizmat e shtetësisë në shtetin përkatës, ose aktorët joshtetërore që kanë krijuar ekspertizë në monitorimin ose shqyrtimin e çështjeve të tilla. Është e rëndësishme që informacioni në lidhje me shtetin të përditësohet vazhdimisht në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në ligjin e shtetësisë dhe praktikën në vendet përkatëse. Në këtë mënyrë, informacioni në lidhje me vendin, i cili shërben si mbështetje duhet të jetë i njëkohshëm me ngjarjet e shtetësisë që janë në shqyrtim në rastin në fjalë. Përveç kësaj, kur praktika e zyrtarëve të përfshirë në zbatimin e ligjeve të shtetësisë së një shteti duket se ndryshon sipas rajonit, kjo duhet të merret parasysh në lidhje me provat e lidhura me vendin të cilat shërbejnë si mbështetje.

(2) Çështjet e provës

87. Autoritetet që ndërmarrin procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të marrin në konsideratë të gjitha provat e disponueshme, me gojë dhe me shkrim, në lidhje me pretendimin e një individi.
88. Përkufizimi i personit pa shtetësi në nenin 1(1) të Konventës së vitit 1954 kërkon prova të një negativi – që një individ nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet sipas veprimit të ligjit të tij. Kjo paraqet sfida të rëndësishme për aplikantët dhe informon se si duhet të zbatohen rregullat e provave në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë.

(3) Barra e provës

89. Barra e provës në procedurat ligjore i referohet pyetjes se cila palë mban përgjegjësinë për të provuar një pretendim ose pohim. Në mënyrë tipike në procedurat administrative ose gjyqësore, një pretendues mban një përgjegjësi fillestare në vërtetimin e pretendimit të tij/saj. Në rastin e përcaktimit të pashtetësisë, barra e provës në parim është e përbashkët, në kuptimin që si aplikanti ashtu edhe ekzaminuesi duhet të bashkëpunojnë për të marrë prova dhe për të vërtetuar faktet. Procedura është një procedurë bashkëpunuese që synon të sqarojë nëse një individ hyn në fushëveprimin e Konventës së 1954-ës. Kështu, aplikanti ka për detyrë të jetë i sinqertë, të japë një përshkrim sa më të plotë të pozicionit të tij ose të saj dhe të paraqesë të gjitha provat e disponueshme në mënyrë të arsyeshme. Në mënyrë të ngjashme, autoriteti përcaktues kërkohet të marrë dhe të paraqesë të gjitha provat përkatëse të disponueshme në mënyrë të arsyeshme për të, duke mundësuar një përcaktim objektiv të statusit të aplikantit. Kjo qasje jo kundërshtuese mund të gjendet në praktikën e një numri shtetesh që tashmë zbatojnë procedurat e përcaktimit të pashtetësisë.
90. Duke pasur parasysh natyrën e pashtetësisë, aplikantët për statusin e pashtetësisë shpesh nuk janë në gjendje të vërtetojnë pretendimin me shumë, apo fare, prova dokumentare. Autoritetet për përcaktimin e pashtetësisë duhet ta marrin parasysh këtë, kur është e përshtatshme duke i dhënë konsideratë dashamirëse shpjegimeve dëshmuuese në lidhje me mungesën e llojeve të caktuara të provave.⁵¹

(4) Standardi i provës

91. Ashtu si me barrën e provës, standardi i provës ose pragu i provave të nevojshme për të përcaktuar pashtetësinë duhet të marrë parasysh vështirësitë e qenësishme në vërtetimin e pashtetësisë, veçanërisht në dritën e pasojave të refuzimit të gabuar të një aplikimi. Kërkimi i një standardi të lartë të provës së pashtetësisë do të minonte objektin dhe qëllimin e

Konventës së 1954-ës. Prandaj, shtetet këshillohen të miratojnë të njëjtin standard prove si ai që kërkohet në përcaktimin e statusit të refugjatit, domethënë, një gjetje e pashtetësisë

⁵¹ Fleksibilitet i mëtejshëm kërkohet gjithashtu kur është e vështirë për individët të marrin dokumente që vijnë nga një autoritet i huaj të noterizuar siç duhet ose të vulosura me vula zyrtare.

do të arsyetohej kur vërtetohet në një "shkallë të arsyeshme" që një individ nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet sipas veprimit të ligjit të tij.⁵²

92. Mungesa e shtetësisë nuk ka nevojë të përcaktohet në lidhje me çdo shtet në botë. Është e nevojshme të merren parasysh vetëm ato shtete me të cilat një individ ka një lidhje përkatëse, përgjithësisht në bazë të lindjes në territor, prejardhjes, martesës, birësimi ose banimit të zakonshëm.⁵³ Megjithatë, pashtetësia nuk do të përcaktohet në një shkallë të arsyeshme kur autoriteti i përcaktimit është në gjendje të tregojë prova të qarta se individ është shtetas i një shteti të identifikuar. Një provë e tillë e shtetësisë mund të marrë formën, për shembull, të konfirmimit me shkrim nga autoriteti kompetent përgjegjës për vendimet e natyralizimit në një vend tjetër që aplikanti është shtetas i atij shteti nëpërmjet natyralizimit ose informacionit që përcakton se sipas ligjit të shtetësisë dhe praktikës së një shteti tjetër aplikanti ka fituar automatikisht shtetësinë atje.⁵⁴
93. Kur një aplikant nuk bashkëpunon në vërtetimin e fakteve, për shembull duke fshehur qëllimisht informacionin që mund të përcaktojë identitetin e tij ose të saj, atëherë ai ose ajo mund të dështojë të vërtetojë në një shkallë të arsyeshme se ai ose ajo është pa shtetësi edhe nëse autoriteti i përcaktimit nuk është në gjendje të demonstrojë prova të qarta të një shtetësie të caktuar. Prandaj, aplikimi mund të refuzohet, përveç rasteve kur provat e disponueshme vërtetojnë pashtetësinë në një shkallë të arsyeshme.⁵⁵ Megjithatë, raste të tilla duhet të dallohen nga rastet kur një aplikant nuk është në gjendje, krahasuar me nuk është i gatshëm, të paraqesë prova mbështetëse dhe/ose dëshmi rreth historisë së tij personale.

(5) Peshimi i provave

94. Kur paraqiten prova autentike dokumentare në lidhje me historinë personale të një individ në një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë, këto prova zakonisht kanë përparësi ndaj dëshmisë së atij individ në arritjen e një përfundimi mbi pashtetësinë. Kur paraqiten prova të kufizuara ose nuk paraqiten fare prova dokumentare në lidhje me rrethanat personale të një individ, megjithatë, do t'i jepet peshë shtesë dëshmisë me shkrim dhe/ose gojore të një aplikanti, informacionit të disponueshëm të vendit dhe çdo rezultati të hetimeve shtesë me

shtetet përkatëse. Udhëzimi në paragrafët e mëposhtëm mbi peshën që duhet t'i jepet llojeve të caktuara të provave që zakonisht do të merren në konsideratë në përcaktimet e

⁵² Ju lutemi shihni paragrafin 42, *Doracak dhe Udhëzues mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit*, shënimi 47 më lart. Në kontekstin e përcaktimit të statusit të refugjatit, një individ mund të pretendojë një frikë të bazuar nga persekutimi duke vërtetuar "në një shkallë të arsyeshme, se qëndrimi i tij i vazhdueshëm në vendin e tij të origjinës është bërë i patolerueshëm për të për arsyt e përmendura në përkufizimin e [refugjatit]."

⁵³ Ju lutemi shihni paragrafin 18 më lart.

⁵⁴ Ju lutemi shihni paragrafët 27 deri 44 më lart mbi trajtimin e provave nga shtetet e tjera, duke përfshirë nga autoritetet e tyre konsullore.

⁵⁵ Ju lutemi shihni seksionin 9 më poshtë mbi Çështjet e Besueshmërisë.

pashtetësisë duhet të lexohet së bashku me udhëzimet për këtë çështje që gjenden në pjesën e parë më lart.

(6) Pasaportat

95. Pasaportat autentike dhe të paskaduara ngrenë prezumimin se mbajtësi i pasaportës është shtetas i vendit që lëshon pasaportën. Megjithatë, ky prezumim mund të hidhet poshtë kur ka prova që tregojnë se një individ nuk konsiderohet realisht shtetas i një shteti, për shembull kur dokumenti është një pasaportë e konvencioneve ose kur pasaporta është lëshuar gabimisht nga një autoritet që nuk është kompetent për të përcaktuar çështjet e shtetësisë. Në raste të tilla, pasaporta nuk është një manifestim i pozicionit të një shteti se individ është një nga shtetasit e tij. Asnjë prezumim nuk ngrihet nga pasaportat që janë të falsifikuara ose të lëshuara ndryshe me mashtrim.⁵⁶

(7) Kërkesat për informacion dhe përgjigjet nga autoritetet e huaja

96. Informacioni i dhënë nga autoritetet e huaja ndonjëherë është i një rëndësie qendrore për procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, edhe pse jo i nevojshëm në rastet kur ka prova të përshtatshme përndryshe. Në asnjë rrethanë nuk duhet të bëhet kontakt me autoritetet e një shteti kundër të cilit një individ pretendon një frikë të bazuar nga persekutimi, përveç nëse është konkluduar përfundimisht se ai ose ajo nuk është as refugjat dhe as nuk ka të drejtë për një formë plotësuese të mbrojtjes.
97. Fleksibiliteti mund të jetë i nevojshëm në lidhje me procedurat për të bërë kontakte me autoritetet e huaja për të konfirmuar nëse një individ është ose jo shtetas i tij. Disa autoritete të huaja mund të pranojnë kërkesa që vijnë drejtpërdrejt nga një shtet tjetër, ndërsa të tjera mund të tregojnë se do t'u përgjigjen vetëm kërkesave nga individë.⁵⁷
98. Kur autoritetet për përcaktimin e pashtetësisë bëjnë pyetje me autoritetet e huaja në lidhje me statusin e shtetësisë ose pashtetësisë së një individ, ato duhet të marrin parasysh peshën që duhet t'i kushtohet përgjigjes ose mungesës së përgjigjes nga shteti në fjalë.⁵⁸
99. Kur një përgjigje nga një autoritet i huaj përfshin arsyetim që duket se përfshin një gabim në zbatimin e ligjit vendas për faktet e rastit ose një gabim në vlerësimin e fakteve,

përgjigja duhet të merret si e mirëqenë. Është pozicioni subjektiv i shtetit tjetër ai që është kritik në përcaktimin nëse një individ është shtetas i tij për qëllimet e përkufizimit të personit

⁵⁶ Për këto çështje, ju lutemi shihni edhe paragrafët 45 dhe 46 më lart.

⁵⁷ Shtetet mund të dëshirojnë të krijojnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për të bërë pyetje (kërkuar informacion) për shtetësinë. Një shembull i një marrëveshjeje të tillë është Konventa e vitit 1999 për lëshimin e një certificate të shtetësisë, në të cilën shtetet anëtare të Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, Bashkimit Evropian ose Këshillit të Evropës mund të aderojnë.

⁵⁸ Udhëzimet për këtë çështje janë dhënë në paragrafin 41 më lart.

pa shtetësi.⁵⁹ Nëse këtë e lejon koha, autoritetet për përcaktimin e pashtetësisë mund të jenë në gjendje të ngrenë shqetësime të tilla me autoritetin e huaj me shpresën për të marrë një qartësi më të madhe rreth statusit të shtetësisë së individit. Në të vërtetë, në disa raste kjo mund të rezultojë që autoriteti i huaj të pranojë me vonesë se individ është shtetas i tij ose të pranojë se ai ose ajo ka të drejtë të fitojë shtetësinë.

(8) Intervistat

100. Një intervistë me një aplikant është një mundësi e rëndësishme për vendimmarrësin që të shqyrtojë çdo pyetje në lidhje me provat e paraqitura. Pyetjet e hapura, të parashtuara në një atmosferë jo kundërshtuese, mund të krijojnë një "klimë besimi"⁶⁰ duke i inkurajuar aplikantët të japin një rrëfim sa më të plotë që të jetë e mundur.⁶¹ Aplikantëve duhet t'u kujtohet që në fillim të intervistës se ata kanë për detyrë të bashkëpunojnë me procedurat. Në këtë mënyrë, nga një aplikant mund të pritët vetëm që të përgjigjet sipas aftësive të tij ose të saj më të mira dhe në shumë raste mund të mos dihet edhe informacioni bazë, për shembull vendi i lindjes ose nëse lindja është regjistruar. Ndërsa një intervistë normalisht do të jetë e mjaftueshme për të nxjerrë historinë e aplikantit, ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të kryhen intervista vijuese.

(9) Çështjet e besueshmërisë

101. Besueshmëria e deklaratave të një aplikanti nuk do të jetë problematike gjatë procedurave të përcaktimit të pashtetësisë, ku mund të arrihet një përcaktim mbi bazën e provave dokumentare të disponueshme kur vlerësohet në dritën e informacionit përkatës në lidhje me vendin. Megjithatë, aty ku ka pak ose aspak prova dokumentare të disponueshme, autoritetet për përcaktimin e pashtetësisë do të duhet të mbështeten në një shkallë më të madhe në dëshminë e një aplikanti dhe mund të lindin çështje që lidhen me besueshmërinë e rrëfimit të aplikantit. Në vlerësimin nëse deklaratat mund të konsiderohen të besueshme, vendimmarrësi mund të marrë në konsideratë treguesit objektivë të besueshmërisë, përkatësisht, specificitetin dhe mjaftueshmërinë e detajeve të ofruara, konsistencën në rrëfimin e aplikantit duke përfshirë deklaratat e tij ose të saj me shkrim dhe me gojë, përputhjen e deklaratave të aplikantit me ato të dëshmitarëve ose anëtarëve të familjes, përputhshmëria me informacionin e vendit të origjinës dhe besueshmëria e deklaratave.
102. Një aplikant mund të pritët të ketë vetëm një nivel njohurish që është i arsyeshëm duke marrë parasysh faktorë të tillë si niveli i arsimimit dhe mosha e aplikantit në kohën e ngjarjeve përkatëse. Ligjet e shtetësisë dhe zbatimi i tyre mund të jenë komplekse. Një aplikant nuk

⁵⁹ Ju lutemi, shihni paragrafët 45 dhe 46, të cilët vënë në dukje se një gabim në zbatimin e ligjit vendor në rastin e një individ është i parëndësishëm në përcaktimin e pozicionit të shtetit.

⁶⁰ Ju lutemi shihni paragrafin 200, *Doracak dhe Udhëzime për Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit*, shënimi 47 më lart.

⁶¹ Teknikat e intervistimit diskutohen më në përgjithësi në UNHCR, *Intervistimi i Aplikantëve për Statusin e Refugjatit*, RLD 4, 1995, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/3ccea3304.pdf>. Ju lutemi shihni gjithashtu UNHCR, *Përtej provave, Vlerësimi i Besueshmërisë në Sistemet e Azilit të BE-së: Përmbledhje*, 2013, <http://www.refworld.org/docid/51a704244.html>, page 24.

do të jetë domosdoshmërisht në gjendje të shpjegojë qartë pse një vendim i caktuar është marrë nga autoritetet ose cila është praktika e shtetësisë në vendet në shqyrtim. Kur identiteti etnik i një aplikanti është material për përcaktimin, testimi i njohurive të tij/saj për praktikat kulturore ose gjuhët duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, nivelet e ndryshme të edukimit dhe të kuptuarit të traditave. Evaziviteti i vazhdueshëm i pashpjegueshëm në pyetjet kyçe mund të ngrejë në mënyrë legjitime shqetësime rreth besueshmërisë së një individi në këto aspekte të dëshmisë së tij ose të saj. Kjo është edhe më e shprehur kur një individ refuzon, pa dhënë asnjë arsye, t'u përgjigjet pyetjeve të caktuara.

103. Kur përcaktohet nëse rrëfimi i një aplikanti është i besueshëm, një vendimmarrës duhet të vlerësojë nëse historia e paraqitur është konsistente nga brenda. Ajo gjithashtu duhet të jetë në përputhje me informacionin e besueshëm në lidhje me ligjin e shtetësisë dhe praktikën në vendet përkatëse dhe nëse ajo vërtetohet nga ndonjë provë dokumentare ose provë tjetër në dispozicion. Besueshmëria nuk cenohet nga mospërputhjet e vogla në rrëfimin e aplikantit, veçanërisht kur këto nuk janë materiale për pretendimin ose kanë të bëjnë me ngjarje që kanë ndodhur shumë vite më parë. Kur dëshmia e aplikantit duket se bie ndesh me provat në lidhje me vendin në fjalë, është e rëndësishme të verifikohet se nuk ka divergjenca rajonale ose praktika diskriminuese në bazë të përkatësisë politike, etnisë, fesë ose arsyeve të tjera në aplikimin e mekanizmit të shtetësisë në fjalë nga zyrtarët e atij shteti.
104. Sjellja e një aplikanti nuk është një tregues i besueshëm i besueshmërisë. Një person pa shtetësi mund të ketë duruar diskriminim të konsiderueshëm si rezultat i mungesës së shtetësisë, duke e bërë atë të sillet i shqetësuar, i rezervuar ose defanziv në çdo intervistë. Dallimet kulturore midis aplikantit dhe vendimmarrësit gjithashtu shpesh pengojnë një interpretim të saktë të formave specifike të sjelljes.
105. Konkluzionet negative nuk duhet të nxirren kur një individ nuk ka pasur mundësinë, në një mjedis të përshtatshëm interviste, të shpjegojë ose sqarojë ndonjë boshllëk, kontradiktë ose mospërputhje të dukshme në rrëfimin e tij ose të saj.
106. Besueshmëria e fakteve materiale të pretendimit përcaktohet duke iu referuar treguesve të besueshmërisë, duke marrë parasysh çdo shpjegim të arsyeshëm të dhënë nga aplikanti për problemet në dukje të besueshmërisë dhe duke pasur parasysh rrethanat e tij/saj individuale. Nëse, pas shqyrtimit të duhur të deklaratave të një aplikanti dhe të gjitha provave të tjera në dispozicion, megjithatë mbetet një element dyshimi në lidhje me besueshmërinë e një fakti të pohuar relevant dhe nuk ka prova të tjera për të mbështetur

atë fakt, vendimmarrësi duhet të shqyrtojë nëse është e përshtatshme të zbatohet parimi i “prezumimit si i besueshëm pavarësisht dyshimeve”.⁶²

⁶² Ju lutemi shihni, në një kontekst tjetër, diskutimin e parimit të "prezumimit të besueshmërisë" në Përtej provave, *Vlerësimi i besueshmërisë në sistemet e azilit të BE-së: Përmbledhje*, shënimi 61 më lart, veçanërisht në faqen 44.

107. Edhe kur elementeve materiale të deklaratave të aplikantit konstatohet se u mungon besueshmëria, kjo nuk e përjashton përcaktimin e pashtetësisë. Dëshmia e një individi duhet të vlerësohet ende në dritën e të gjitha provave të tjera, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendet në fjalë, të cilat mund të mbështesin ende një konstatim të pashtetësisë.⁶³

E. KONSIDERATAT SHITESË PROCEDURALE

(1) Përcaktimi grupor

108. Duke pasur parasysh natyrën e pashtetësisë, procedurat e individualizuara janë normë pasi ato lejojnë eksplorimin e rrethanave personale të aplikantit. Vendet që kanë miratuar deri tani procedurat e përcaktimit të pashtetësisë kanë ndjekur këtë qasje. Shumica e tyre janë palë në Konventën e vitit 1954 dhe po vlerësojnë shtetësinë/pashtetësinë në raport me individët e pranishëm në një kontekst migrim.
109. Megjithatë, është e mundur që t'u jepet statusi i personit pa shtetësi individëve brenda një grupi mbi baza *prima facie*,⁶⁴ pra, pa ndërmarrë një përcaktim të plotë të statusit individual. Kjo mund të jetë e përshtatshme kur ka informacion të gatshëm dhe objektiv në lidhje me mungesën e shtetësisë së anëtarëve të një grupi, ashtu që ata prima do të përmbushnin *prima facie* përkufizimin e personit pa shtetësi në nenin 1(1) të Konventës së 1954-ës. Në mungesë të provave të kundërta, pranueshmëria e një individi për mbrojtje sipas Konventës do të bazohet në faktin nëse ai ose ajo është anëtar i një grupi të identifikuar që përmbush përkufizimin e nenit 1(1).
110. Njohja *prima facie* nuk është një kategori shtesë ose status më i vogël, por më tepër pasqyron një vlerësim efikas të provave që çon në njohje sipas Konventës së 1954-ës. Si persona pa shtetësi, ata përfitojnë nga të drejtat që i bashkëngjiten atij statusi deri në përfundimin e këtij statusi. Ashtu si me mekanizmat individualë të përcaktimit, duhet të ketë një mjet juridik efektiv për individët në një grup për të sfiduar një konstatim *prima facie* negativ për çështjen e statusit.
111. Përcaktimi grupor duhet të mundësoj shqyrtimin e klauzolave të përjashtimit të përcaktuara në nenin 1(2) të Konventës së 1954-ës në baza individuale. Personat që përfshihen në nenin

⁶³ Një qasje e ngjashme zbatohet në përcaktimin e statusit të refugjatit. Ju lutemi shihni paragrafin 42 të *Doracakut dhe Udhëzuesit mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit*, shënimi 47 më lart. Duke pasur parasysh natyrën e përkufizimit të pashtetësisë, çështjet e besueshmërisë kanë më pak gjasa të parandalojnë një konstatim të pashtetësisë sesa në përcaktimin e statusit të refugjatit.

⁶⁴ Teknika *prima facie* përdoret në përcaktimin e statusit të refugjatit, zakonisht në një kontekst grupor. Por është aplikuar edhe në përcaktimet individuale.

1(2) nuk do të kenë të drejtën e mbrojtjes së Konventës së vitit 1954 edhe pse ata plotësojnë përkufizimin e personit pa shtetësi të përcaktuar në nenin 1(1) të atij instrumenti.⁶⁵

(2) Ndalimi

112. Ndalimi rutinë i individëve që kërkojnë mbrojtje për shkak të pashtetësisë është arbitrar.⁶⁶ Pashtetësia, nga vetë natyra e saj, kufizon rreptësisht qasjen në dokumentet bazë të identitetit dhe të udhëtimit që shtetasit posedojnë normalisht. Për më tepër, personat pa shtetësi janë shpesh pa një vendbanim të ligjshëm në asnjë vend. Kështu, të qenit pa dokumente ose mungesa e lejeve të nevojshme të imigracionit nuk mund të përdoret si një justifikim i përgjithshëm për ndalimin e këtyre personave. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("ICCPR"), që garanton të drejtën për liri

dhe siguri të personit, ndalon ndalimin e paligjshëm dhe arbitrar. Që ndalimi të jetë i ligjshëm, ai duhet të rregullohet nga ligji i brendshëm, mundësisht me kufijtë maksimalë të vendosur për një ndalim të tillë dhe t'i nënshtrohet rishikimit periodik dhe gjyqësor. Që ndalimi të mos jetë arbitrar, duhet të jetë i nevojshëm në çdo rast individual, i arsyeshëm në

⁶⁵ Neni 1(2) ka të bëjë me personat që nuk meritojnë mbrojtje qoftë sepse kanë një rrugë alternative për mbrojtjen ose për shkak të sjelljes së tyre:

2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për:

(i) Personat që aktualisht marrin mbrojtje ose ndihmë nga organe ose agjenci të Kombeve të Bashkuara, përveç Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, për sa kohë që ata marrin një mbrojtje ose ndihmë të tillë;

(ii) Personat që njihen nga autoritetet kompetente të vendit në të cilin kanë zënë banim se kanë të drejtat dhe detyrimet që i bashkëngjiten zotërimit të shtetësisë së atij vendi;

(iii) Personat në lidhje me të cilët ka arsye serioze për të konsideruar se:

(a) kanë kryer një krim kundër paqes, një krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të caktuar dispozita në lidhje me krime të tilla; (b) kanë kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë vendit të banimit të tyre përpara pranimit të tyre në atë vend; (c) kanë qenë fajtorë për veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

⁶⁶ Ju lutemi shihni, në lidhje me ndalimin e imigracionit në përgjithësi, qëndrimin e mbajtur nga Grupi i Punës i OKB-së për ndalimin arbitrar: (58)...konsideron se ndalimi i imigracionit duhet të hiqet gradualisht. Emigrantët në situatë të parregullt nuk kanë kryer asnjë krim. Kriminalizimi i migracionit të parregullt tejkalon interesat legjitime të shteteve në mbrojtjen e territoreve të tyre dhe rregullimin e flukseve të parregullta të migracionit. (59) Nëse duhet të ketë ndalim administrativ, parimi i proporcionalitetit kërkon që ai të jetë zgjidhja e fundit. Duhet të respektohen kufizime të repta ligjore dhe të sigurohen masa mbrojtëse gjyqësore. Arsyet e paraqitura nga shtetet për të justifikuar ndalimin, siç është nevoja e identifikimit të migrantit në një situatë të parregullt, rreziku i arratisjes ose lehtësimi i dëbimit të një migranti të parregullt të cilit i është dhënë një urdhër largimi, duhet të përcaktohen qartë dhe të numërohen në mënyrë shteruese në legjislacion. Grupi i Punës i OKB-së për Ndalimin Arbitrar, Raport për Këshillin e të Drejtave të Njeriut, A/HRC/13/30, 18 janar 2010, <http://www.refworld.org/docid/502e0fa62.html> Në lidhje me personat pa shtetësi, ju lutemi shihni Konkluzionin 106 të Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së (LV1) të vitit 2006 mbi identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, <http://www.unhcr.org/453497302.html> i cili "u bën thirrje shteteve që të mos ndalojnë personat pa shtetësi mbi bazën e vetme të të qenit pa shtetësi dhe t'i trajtojnë ata në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ...".

të gjitha rrethanat, proporcional dhe jodiskriminues. Format e ndalimit për kohë të pacaktuar si dhe të detyrueshme janë në vetvete arbitrare.⁶⁷

113. Prandaj, ndalimi është një masë e fundit dhe mund të justifikohet vetëm kur masat e tjera më pak invazive ose shtrënguese janë konsideruar dhe janë gjetur të pamjaftueshme për të mbrojtur objektivin e ligjshëm qeveritar të ndjekur me anë të ndalimit. Alternativat e ndalimit nga kërkesat e raportimit ose sistemet e lirimimit me kusht/garanci deri te mbikëqyrja e strukturuar e komunitetit dhe/ose programet e menaxhimit të rasteve – janë pjesë e çdo vlerësimi të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të ndalimit. Parimet e përgjithshme në lidhje me ndalimin zbatohen a *fortiori* për fëmijët të cilët, si rregull, nuk duhet të ndalohen në asnjë rrethanë.
114. Kur personat që presin përcaktimin e pashtetësisë janë të ndaluar, ata nuk duhet të mbahen me kriminelë të dënuar ose individë në pritje të gjykimit.⁶⁸ Për më tepër, mbikëqyrja gjyqësore e ndalimit është gjithmonë e nevojshme dhe individët e ndaluar duhet të kenë qasje në përfaqësimin ligjor, duke përfshirë këshillim falas për ata që nuk kanë mjete.
115. Për personat pa shtetësi, mungesa e procedurave të përcaktimit të statusit për të verifikuar identitetin ose shtetësinë mund të çojë në ndalim të zgjatur ose me kohë të pacaktuar. Prandaj, procedurat e përcaktimit të pashtetësisë janë një mekanizëm i rëndësishëm për të reduktuar rrezikun e ndalimit të zgjatur dhe/ose arbitrar.

⁶⁷ Ju lutemi shihni vendimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në *van Alpen kundër Holandës*, Komunikimi nr. 305/1988, 23 korrik 1990,

<http://www.refworld.org/docid/525414304.html> paragrafi 5.8; A kundër Australisë, CCPR/ C/59/D/560/1993, 30 prill 1997, <http://www.refworld.org/docid/3ae6b71a0.html> paragrafi 9.4; dhe *Danyal Shafiq kundër Australisë*, CCPR/C/88/D/1324/2004, 13 nëntor 2006, <http://www.refworld.org/docid/47975af921.html> paragrafi 7.3. Në kontekstin e refugjatëve, Konkluzioni i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së 44 (XXXVII) i vitit 1986 mbi ndalimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve, i disponueshëm në: <http://www.refworld.org/docid/3ae68c43c0.html> thekson se ndalimi i azilkërkuesve normalisht duhet të shmanget, por nëse është e nevojshme duhet të ndodhë vetëm në baza të përcaktuara me ligj për të përcaktuar identitetin e individit; për të marrë faktet themelore të çështjes; kur një individ ka shkatërruar qëllimisht dokumentacion ose ka paraqitur dokumentacion mashtrues për të mashtruar autoritetet;

dhe/ose ku ka shqetësime të sigurisë kombëtare ose rendit publik. Ju lutemi shihni gjithashtu UNHCR, "Udhëzimet mbi kriteret dhe standardet e aplikueshme në lidhje me ndalimin e azilkërkuesve dhe alternativat e ndalimit", 2012, <http://www.unhcr.org/505b10ee9.html>

⁶⁸ Ju lutemi shihni udhëzimet e ngjashme në lidhje me ndalimin e azilkërkuesve, *po aty*.

(3) Roli i UNHCR-së

116. UNHCR-ja ndihmon shtetet në mënyra të ndryshme për të përmbushur mandatin e saj të pashtetësisë.⁶⁹ Duke u mbështetur në njohuritë e saj krahasuese për procedurat e përcaktimit të pashtetësisë në një sërë shtetesh dhe përvojën e saj në vlerësimin e pashtetësisë dhe shtetësisë, UNHCR mund të këshillojë si për zhvillimin e procedurave të reja të përcaktimit të pashtetësisë ashtu dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.⁷⁰ Përveç kësaj, UNHCR mund të lehtësojë hetimet e bëra nga autoritetet e përcaktimit të pashtetësisë me autoritetet e shteteve të tjera dhe mund të veprojë si një burim informacioni mbi ligjet e shtetësisë dhe praktikat.⁷¹ Qasja për aplikantët në UNHCR gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e paanshmërisë së procedurave të përcaktimit. Së fundi, UNHCR mund të kryejë vetë përcaktimin e pashtetësisë në nivel individual dhe/ose grupor nëse është e nevojshme.

(4) Eksplorimi i zgjidhjeve jashtë vendit

117. Disa aplikantë në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë mund të kenë një perspektivë realiste pranimi ose ripranimi në një shtet tjetër, në disa raste nëpërmjet fitimit ose rifitimit të shtetësisë. Këto raste, të cilat prirën të lindin kur individët kërkojnë përcaktimin e pashtetësisë në një kontekst migrator, ngrenë çështjen e bashkëpunimit midis shteteve për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme. Përpjekjet për të siguruar pranim ose ripranim mund të justifikohen, por këto duhet të ndodhin pas një përcaktimi të pashtetësisë. Megjithatë, pezullimi i procedurës së përcaktimit nuk është i përshtatshëm në këtë kontekst, pasi njohja e pashtetësisë së individit është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e plotë të të drejtave për të cilat ai ose ajo ka të drejtë.

(5) Masat mbrojtëse shtesë procedurale dhe provash për grupe të veçanta

118. Grupe të caktuara mund të përballen me sfida të veçanta në përcaktimin e statusit të shtetësisë së tyre. Konsideratat e moshës, gjinisë dhe diversitetit mund të kërkojnë që disa

⁶⁹ Në veçanti, sipas paragrafit 4 të Rezolutës 61/137 Asambleja e Përgjithshme e OKB. Ju lutemi shihni paragrafin 4 më lart dhe Shtojcën IV.

⁷⁰ Siç përcaktohet në Konkluzionin e Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së 106 (LVII) të vitit 2006, shënimi 666 më lart, Komiteti Ekzekutiv i ka kërkuar UNHCR-së “të shpërndajë në mënyrë aktive informacionin dhe, aty ku është e përshtatshme, të trajtojë homologët e qeverisë për mekanizmat e duhur për identifikimin, regjistrimin dhe dhënien e një statusi personave pa shtetësi” dhe “për të ofruar këshilla teknike për shtetet palë për zbatimin e Konventës së 1954-ës në mënyrë që të sigurohet zbatimi i qëndrueshëm i dispozitave të saj”. (paragrafët (t) dhe (x)). Shihni gjithashtu Shtojcën V.

⁷¹ Shtetet këshillohen gjithashtu që të konsultohen me bazat e të dhënave të shtetësisë të disponueshme nëpërmjet burimeve të tilla si baza e të dhënave Refworld e UNHCR-së, www.refworld.org, ose burime rajonale të tilla si databaza e ligjit të shtetësisë e European Union Democracy Observer (EUDO).

<http://eudo-citizenship.eu/databases>, dhe Projekti i Monitorimit dhe Avokimit të Qeverisjes së Afrikës (AfriMAP)), www.afri-map.org

individëve t'u ofrohen masa mbrojtëse procedurale dhe provash për të siguruar që të merren vendime të drejta për përcaktimin e pashtetësisë.

119. Fëmijët, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar, mund të përballen me sfida akute në komunikimin e fakteve themelore në lidhje me shtetësinë e tyre. Shtetet që vendosin procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të ndjekin parimin e ndjekjes së interesave më të mira të fëmijës kur shqyrtojnë statusin e shtetësisë dhe nevojën për mbrojtjen e pashtetësisë të fëmijëve.⁷² Masat mbrojtëse shtesë procedurale dhe të provave për pretenduesit fëmijë përfshijnë përpunimin me përparësi të kërkesave të tyre, sigurimin e përfaqësuesve ligjorë, intervistuesve dhe përkthyesve të trajnuar siç duhet, si dhe marrja e një pjese më të madhe të barrës së provës nga shteti.
120. Në rrethana të caktuara, konsiderata të ngjashme mund të zbatohen për personat me aftësi të kufizuara⁷³ të cilët përballen me vështirësi në komunikimin e informacionit për statusin e tyre të shtetësisë. Vendimmarrësit duhet të kenë parasysh se për shkak të diskriminimit, personat me aftësi të kufizuara mund të kenë më pak të ngjarë të kenë dokumente identiteti dhe të tjera.
121. Do të ishte e preferueshme që të gjithë pretenduesve t'u ofrohet zgjedhja që të kenë intervistues dhe përkthyes të së njëjtës gjini si ata. Intervistuesit dhe përkthyesit duhet gjithashtu të jenë të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm ndaj çdo ndjeshmërie kulturore ose fetare ose faktori personal, si mosha dhe niveli i arsimimit. Si rezultat i diskriminimit, gratë mund të përballen me pengesa shtesë në marrjen e dokumentacionit përkatës, të tilla si certifikatat e lindjes ose dokumente të tjera identifikimi që do të kishin lidhje me përcaktimin e statusit të tyre të shtetësisë.

⁷² Të gjithë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë duhet të kenë qasje në një procedurë për të përcaktuar interesat e tyre më të mira. Rezultati i një procedure të përcaktimit të pashtetësisë, sikurse rezultati i përcaktimit të statusit të refugjatit, është pjesë e përcaktimit të interesit më të mirë. Në lidhje me procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit dhe përcaktimet e interesit më të mirë, ju lutemi shihni UNHCR, Udhëzues i UNHCR-së për Përcaktimin e Interesit më të Mirë të Fëmijës, maj 2008, <http://www.refworld.org/docid/48480c342.html>

⁷³ Konventa e vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara pranon se "aftësia e kufizuar është një koncept në evoluim dhe se aftësia e kufizuar është rezultat i ndërveprimit midis personave me dëmtime dhe barrierave qëndrore dhe të mjedisit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.", Preambula, paragrafi (e).

F. PËRCAKTIMI I PASHTETËSISË KU NUK ZBATOHET KONVENTA E VITIT 1954

122. Shumë persona pa shtetësi që plotësojnë përkufizimin e Konventës së 1954-ës e gjejnë veten në vende që nuk janë të detyruara nga ky traktat. Megjithatë, një numër shtetesh jokontraktuese kanë prezantuar ndonjë formë të procedurës së përcaktimit të pashtetësisë për të adresuar situatën e personave të tillë në territoret e tyre, duke pasur parasysh angazhimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Në lidhje me këtë të fundit, pashtetësia është një fakt juridikisht i rëndësishëm, për shembull në lidhje me mbrojtjen kundër ndalimit arbitrar (neni 9(1) i ICCPR), të drejtën e grave për trajtim të barabartë me burrat në lidhje me shtetësinë (neni 9 i Konventës së 1979-ës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave) dhe të drejtën e çdo fëmije për një shtetësi (neni 24(3) i ICCPR dhe neni 7(1) i Konventës së vitit 1989 për të Drejtat e Fëmijës).
123. Personat pa shtetësi "*de facto*" janë gjithashtu jashtë mbrojtjes së Konventës së 1954-ës.⁷⁴ Disa shtete kanë përfshirë konceptin e pashtetësisë *de facto* (në thelb, nëse jo gjithmonë në emër) në procedurat e tyre të përcaktimit të pashtetësisë, duke shqyrtuar përshtatshmërinë për mbrojtje mbi këtë bazë krahas kritereve të Konventës së 1954-ës.
124. Shtetet inkurajohen të ofrojnë mbrojtje për personat pa shtetësi *de facto*, përveç personave pa shtetësi të Konventës së 1954-ës. Shpesh personat pa shtetësi *de facto* ndodhen në situata të parregullta ose në ndalim të zgjatur sepse nuk janë në gjendje të kthehen në vendin e tyre të shtetësisë. Shtetet do të marrin parasysh një sërë faktorësh kur të vendosin llojin e procedurës në të cilën do të përcaktohet pashtetësia *de facto*. Një konsideratë është se nuk do të jetë e qartë që në fillim, edhe nga këndvështrimi i aplikantit, nëse ai ose ajo është pa shtetësi sipas Konventës së 1954-ës ose brenda konceptit *de facto*. Pavarësisht se ku përcaktohet pashtetësia *de facto*, procedura nuk duhet t'i pengojë individët të kërkojnë mbrojtje si refugjat ose si person pa shtetësi në kuptim të Konventës së vitit 1954, pasi njohja si të tillë do të shkaktonte detyrime më të mëdha për shtetin sipas së drejtës ndërkombëtare sesa njohja si një person pa shtetësi *de facto*.

⁷⁴ Siç u përmend në paragrafin 7 më lart, nuk ka një përkufizim ndërkombëtar të termit person pa shtetësi *de facto*. Seksioni II.A. i Konkluzioneve të Prato, shënimi 4 më sipër, propozon përkufizimin operacional të mëposhtëm për termin: Personat pa shtetësi *de facto* janë persona jashtë vendit të shtetësisë së tyre, të cilët nuk janë në gjendje ose, për arsye të vlefshme, nuk janë të gatshëm të përfitojnë nga mbrojtja e atij vendi. Mbrojtja në këtë kuptim i referohet të drejtës së mbrojtjes diplomatike të ushtruar nga një shtet i shtetësisë me qëllim korrigjimin e një akti të padrejtë ndërkombëtarisht kundër një shtetasi të tij, si dhe mbrojtjes dhe ndihmës diplomatike dhe konsullore në përgjithësi, duke përfshirë në lidhje me kthimin në shtetin e shtetësisë.

PJESA E TRETË: STATUSI I PERSONAVE PA SHTETËSI NË NIVEL KOMBËTAR

A. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE STATUSI I PERSONAVE PA SHTETËSI

(1) Paralelet midis statusit të refugjatëve dhe personave pa shtetësi

125. Statusi i përcaktuar për personat pa shtetësi në Konventën e 1954-ës është modeluar sipas atij të vendosur për refugjatët në Konventën e vitit 1951. Krahasimi i teksteve të dy traktateve tregon se dispozita të shumta të Konventës së 1954-ës janë marrë fjalë për fjalë, ose me ndryshime minimale, nga dispozitat përkatëse të Konventës së vitit 1951. Kjo është kryesisht për shkak të historisë së përbashkët të hartimit të Konventave të vitit 1951 dhe 1954, të cilat të dyja dolën nga puna e Komitetit Ad Hoc për Pashtetësinë dhe Problemet e Ndërlidhura që u emërua nga Këshilli Ekonomik dhe Social në vitin 1949.⁷⁵ Si rezultat, *Travaux Préparatoires* të Konventës së vitit 1951 janë veçanërisht të rëndësishme në interpretimin e Konventës së 1954-ës.⁷⁶
126. Ashtu si me Konventën e vitit 1951, të drejtat e përcaktuara në Konventën e 1954-ës nuk kufizohen vetëm tek individët që janë njohur si pa shtetësi pas një përcaktimi të bërë nga një shtet ose UNHCR-ja. Një person është pa shtetësi që nga momenti kur ai ose ajo plotëson kriteret në përkufizimin e Konventës së 1954-ës, ku çdo përcaktim i këtij fakti është thjesht deklarativ. Në vend të kësaj, të drejtat që i jepen një individ sipas Konventës janë të lidhura me natyrën e pranisë së atij personi në shtet, të vlerësuara në kuptimin e shkallës së lidhjes me vendin pritës.

75 Rezoluta 248 (IX) (B) e 8 gushtit 1949. Megjithatë mbrojtja e personave pa shtetësi fillimisht synohej të trajtohej në një Protokoll i cili do të aplikonte *mutatis mutandis* shumicën e të drejtave substantive të përcaktuara në Konventën e vitit 1951, më pas u vendos që të miratohej një instrument i pavarur, Konventa në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi.

Për informacion shtesë mbi historinë e hartimit, ju lutemi shihni përshkrimin e detajuar të *Travaux Préparatoires* në UNHCR, *Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi: Historia e saj dhe interpretimi - Një komentari nga Nehemiah Robinson*, 1955, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/4785f03d2.pdf> ("Komentari i Robinson për Konventën e vitit 1954").

76 Ju lutemi shihni, në veçanti, paragrafët 132-139 më poshtë mbi shkallën e të drejtave që u jepen personave pa shtetësi sipas Konventës së 1954-ës në varësi të nivelit të lidhjes së tyre me shtetin palë.

127. Pavarësisht se ndan të njëjtën qasje të përgjithshme, Konventa e 1954-ës megjithatë përmban disa dallime të rëndësishme nga Konventa e viti 1951. Nuk ka asnjë ndalim kundër kthimit (neni 33, Konventa 1951) dhe nuk ka mbrojtje kundër dënimeve për hyrje të paligjshme (neni 31, Konventa 1951). Për më tepër, si e drejta për punësim ashtu edhe e drejta e asociimit parashikojnë një standard më të ulët trajtimi se dispozitat ekuivalente në Konventën e vitit 1951.⁷⁷ Shtrirja e mbrojtjes kundër dëbimit ndryshon gjithashtu ndërmjet traktateve.
128. Një person pa shtetësi mund të jetë njëkohësisht refugjat.⁷⁸ Kur është kështu, është e rëndësishme që çdo kërkesë të vlerësohet dhe që pashtetësia dhe statusi i refugjatit të njihen në mënyrë eksplicite. Në mënyrë të ngjashme, kur standardet e trajtimit janë parashikuar për një formë plotësuese të mbrojtjes, duke përfshirë mbrojtjen kundër kthimit, shtetet duhet t'i zbatojnë këto standarde për individët pa shtetësi që kualifikohen për atë mbrojtje.⁷⁹

(2) Pasqyrë e standardit të trajtimit të kërkuar nga Konventa e 1954-ës

129. Nenet 12-32 të Konventës së 1954-ës përcaktojnë një gamë të gjerë të drejtash civile, ekonomike, sociale dhe kulturore që shtetet t'u akordojnë personave pa shtetësi. Konventa e vitit 1954 i ndan këto të drejta në kategoritë e mëposhtme:
- statusi juridik (duke përfshirë statusin personal, të drejtat pronësore, të drejtën e asociimit dhe qasjen në gjykata);
 - punësimi fitimprurës (përfshirë punësimin me pagë, vetëpunësimin dhe qasjen në profesionet e lira);
 - mirëqenia (duke përfshirë racionimin, strehimin, arsimin publik, ndihmën publike, legjislacionin e punës dhe sigurimet shoqërore); dhe
 - masat administrative (përfshirë ndihmën administrative, lirinë e lëvizjes, dokumentet e identitetit, dokumentet e udhëtimit, tarifat fiskale, transferimin e aseteve, dëbimin dhe natyralizimin).
130. Konventa e vitit 1954 përcakton standardet minimale. Ashtu si Konventa e vitit 1951, Konventa e 1954-ës kërkon që shtetet t'u ofrojnë përfituesve të saj trajtim sipas shkallës së mëposhtme:

⁷⁷ Megjithatë, ashtu si Konventa e 1951-shit, Konventa e 1954-ës u bën thirrje shteteve "t'i japin konsideratë dashamirëse asimilimit të të drejtave të të gjithë personave pa shtetësi në lidhje me punësimin me pagë ndaj atyre të shtetasve...". Ju lutemi shihni nenin 17(2) të Konventës së 1954-ës.

⁷⁸ Siç u theksua në paragrafin 15 më sipër, përkufizimet e personit pa shtetësi sipas Konventës së 1954 dhe ai i refugjatëve sipas Konventës së 1951 nuk janë ndërsjellshmërisht përjashtuese.

⁷⁹ Për informacion të mëtejshëm rreth mënyrës se si duhet të vlerësohen kërkesat për refugjat, mbrojtje plotësuese dhe pashtetësi në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, si dhe garancitë e nevojshme të konfidencialitetit, ju lutemi shihni paragrafët 78-82 më lart.

- trajtimi që duhet t'u ofrohet personave pa shtetësi, pavarësisht nga trajtimi që u bëhet qytetarëve ose të huajve të tjerë;
- të njëjtin trajtim si shtetasit;
- trajtimi sa më i favorshëm dhe, në çdo rast, jo më pak i favorshëm se ai që u jepet të huajve në përgjithësi në të njëjtat rrethana; dhe
- i njëjti trajtim që u bëhet përgjithësisht të huajve.

131. Shtetet kanë diskrecionin për të mundësuar barazi më të madhe ndërmjet statusit të personave pa shtetësi dhe atij të shtetasve dhe në të vërtetë mund të kenë gjithashtu një detyrim për ta bërë këtë sipas traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Përgjegjësia e vendosur mbi shtetet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e Konventës së 1954-ës balancohet nga detyrimi në nenin 2 të të njëjtit traktat që personat pa shtetësi t'u binden ligjeve të vendit në të cilin gjenden.

(a) Të drejtat në një shkallë graduale, të kushtëzuar

132. Të drejtat e parashikuara në Konventën e 1954-ës shtrihen tek personat pa shtetësi bazuar në shkallën e lidhjes së tyre me shtetin. Disa dispozita janë të zbatueshme për çdo individ që plotëson përkufizimin e "personit pa shtetësi" në Konventën e 1954-ës dhe janë ose subjekt i juridiksionit të një shteti palë ose të pranishëm në territorin e tij. Të drejta të tjera, megjithatë, u jepen personave pa shtetësi, të kushtëzuara me atë nëse një individ është "në mënyrë të ligjshme", "qëndron ligjërisht" ose "banues i zakonshëm" në territorin e një shteti palë. Kështu, shtetet mund t'u japin individëve të përcaktuar si pa shtetësi të drejta më gjithëpërfshirëse sesa ato të garantuara për individët që presin një përcaktim. Megjithatë, këta të fundit kanë të drejtën e shumë prej të drejtave të Konventës së 1954-ës. Kjo është e ngjashme me trajtimin e azilkërkuesve sipas Konventës së vitit 1951.
133. Ato të drejta në Konventën e 1954-ës, të cilat shkaktohen kur një individ është subjekt i juridiksionit të një shteti palë përfshijnë statusin personal (neni 12), pronën (neni 13), qasjen në gjykata (neni 16(1)), racionimin (neni 20), arsimin publik (neni 22), ndihma administrative (neni 25) dhe natyralizimi i lehtësuar (neni 32). Të drejtat shitesë që fitojnë individët kur ata janë fizikisht të pranishëm në territorin e një shteti palë janë liria e fesë (neni 4) dhe e drejta për dokumente identiteti (neni 27).
134. Konventa e vitit 1954 parashikon që personat pa shtetësi të cilët janë "ligjshëm në" një shtet palë (në frëngjisht "*se trouvant régulièrement*"), kanë të drejtë për një grup të drejtash shitesë. Të drejtat e "ligjshëm në" përfshijnë të drejtën për t'u angazhuar në vetëpunësim (neni 18), lirinë e lëvizjes brenda një shteti (neni 26) dhe mbrojtjen nga dëbimi (neni 31).
135. Që personat pa shtetësi të jenë "ligjshëm në" një shtet palë, prania e tyre në vend duhet të autorizohet nga shteti. Koncepti përfshin si praninë e sanksionuar në mënyrë eksplicite, ashtu edhe atë që njihet dhe nuk ndalohet, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat

personale të individit.⁸⁰ Kohëzgjatja e pranisë mund të jetë e përkohshme. Ky interpretim i kushteve të Konventës së 1954 është në përputhje me objektin dhe qëllimin e saj, që është të sigurojë ushtrimin sa më të gjerë të mundshëm nga personat pa shtetësi të të drejtave të përfshira në të. Siç konfirmohet nga historia e hartimit të Konventës,⁸¹ aplikantët për statusin e pashtetësisë, të cilët hyjnë në një procedurë përcaktimi, ndodhen “në mënyrë të ligjshme” në territorin e një shteti palë.⁸² Në të kundërt, një individ që nuk ka status imigrimi në vend dhe refuzon mundësinë për të hyrë në një procedurë të përcaktimit të pashtetësisë nuk është “ligjshëm në” vend.

⁸⁰ Konventa e 1951-ës gjithashtu e kushtëzon gëzimin e të drejtave specifike për refugjatët me shkallë të ndryshme të lidhjes me shtetin, ju lutemi shikoni paragrafin 29 të UNHCR, Dokument mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, A/AC.96/830, 7 shtator 1994, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f0a935f2.html> Sipas Komentarit të *Robinson për Konventën e 1954*, shënimi 75 më sipër: “Duhet të supozohet se shprehja 'ligjshëm në vend' siç përdoret në këtë Konventë [1954] ka të njëjtin kuptim sikurse ai në Konventën për Refugjatët”; në paragrafin 5 të Komentarit të nenit 15. Koncepti i qëndrimit “të ligjshëm” për qëllimet e Konventës së 1951 është interpretuar si më poshtë dhe, në dritën e historisë së përbashkët të hartimit të Konventave të 1951 dhe 1954, zbatohet gjithashtu në interpretimin e Konventës së vitit 1954: “...‘ligjshëm’ normalisht duhet të vlerësohet kundrejt ligjeve dhe rregulloreve kombëtare mbizotëruese; megjithatë, një gjykim për sa i përket ligjshmërisë duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat mbizotëruese, duke përfshirë faktin që qëndrimi në fjalë dihet dhe nuk ndalohej, pra tolerohet për shkak të rrethanave të pasigurta të personit”. Ju lutemi shihni në lidhje me këtë diskutimin e “ligjshëm në” në paragrafin 8 të UNHCR, “*Qëndrimi i ligjshëm*” - Një shënim mbi interpretimin, 3 maj 1988, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/42ad93304.html> Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka vendosur që një individ me një urdhër dëbimi që nuk u zbatua, i cili u lejua të qëndronte në Suedi për arsye humanitare ishte “ligjshëm në territor” për qëllime të gëzimit të së drejtës së lirisë së lëvizjes të mbrojtur nga neni 12 i ICCPR. Ju lutemi shihni Celepli kundër Suedisë, CCPR/C/51/D/456/1991, 26 korrik 1994, <http://www.refworld.org/docid/51b6e7ad4.html> paragrafi 9.2.

⁸¹ Ju lutemi shihni *Komentarin e Robinson për Konventën e 1954*, shënimi 75 më lart, veçanërisht në lidhje me nenet 15, 18 dhe 31. Duke pasur parasysh historinë e përbashkët të hartimit të Konventave të 1951 dhe 1954 dhe masën në të cilën dispozitat specifike të Konventës së 1954 pasqyrojnë ato të Konventës së 1951, është e rëndësishme të theksohet deklarata e delegatit të Francës në shpjegimin e kuptimit të termit “pranuar në mënyrë të rregullt” siç përdoret në tekstin e propozuar nga Franca, i cili më vonë u pranua nga komiteti hartues: “Çdo person në posedim të një leje qëndrimi ishte në pozicion të rregullt. Në fakt, e njëjta gjë vlente edhe për një person që nuk kishte ende një leje qëndrimi, por që kishte aplikuar për të dhe kishte dëftesën për atë kërkesë. Në pozitë të parregullt ishin vetëm ata persona të cilët nuk kishin aplikuar, apo aplikimi i të cilëve ishte refuzuar”. Komiteti Ad Hoc i OKB-së për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi, *Komiteti Ad Hoc për Pashtetësinë dhe Problemet e Ndërlidhura, Sesioni i Parë: Regjistrimi përmbledhës i Takimit të Pesëmbëdhjetë të mbajtur në Lake Success, Nju Jork, më 27 janar 1950*, E/AC.32/SR.15, 6 shkurt 1950, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/40aa1d5f2.html> Ndërsa termi “i pranuar në mënyrë të rregullt” nuk arriti të jetë pjesë e Konventës së 1951, ai informoi konceptin e “ligjshëm në”.

⁸² Ju lutemi shihni paragrafin 72, i cili përcakton se procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të kenë efekt pezullues në procedurat e largimit për individin në fjalë për kohëzgjatjen e procedurës derisa të arrihet një përcaktim. Kohëzgjatja e kohës që një individ do të konsiderohet si “ligjshëm në” një vend si rezultat i të qenit në një procedurë të përcaktimit të pashtetësisë shpesh do të jetë e shkurtër. Siç përcaktohet në paragrafët 74-75, aplikimet qartazi të bazuara mund të kërkojnë vetëm disa muaj për të arritur një përcaktim përfundimtar, ku vendimet e shkallës së parë përgjithësisht lëshohen jo më shumë se gjashtë muaj nga aplikimi.

136. Konventa e vitit 1954 u jep një grup tjetër të drejtash personave pa shtetësi që "qëndrojnë ligjërisht" në një shtet palë (në frëngjisht "résidant régulièrement"). Të drejtat e "qëndrimit të ligjshëm" në Konventën e 1954-ës përfshijnë të drejtën e asociimit (neni 15), të drejtën për punë (neni 17), ushtrimin e profesioneve të lira (neni 19), qasjen në banesat publike (neni 21), të drejtën për ndihmë publike. (neni 23), të drejtat e punës dhe të sigurimeve shoqërore (neni 24) dhe dokumentet e udhëtimit (neni 28).⁸³
137. Kërkesa e "qëndrimit të ligjshëm" parashikon një kohëzgjatje më të madhe të pranisë në një territor. Megjithatë, kjo nuk duhet të marrë formën e qëndrimit të përhershëm. Periudhat më të shkurtra të qëndrimit të autorizuar nga shteti mund të mjaftojnë për sa kohë që ato nuk janë vizita kalimtare. Personat pa shtetësi të cilëve u është dhënë një leje qëndrimi do të hynin në këtë kategori.⁸⁴ Ajo mbulon gjithashtu individët që kanë leje të përkohshme qëndrimi nëse kjo është për më shumë se disa muaj. Për dallim nga kjo, një vizitor i pranuar për një periudhë të shkurtër nuk do të ishte "qëndrim i ligjshëm". Individët e njohur si pa shtetësi pas një procedure përcaktimi, por të cilëve nuk u është dhënë leje qëndrimi, në përgjithësi do të "qëndrojnë ligjshëm" në një shtet palë për shkak të kohëzgjatjes së kaluar tashmë në vend në pritje të një përcaktimi.
138. Një grup përfundimtar i të drejtave të parashikuara nga Konventa e vitit 1954 janë ato që duhet t'u akordohen personave pa shtetësi që janë "banorë të zakonshëm" ose "me banim" në një shtet palë. Të drejtat që u takojnë atyre që janë "banorë të zakonshëm" janë mbrojtja e të drejtave artistike dhe pronës intelektuale (neni 14) dhe të drejtat që kanë të bëjnë me qasjen në gjykata, duke përfshirë ndihmën juridike dhe ndihmën në dërgimin e garancive ose pagesën e garancisë për shpenzimet ligjore (neni 16(2)).
139. Kushti që një person pa shtetësi të jetë "banor i zakonshëm" ose "me banim" tregon se personi banon në një shtet palë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. "banim i zakonshëm" do të kuptohet si banim i qëndrueshëm dhe faktik. Kjo mbulon ata persona pa shtetësi, të cilëve u është dhënë qëndrimi i përhershëm, si dhe vlen edhe për individët pa leje qëndrimi, të cilët janë vendosur në një vend, që kanë qenë atje për disa vite, të cilët presin një banim të vazhdueshëm atje.

83 Që nga 1 prilli 2010, të gjitha dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga shtetet, duke përfshirë dokumentet e udhëtimit për personat pa shtetësi, në përputhje me Konventën e 1954-ës, duhet të jenë të lexueshme nga makina në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil ("ICAO"). Ju lutemi shikoni ICAO, *Aneksin 9 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Lehtësimi*, korrik 2005 dhe ICAO-UNHCR, *Udhëzues për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit të lexueshme nga makina për refugjatët dhe personat pa shtetësi*, tetor 2012, <http://www.refworld.org/docid/52b166a34.html>

84 Koncepti i "qëndrimit" është interpretuar në kontekstin e Konventës së vitit 1951 dhe është i zbatueshëm për interpretimin e Konventës së 1954-ës si më poshtë: "'qëndrim' do të thotë diçka më pak se një banim i qëndrueshëm, megjithëse qartësisht më shumë se një ndalesë tranziti". Ju lutemi shihni paragrafin 23, UNHCR, "Qëndrimi në mënyrë të ligjshme" – Një Dokument mbi interpretimin, shënimi i mësipërm 80.

(3) E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

140. Statusi i një personi pa shtetësi sipas së drejtës kombëtare duhet të pasqyrojë gjithashtu dispozitat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shumica dërmuese e të drejtave të njeriut zbatohen për të gjithë personat, pavarësisht nga shtetësia ose statusi i imigrimit, duke përfshirë edhe personat pa shtetësi.⁸⁵ Për më tepër, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit në përgjithësi ndalon çdo diskriminim të bazuar në mungesën e statusit të shtetësisë.⁸⁶ Diferencimi legjitim mund të lejohet për grupet që janë në një pozicion materialisht të ndryshëm.⁸⁷ Kështu, shtetet mund të shqyrtojnë masa afirmative për të ndihmuar grupet veçanërisht të cenueshme të personave pa shtetësi në territorin e tyre.
141. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut plotëson regjimin e mbrojtjes të përcaktuar në Konventën e vitit 1954.⁸⁸ Ndërsa një numër dispozitash të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut replikojnë të drejtat e gjetura në Konventën e 1954-ës, të tjerat parashikojnë një standard më të lartë trajtimi ose të drejta që nuk gjenden në Konventë fare.⁸⁹
142. Me rëndësi të veçantë për personat pa shtetësi është e drejta e parashikuar në nenin 12(4) të ICCPR për të hyrë në “vendin e vet”. Kjo shkon përtej së hyrjes në vendin e

shtetësisë.⁹⁰ Ajo garanton gjithashtu të drejtën e hyrjes, dhe rrjedhimisht të drejtën për të

⁸⁵ Ju lutemi shihni Komitetin e të Drejtave të Njeriut, *Komentin e Përgjithshëm nr. 15 (Pozicioni i të huajve sipas Konventës)*, 11 prill 1986, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/45139acfc.pdf> dhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut, *Komenti i Përgjithshëm nr. 31 (Natyra e detyrimit të përgjithshëm ligjor të vendosur mbi shtetet palë në Konventë)*, CCPR/C/21/Rev.1/Add.13, 26 maj 2004, <http://www.refworld.org/docid/478b26ae2.html>. Ju lutemi shihni gjithashtu Nën komisionin e OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Raportuesi Special për të drejtat e jo qytetarëve, Raporti Përfundimtar, E/CN.Sub.2/2003/23, 26 maj 2003, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/3f46114c4.pdf>. Ju lutemi vini, megjithatë, se gëzimi i plotë i të drejtave të njeriut lehtësohet nga zotërimi i një shtetësie, prandaj edhe ekziston nevoja për mbrojtje specifike për personat pa shtetësi në formën e Konventës së 1954-ës.

⁸⁶ Ju lutemi shihni, për shembull, nenet 2(1) dhe 26 të ICCPR.

⁸⁷ Ju lutemi shihni Komitetin e të Drejtave të Njeriut, *Komentin e Përgjithshëm nr. 18 (Mosdiskriminimi)*, 10 nëntor 1989, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/453883fa8.pdf> paragrafin 13. Ju lutemi shihni gjithashtu Përmbledhje Ekzekutive dhe paragrafi 23 i Raportuesit Special të OKB-së për të drejtat e jo qytetarëve, *Raporti Përfundimtar*, më lart në shënimin 85.

⁸⁸ Ai siguron gjithashtu një kuadër rregullator alternativ në vendet që nuk kanë aderuar në Konventën e 1954-ës. Kjo shqyrtohet më tej në paragrafin 166 më poshtë.

⁸⁹ Për shembull, mbrojtja kundër ndalimit arbitrar të përmendur në nenin 9(1) të ICCPR. Traktatet rajonale të të drejtave të njeriut janë gjithashtu relevante.

⁹⁰ Ju lutemi shihni Komitetin e të Drejtave të Njeriut, *Komentin e Përgjithshëm nr. 27 (Liria e Lëvizjes)*, CCPR/C/21/Rev.1/Add.9, 2 nëntor 1999, <http://www.refworld.org/docid/45139c394.html> paragrafi 20: Formulimi i

qëndruar, të individëve me lidhje të veçanta me një shtet. Kjo përfshin, për shembull, personat pa shtetësi të vendosur prej kohësh në një shtet, si dhe personat pa shtetësi të cilëve u është hequr shtetësia në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare ose të cilëve u është mohuar shtetësia e një shteti i cili ka fituar nëpërmjet suksesionit të shtetit territorin në të cilin ata banojnë zakonisht.

143. Edhe duke marrë parasysh këto zhvillime në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Konventa e 1954-ës ruan rëndësinë e saj pasi trajton çështje specifike për pashtetësinë që nuk trajtohen diku tjetër, veçanërisht dhënien e dokumenteve të identitetit dhe dokumenteve të udhëtimit, si dhe ndihmën administrative për personat pa shtetësi. Për më tepër, dispozitat e Konventës nuk lejojnë derogimin në kohë emergjence publike ndryshe nga disa traktate të të drejtave të njeriut dhe ajo përcakton një numër standardesh që janë më zemërgjera se simotrat e tyre sipas së drejtës për të drejtat e njeriut.⁹¹

nenit 12, paragrafi 4, nuk bën dallim ndërmjet shtetasve dhe të huajve ("askush"). Kështu, personat që kanë të drejtë të ushtrojnë këtë të drejtë mund të identifikohen vetëm duke interpretuar kuptimin e shprehjes "vendi i vet". Shtrirja e "vendi i vet" është më e gjerë se koncepti "vendi i shtetësisë së tij". Ai nuk kufizohet vetëm në shtetësinë në kuptimin formal, domethënë shtetësinë e fituar në lindje ose me dhënie; ai përfshin, të paktën, një individ i cili, për shkak të lidhjeve të veçanta të tij ose të saj ose pretendimeve në lidhje me një vend të caktuar, nuk mund të konsiderohet të jetë thjesht një i huaj. Ky do të ishte rasti, për shembull, për shtetasit e një vendi, të cilëve atje u është hequr shtetësia në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, dhe për individët, vendi i shtetësisë së të cilëve është inkorporuar ose transferuar në një entitet tjetër kombëtar, shtetësia e të cilëve po i mohohet. Gjuha e nenit 12, paragrafi 4, për më tepër, lejon një interpretim më të gjerë që mund të përfshijë kategori të tjera të banorëve afatgjatë, duke përfshirë por pa u kufizuar në personat pa shtetësi të privuar arbitrarisht nga e drejta për të fituar shtetësinë e vendit të këtij qëndrimi.

- ⁹¹ Për shembull, mbrojtja kundër dëbimit për personat "ligjshëm në" territor kufizohet sipas nenit 13 të ICCPR në masat mbrojtëse procedurale, ndërsa neni 31 i Konventës së 1954 kufizon gjithashtu arsyet substantive mbi të cilat dëbimi mund të justifikohet.

B. INDIVIDËT NË NJË KONTEKST MIGRATOR

(1) Individët që presin përcaktimin e pashtetësisë

144. Siç u diskutua në pjesën hyrëse të doracakut, megjithëse Konventa e 1954-ës nuk trajton në mënyrë eksplicite procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, ekziston një përgjegjësi e nënkuptuar për shtetet që të identifikojnë personat pa shtetësi në mënyrë që t'u akordojnë standardet e duhura të trajtimit sipas Konventës.⁹² Paragrafët në vijim marrin në konsideratë statusin e duhur për individët që presin përcaktimin e pashtetësisë së tyre.
145. Një individ që pret një vendim ka të drejtë, së paku, për të gjitha të drejtat bazuar në juridiksionin ose praninë në territor, si dhe të drejtat e "ligjshëm në."⁹³ Në këtë mënyrë, statusi i tij apo saj duhet të garantojë, ndër të tjera, dokumentet e identitetit, të drejtën për vetëpunësim, lirinë e lëvizjes dhe mbrojtjen kundër dëbimit.⁹⁴ Meqenëse të drejtat e lartpërmendura të Konventës janë formuluar pothuajse në mënyrë identike me ato në Konventën e 1951, rekomandohet që individët që presin një përcaktim të pashtetësisë të marrin të njëjtat standarde trajtimi si azilkërkuesit pretendimet e të cilëve janë duke u shqyrtuar në të njëjtin shtet.
146. Statusi i atyre që presin përcaktimin e pashtetësisë duhet gjithashtu të pasqyrojë të drejtat e zbatueshme të njeriut si mbrojtja kundër ndalimit arbitrar dhe ndihma për të përmbushur nevojat bazë.⁹⁵ Lejimi i individëve që presin përcaktimin e pashtetësisë për t'u angazhuar në punësim me pagë, qoftë edhe në baza të kufizuara, mund të reduktojë presionin mbi burimet shtetërore dhe kontribuon në dinjitetin dhe vetëmjaftueshmërinë e individëve në fjalë.

(2) Individët e përcaktuar si pa shtetësi – e drejta e qëndrimit

147. Edhe pse Konventa e 1954-ës nuk kërkon shprehimisht nga shtetet t'i japin një personi të përcaktuar si pa shtetësi të drejtën e qëndrimit, dhënia e një leje të tillë do të përmbushte objektin dhe qëllimin e traktatit. Kjo reflektohet në praktikën e shteteve me procedurat e përcaktimit. Pa të drejtën për të qëndruar, individ është në rrezik të pasigurisë së vazhdueshme dhe i penguar të gëzojë të drejtat e garantuara nga Konventa e 1954-ës dhe ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

⁹² Ju lutemi shihni paragrafin 8.

⁹³ Siç përcaktohet në paragrafët 134-135 më lart. Kjo do të zbatohet gjithashtu në shtetet pa procedura të dedikuara përcaktimi kur një individ ngre një pretendim për pashtetësinë në një kontekst tjetër.

⁹⁴ Ju lutemi shihni paragrafin 72 më lart mbi mbrojtjen kundër dëbimit për procedura të drejta dhe efikase të përcaktimit.

⁹⁵ Ju lutemi shihni paragrafin 140-141 më sipër.

148. Prandaj, rekomandohet që shtetet t'u japin personave të njohur si pa shtetësi një leje qëndrimi të vlefshme për të paktën dy vjet, megjithëse lejet për një kohëzgjatje më të gjatë, si pesë vjet, janë të preferueshme për interesa të stabilitetit. Leje të tilla duhet të rinovohen, duke ofruar mundësinë e natyralizimit të lehtësuar siç përcaktohet nga neni 32 i Konventës së 1954.
149. Nëse një individ i njohur si pa shtetësi fiton ose rifiton më pas shtetësinë e një shteti tjetër, për shembull për shkak të një ndryshimi në ligjet e shtetësisë së tij, ai ose ajo do të pushojë së qeni pa shtetësi sipas Konventës së 1954-ës. Kjo mund të justifikojë anulimin e një leje qëndrimi të marrë në bazë të statusit të pashtetësisë, megjithëse konsideratat e proporcionalitetit në lidhje me të drejtat e fituara dhe faktorët që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si shkalla në të cilën individ ka krijuar një jetë private dhe familjare në shtet, duhet të merren parasysh.
150. Njohja e një individ si person pa shtetësi në bazë të Konventës së 1954-ës shkakton gjithashtu të drejta të "qëndrimit të ligjshëm",⁹⁶ përveç të drejtës për banim. Kështu, e drejta për punë, qasja në kujdesin shëndetësor dhe asistencën sociale, si dhe një dokument udhëtimi duhet të shoqërojnë një leje qëndrimi.
151. Edhe pse Konventa e 1954-ës nuk trajton bashkimin e familjes, shtetet palë megjithatë inkurajohen të lehtësojnë ribashkimin e atyre me status të njohur të pashtetësisë në territorin e tyre me bashkëshortët dhe personat në ngarkim.⁹⁷ Në të vërtetë, disa shtete kanë detyrime për ta bërë këtë që lindin sipas traktateve përkatëse ndërkombëtare ose rajonale të të drejtave të njeriut.⁹⁸
152. Dy dispozitat e Konventës që janë të kufizuara në individët me "banim të zakonshëm" nuk do të rrjedhin automatikisht nga njohja si pa shtetësi.⁹⁹ Megjithatë, këto mund të aktivizohen nëse individ mund të konsiderohet se jeton në vend në baza të qëndrueshme.

⁹⁶ Ju lutemi shihni paragrafët 136-137 më sipër.

⁹⁷ Për një shpjegim të bashkimit të familjes në kontekstin e Konventës së vitit 1951, ju lutemi shihni *Doracakun mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit*, shënimi 47 më lart, në paragrafët 181-188. Nëse personat në ngarkim të një personi pa shtetësi do të kishin të drejtën e statusit të pashtetësisë, i nënshtrohet një hetimi mbi statusin e shtetësisë së secilit person në ngarkim për të verifikuar kualifikimin si "person pa shtetësi" sipas Konventës së 1954-ës. Lehtësimi i bashkimit familjar, megjithatë, mund të arrihet gjithashtu duke u dhënë të drejta qëndrimi personave në ngarkim të një personi pa shtetësi në territorin e një shteti palë, edhe kur personat në ngarkim nuk janë pa shtetës.

⁹⁸ Për më shumë informacion se si detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut plotësojnë ato që dalin nga Konventa e 1954-ës, ju lutemi shihni paragrafët 140-143 më lart.

⁹⁹ Ju lutemi shihni paragrafët 138-139 më lartë.

(3) Kur mbrojtja është e disponueshme në një shtet tjetër

153. Kur një individ i njohur si pa shtetësi ka një mundësi realiste, në të ardhmen e afërt, për të marrë një mbrojtje në përputhje me standardet e Konventës së 1954-ës në një shtet tjetër, shteti pritës ka diskrecionin për të dhënë një status që është më tranzicional në natyrë se ai i përshkruar në paragrafët 148-152 më sipër. Konsiderata të veçanta vlejnë për ata që vullnetarisht heqin dorë nga shtetësia e tyre si një çështje lehtësie ose zgjedhjeje.¹⁰⁰
154. Në këto raste, duhet pasur kujdes që të sigurohet që kriteret për të përcaktuar nëse një individ ka një mundësi realiste për të marrë mbrojtje diku tjetër, të interpretohen ngushtë.¹⁰¹ Sipas mendimit të UNHCR-së, mbrojtja mund të konsiderohet e disponueshme në një vend tjetër vetëm kur një person pa shtetësi:
- është në gjendje të fitojë ose rifitojë shtetësinë përmes një procedure të thjeshtë, të shpejtë dhe jodiskrecionale, e cila është thjesht një formalitet; ose
 - gëzon statusin e banimit të përhershëm në një vend të banimit të mëparshëm të zakonshëm në të cilin është i mundur kthimi i menjëhershëm.
155. Për sa i përket fitimit ose rifitimit të shtetësisë, individët duhet të jenë në gjendje të përdorin një procedurë lehtësisht të qasshme, si fizikisht ashtu edhe financiarisht, si dhe një procedurë që është e thjeshtë për sa i përket hapave procedural dhe kërkesave të provave. Për më tepër, procedura e fitimit/rifitimit duhet të jetë e shpejtë dhe rezultati i garantuar sepse është jodiskrecionale kur plotësohen kërkesat e përcaktuara.¹⁰²
156. Për dallim nga kjo, procedurat e tjera për fitimin e shtetësisë mund të mos paraqesin një gjasë mjaftueshëm të besueshme për marrjen e mbrojtjes diku tjetër dhe për këtë arsye nuk do të justifikonin dhënien e një statusi thjesht kalimtar për personat pa shtetësi. Për shembull, nuk do të mjaftonte që individit të ketë qasje në procedurat e natyralizimit, të cilat, si rregull i përgjithshëm, lënë diskrecionin në duart e zyrtarëve dhe nuk kanë asnjë rezultat të garantuar. Në mënyrë të ngjashme, procedurat me kërkesa të paqarta për fitimin e shtetësisë ose ato që do ta detyronin një individ të ishte fizikisht i pranishëm në një vend të shtetësisë së mëparshme ku hyrja dhe qëndrimi ligjor nuk janë të garantuara gjithashtu nuk do të mjaftonin.

¹⁰⁰ Ju lutemi shihni paragrafët e mëtejshëm 161-162 më poshtë.

¹⁰¹ Për më tepër, masat mbrojtëse janë të nevojshme për të parandaluar që individit të mbetet pa status ligjor kudo dhe për të siguruar që çdo rrethanë e veçantë që justifikon një leje qëndrimi të shqyrtohet siç duhet.

¹⁰² Një shembull do të ishte një procedurë përmes së cilës ish-shtetasit mund të rifitojnë shtetësinë e tyre thjesht duke nënshkruar një deklaratë pranë autoritetit më të afërt konsullor pas paraqitjes së certifikatës së lindjes ose pasaportës së anuluar/skaduar, ku autoriteti kompetent është më pas i detyruar të rivendosë shtetësinë. Procedura të ngjashme mund të përfshijnë gjithashtu regjistrimin ose ushtrimin e të drejtës së opsionit për të fituar shtetësinë.

157. Për sa i përket aftësisë së një individ për t'u kthyer në një vend të banimit të mëparshëm të zakonshëm, kjo duhet të shoqërohet me mundësinë për të jetuar një jetë të sigurt dhe dinjitoze në përputhje me objektin dhe qëllimin e Konventës së 1954-ës. Kështu, ky përjashtim zbatohet vetëm për ata individë që tashmë gëzojnë statusin e qëndrimit të përhershëm në një vend tjetër, ose do t'i jepej pas mbërritjes, kur kjo shoqërohet me një gamë të plotë të të drejtave civile, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe ku ka një mundësi të arsyeshme për të marrë shtetësinë e atij shteti.¹⁰³ Leja për t'u kthyer në një vend tjetër në një bazë afatshkurtër nuk do të mjaftonte.

(a) Kur pashtetësia rezulton nga humbja/privimi ose heqja dorë vullnetare nga shtetësia me mirëbesim

158. Në shumë raste një individ do të bashkëpunojë në përpjekjen për të fituar ose rivendosur shtetësinë ose për të bërë rregullime për kthimin në një vend të banimit të mëparshëm të zakonshëm. Kjo mund të ndodhë kur një individ ka hequr dorë ose ka humbur në mënyrë të pavullnetshme shtetësinë e tij/saj. Kjo mund të lindë gjithashtu kur një individ ka hequr dorë nga shtetësia e tij/saj e mëparshme me vetëdije dhe mirëbesim, me synimin për të fituar një shtetësi tjetër. Në disa raste, për shkak të ligjeve të shtetësisë të hartuara keq, individë të tillë duhet të heqin dorë nga shtetësia e tyre për të aplikuar për një tjetër, por më pas nuk janë në gjendje të fitojnë shtetësinë e dytë dhe mbeten pa shtetësi.
159. Zgjidhja më e mirë në raste të tilla është rifitimi i shtetësisë së mëparshme. Kur një shtet përcakton se individë të tillë janë pa shtetësi, por kanë mundësinë të rifitojnë shtetësinë e tyre të mëparshme, shtetit nuk do t'i duhet t'u sigurojë atyre një leje qëndrimi. Përkundrazi, atyre mund t'u sigurohet një formë e statusit të imigracionit për t'i lejuar individët në fjalë të qëndrojnë për një kohë të shkurtër në territor ndërsa bëjnë rregullime për të lëvizur në shtetin tjetër. Një leje e tillë e përkohshme mund të jetë për një periudhë të shkurtër prej vetëm disa muaj dhe të drejtat që duhet të gëzohen nuk ka nevojë të përputhen me ato që kërkohen kur lëshohet një leje qëndrimi. Në të vërtetë, një status më i afërt me atë të dhënë gjatë procesit të përcaktimit mund të jetë i justifikueshëm.
160. Shtetet mund të zgjasin lejen e përkohshme për të qëndruar aty ku pranimi/ripranimi ose rifitimi i shtetësisë nuk realizohet, kjo pa fajin e individit. Megjithatë, zgjatjet mund të kufizohen në kohëzgjatje në mënyrë që të arrihet një ekuilibër i drejtë midis lehtësisë të përfundimit të përpjekjeve për pranim/ripranim ose rifitim dhe ofrimit të një shkalle sigurie për personin pa shtetësi të prekur. Nëse arrihet afati kohor dhe pranimi/ripranimi ose rifitimi nuk është materializuar ende pavarësisht përpjekjeve me mirëbesim të individit, atëherë është përgjegjësia e shtetit palë që t'i japë individit statusin e dhënë përgjithësisht pas

¹⁰³ Paragrafët 20-22 të UNHCR-së, *Pozicioni mbi kthimin e personave që nuk janë konstatuar se kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e tyre të origjinës: Roli i UNHCR-së*, nëntor 2010, <http://www.unhcr.org/refworld/pdfid/4cea23c62.pdf> duhet të lexohen në dritën e kritereve të përcaktuara në këtë Doracak.

njohjes si person pa shtetësi; d.m.th një leje qëndrimi të rinovueshme me një plotësim të të drejtave, duke përfshirë të drejtën për të punuar dhe për të marrë një dokument udhëtimi.

(b) Kur pashtetësia rezulton nga heqja dorë vullnetare nga shtetësia si një çështje lehtësie ose zgjedhjeje

161. Disa individë heqin dorë vullnetarisht nga një shtetësi sepse nuk dëshirojnë të jenë shtetas të një shteti të caktuar ose me besimin se kjo do të çojë në dhënien e një statusi mbrojtjeje në një vend tjetër.¹⁰⁴ Ripranimi në shtetin e shtetësisë së mëparshme, i shoqëruar me fitimin e asaj shtetësie, është zgjidhja e preferuar në situata të tilla. Kur mungon bashkëpunimi nga individë për ripranimin në një shtet tjetër ose për rifitimin e shtetësisë, autoritetet kanë të drejtë të vazhdojnë diskutimet e tyre me shtetin tjetër për të siguruar pranimin e individit në fjalë. Në këtë kontekst, detyrimet e tjera ndërkombëtare të shtetit të shtetësisë së mëparshme do të jenë të rëndësishme, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me parandalimin e pashtetësisë pas heqjes dorë nga shtetësia dhe e drejta për të hyrë në vendin e vet.¹⁰⁵
162. Një shtet nuk ka nevojë domosdoshmërisht t'u japë ose të rinovojë lejen e qëndrimit për këta individë. Të njëjtit as nuk do të kishin të drejtën për të gjitha të drejtat e parashikuara nga Konventa e 1954-ës. Përfshirë çdo pengesë tjetër të mbrojtjes, kthimi i pavullnetshëm nuk mund të përjashtohet në raste të tilla, për shembull, kur shteti i mëparshëm i shtetësisë është gjithashtu vendi i banimit të zakonshëm të mëparshëm dhe autoritetet e tij janë të përgatitura për t'i dhënë qëndrim të përhershëm individit në fjalë.

¹⁰⁴ E drejta ndërkombëtare njeh se çdo individ ka të drejtën për një shtetësi, por kjo nuk shtrihet në të drejtën e individëve për të zgjedhur një shtetësi të caktuar. Ekziston një pranim i gjerë i dhënies automatike të shtetësisë nga shtetet bazuar në faktorë jashtë kontrollit të një individ, si prejardhja, lindja në territor ose vendbanimi në territor në momentin e suksesionit të shtetit.

¹⁰⁵ Ju lutemi shihni, në veçanti, nenin 7(1) të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë dhe nenin 12(4) të ICCPR. Përveç kësaj, marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimi ndërmjet shteteve bazuar në parimin e mirëbesimit kërkojnë ripranim në rrethana të tilla. Marrëveshjet e shumta ndërmjet shteteve e lehtësojnë tani këtë duke parashikuar ripranimin e personave pa shtetësi, duke përfshirë ish-shtetasit dhe ish-banorët e zakonshëm. UNHCR mund të jetë në gjendje të luajë një rol në këtë drejtim, ju lutemi shihni paragrafin (j) të Konkluzionit të Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së nr. 96 (LIV) të vitit 2003 mbi kthimin e personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f93b1ca4.html> në të cilën Komiteti Ekzekutiv: Rekomandon, në varësi të situatës, që UNHCR të plotësojë përpjekjet e shteteve për kthimin e personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet: (i) promovimit me shtetet të atyre parimeve që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e tyre për të pranuar përsëri shtetasit e tyre, si dhe parimet për reduktimin e pashtetësisë; (ii) Marrjes së qëndrimeve të qarta publike mbi pranueshmërinë e kthimit të personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare; (iii) Vazhdimin e dialogut me shtetet për të rishikuar legjislacionin e tyre të shtetësisë, veçanërisht nëse ai lejon heqjen dorë nga shtetësia pa u siguruar në të njëjtën kohë që personi në fjalë ka fituar një shtetësi tjetër dhe mund të përdoret për të ndaluar ose vonuar kthimin e një personi në një vend të shtetësisë.

(c) Konsiderimi i lidhjeve lokale

163. Kur një individ ka zhvilluar lidhje të ngushta me një shtet pritës si rezultat i qëndrimit afatgjatë dhe lidhjeve familjare, dhënia e statusit të dhënë normalisht pas njohjes si person pa shtetësi, pra një leje qëndrimi e rinovueshme me një plotësim të të drejtave, do të ishte e përshtatshme, edhe kur mbrojtja mund të jetë e disponueshme në një shtet tjetër.¹⁰⁶ Në disa raste, kjo qasje mund të kërkohet për të përmbushur detyrimet e të drejtave të njeriut, si p.sh. përmbajtja nga ndërhyrja e paligjshme ose arbitrare në privatësi, në familje ose në votër.¹⁰⁷

C. INDIVIDËT NË “VENDIN E VET”

164. Siç u përmend në paragrafin 142 më lart, disa persona pa shtetësi mund të konsiderohen se janë në "vendin e vet" në kuptimin e parashikuar nga neni 12(4) i ICCPR. Persona të tillë përfshijnë individë që janë banorë afatgjatë dhe të zakonshëm të një shteti që shpesh është vendi i tyre i lindjes. Duke qenë në "vendin e vet" ata kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë aty me implikime të rëndësishme për statusin e tyre sipas ligjit kombëtar. Lidhja e tyre e thellë me shtetin në fjalë, shpeshherë e shoqëruar nga mungesa e lidhjeve me vendet e tjera, i imponon shtetit një imperativ politik dhe moral për të lehtësuar integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Fakti që këta njerëz janë pa shtetësi në "vendin e vet" është shpesh një reflektim i trajtimit diskriminues në hartimin dhe zbatimin e ligjeve të shtetësisë. Disave do t'u është mohuar shtetësia pavarësisht se kanë lindur dhe banojnë vetëm në atë shtet; të tjerëve mund t'u jetë hequr shtetësia për shkak të qenit anëtarë të një pjese të komunitetit që janë të disfavorizuar në aspektin politik ose shoqëror.¹⁰⁸
165. Statusi i duhur për individë të tillë në "vendin e vet" është shtetësia e shtetit në fjalë. Siç u parashtrua në pjesën e dytë më lart, në këto raste mekanizmi i saktë për përcaktimin e statusit të një individi ose të një grupi popullsie është ai që ka të bëjë me rivendosjen ose dhënien e shtetësisë.¹⁰⁹ Rekursi në një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë në përgjithësi nuk do të jetë i përshtatshëm. Megjithatë, nëse individët pritet të kërkojnë

¹⁰⁶ Kjo është veçanërisht e vërtetë kur lidhja me shtetin tjetër është relativisht e dobët. Megjithatë, kjo duhet të dallohet nga lidhjet që janë aq të thella sa që individ konsiderohet të jetë në "vendin e vet".

¹⁰⁷ Ju lutemi shihni paragrafët 140-143 më lartë.

¹⁰⁸ Me rëndësi në këtë drejtim janë ndalimi i privimit arbitrar të shtetësisë të përmendur, ndër të tjera, në nenin 15(2) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe ndalimi kundër diskriminimit të përmendur në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti ndalimin *jus cogens* mbi diskriminim racor. Natyra e një norme *jus cogens* diskutohet në shënimin 13 më sipër.

¹⁰⁹ Ju lutemi shihni paragrafët 58-61.

mbrojtje nëpërmjet një mekanizmi të tillë, statusi i dhënë pas njohjes do të përfshijë, të paktën, banimin e përhershëm me qasje të lehtësuara në shtetësi.¹¹⁰

D. STATUSI PËR PERSONAT PA SHTETËSI QË NUK MBULOHEN NGA KONVENTA E VITIT 1954

166. Shumë individë që plotësojnë përkufizimin e personit pa shtetësi në Konventën e 1954-ës jetojnë në vende që nuk janë palë në këtë traktat. Megjithatë, standardet në Konventë dhe praktika e shteteve palë mund të jenë të dobishme për këto vende në hartimin dhe zbatimin e strategjive për trajtimin e pashtetësisë në territoret e tyre dhe rregullimin e statusit të personave pa shtetësi. Në veçanti, shtetet që nuk janë ende palë në Konventë mund të marrin parasysh praktikën e dhënies së dokumenteve të identitetit dhe dokumenteve të udhëtimit për personat pa shtetësi, masa të cilat tashmë janë miratuar në disa shtete të tjera jo kontraktuese. Përveç kësaj, të gjitha shtetet do të duhet të respektojnë detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, të tilla si mbrojtja kundër ndalimit arbitrar (neni 9(1) i ICCPR) dhe, në rastin e personave pa shtetësi in situ, e drejta për të hyrë dhe qëndruar në “vendin e vet” (neni 12(4) i ICCPR).¹¹¹
167. Personat pa shtetësi *de facto* janë gjithashtu jashtë mbrojtjes së Konventës së 1954-ës.¹¹² Megjithatë, pasi personat pa shtetësi *de facto* nuk janë në gjendje të kthehen menjëherë në vendin e tyre të shtetësisë, dhënia atyre në minimum e lejes së përkohshme të qëndrimit promovon një shkallë të stabilitetit. Kështu, shtetet mund të konsiderojnë t'u japin atyre një status të ngjashëm me atë të rekomanduar më sipër në paragrafin 159 për personat pa shtetësi që kanë mundësinë të sigurojnë mbrojtje diku tjetër. Në shumë raste, një masë e përkohshme e kësaj natyre do të jetë e mjaftueshme pasi kthimi do të bëhet i mundur për shembull, nëpërmjet përmirësimit të ndihmës konsullore ose një ndryshimi të politikës në lidhje me ndihmën konsullore për këta individë.

110 Aty ku shtetet kanë krijuar popullata pa shtetësi në territorin e tyre, ato mund të mos jenë të gatshme të prezantojnë procedurat e përcaktimit të pashtetësisë ose t'u japin personave pa shtetësi statusin e rekomanduar. Në raste të tilla, përpjekjet e UNHCR-së për të siguruar zgjidhje për popullatën në fjalë mund të shkojnë përtej avokimit në këshillat teknike dhe mbështetje operacionale për iniciativat që synojnë njohjen e lidhjes ndërmjet individëve të tillë dhe shtetit nëpërmjet dhënies së shtetësisë.

111 Ju lutemi shihni tutje paragrafët 164-165 më lart.

112 Siç u përmend në paragrafin 7 më lart, nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht për pashtetësinë *de facto*. Sipas përpjekjeve të fundit për të përkufizuar termin, personat pa shtetësi *de facto* kanë një shtetësi, por nuk janë në gjendje, ose për arsye të vlefshme nuk janë të gatshëm, të përfitojnë nga mbrojtja e një shteti të shtetësisë. Ju lutemi shihni më tej seksionin II.A. i Konkluzioneve të Prato, shënimi 4 më sipër, i cili propozon përkufizimin operacional të mëposhtëm për termin: Personat pa shtetësi *de facto* janë persona jashtë shtetit të shtetësisë së tyre, të cilët nuk janë në gjendje ose, për arsye të vlefshme, nuk janë të gatshëm të përfitojnë nga mbrojtja e atij vendi. Mbrojtja në këtë kuptim i referohet të drejtës së mbrojtjes diplomatike të ushtruar nga një shtet shtetësie për të korrigjuar një akt të padrejtë ndërkombëtarisht kundër një shtetasi të tij, si dhe mbrojtjen dhe ndihmën diplomatike dhe konsullore në përgjithësi, duke përfshirë në lidhje me kthimin në shtetin e shtetësisë.

168. Aty ku gjasat e mbrojtjes kombëtare duken më të largëta, rekomandohet të përmirësohet statusi i personave pa shtetësi *de facto* nëpërmjet dhënies së një leje qëndrimi të ngjashme me ato që u jepen personave që njihen si pa shtetësi në bazë të Konventës së 1954-ës. Në përgjithësi, fakti që personat pa shtetësi *de facto* kanë një shtetësi do të thotë se kthimi në vendin e tyre të shtetësisë është zgjidhja e preferuar e qëndrueshme. Megjithatë, aty ku pengesat për kthim rezultojnë të vështira, konsideratat praktike dhe humanitare aludojnë drejt zgjidhjeve lokale nëpërmjet natyralizimit si përgjigje e duhur.

SHTOJCA I – KONVENTA E VITIT 1954 LIDHUR ME STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI*

Preambula

Palët e larta kontraktuese

Duke marrë parasysh që Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka pohuar parimin që qeniet njerëzore gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore pa diskriminim,

Duke marrë parasysh që Kombet e Bashkuara kanë treguar në raste të ndryshme shqetësimin e tyre të thellë për personat pa shtetësi dhe janë përpjekur t'u sigurojnë personave pa shtetësi ushtrimin më të gjerë të mundshëm të këtyre të drejtave dhe lirive themelore,

Duke marrë parasysh që vetëm ata persona pa shtetësi të cilët janë edhe refugjatë mbulohen nga Konventa lidhur me statusin e refugjatëve e 28 korrikut të vitit 1951 dhe se ka shumë persona pa shtetësi të cilët nuk janë mbuluar nga ajo Konventë,

Duke marrë parasysh që është e dëshirueshme të rregullohet dhe përmirësohet statusi i personave pa shtetësi nga një marrëveshje ndërkombëtare,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1

Përkufizimi i termi “person pa shtetësi”

1. Për qëllimin e kësaj Konvente, termi “person pa shtetësi” do të thotë një person i cili nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet sipas veprimit të ligjit të tij.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet:

- (i) Ndaj personave të cilët për momentin janë duke marrë mbrojtje ose ndihmë nga organe ose agjenci të Kombeve të Bashkuara, përveç Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët, për aq kohë sa ata e marrin një mbrojtje dhe ndihmesë të tillë.
- (ii) Ndaj personave të cilët njihen nga autoritetet kompetente të vendit në të cilin ata qëndrojnë, që kanë të drejtat dhe detyrimet të cilat i janë bashkuar mbajtjes së shtetësisë së atij vendi;

* Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara, vëll. 360, f. 1177

- (iii) Ndaj personave në lidhje me të cilët ka arsye serioze për të konsideruar që
- (a) ata kanë kryer një krim kundër paqes, një krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, siç është përcaktuar në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të parashikuar dispozita për krime të tilla;
 - (b) ata kanë kryer një krim serioz jopolitik jashtë vendit të tyre të qëndrimit para pranimit të tyre në atë vend;
 - (c) ata kanë qenë fajtorë të veprimeve në kundërshtim me qëllimin dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

NENI 2

Detyrimet e përgjithshme

Çdo person pa shtetësi ka detyra ndaj vendit në të cilin ai gjendet, të cilat kërkojnë në veçanti që ai të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij, po ashtu edhe ndaj masave të marra për ruajtjen e rendit publik.

NENI 3

Mosdiskriminimi

Shtetet kontraktuese do të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente ndaj personave pa shtetësi pa diskriminim ndaj racës, fesë ose vendit të origjinës.

NENI 4

Feja

Shtetet Kontraktuese do t'u akordojnë personave pa shtetësi brenda territoreve të tyre një trajtim së paku aq të favorshëm sa ai i akorduar shtetasve të tyre në lidhje me lirinë e praktikimit të fesë së tyre dhe lirinë lidhur me arsimimin fetar të fëmijëve të tyre.

NENI 5

Të drejtat e dhëna pavarësisht nga kjo Konventë

Asgjë në këtë Konventë nuk gjykohet se cenon ndonjë prej të drejtave dhe përfitimeve të dhëna nga Shteti Kontraktues personave pa shtetësi pavarësisht nga kjo Konventë.

NENI 6

Termi “në të njëjtat rrethana”

Për qëllimin e kësaj Konvente, termi “në të njëjtat rrethana” nënkupton që çdo kërkesë (duke përfshirë kërkesat lidhur me kohëzgjatjen dhe kushtet e qëndrimit) të cilën një individ i veçantë do duhet të përmbushë që të gëzojë të drejtat në fjalë, nëse ai nuk do të ishte një person pa shtetësi, duhet të plotësohen prej tij, me përjashtim të kërkesave të cilat, për shkak të natyrës së tyre, një person pa shtetësi është i paaftë t'i përmbushë.

NENI 7

Përjashtim nga reciprociteti

1. Përveç rasteve kur kjo Konventë përmban dispozita më të favorshme, një shtet Kontraktues u akordon personave pa shtetësi të njëjtin trajtim, siç u akordon të huajve në përgjithësi.
2. Pas një periudhe qëndrimi prej tre vitesh, të gjithë personat pa shtetësi gëzojnë përjashtim nga reciprociteti legjislativ në territorin e Shteteve Kontraktuese.
3. Çdo Shtet Kontraktues vazhdon t'u akordojë personave pa shtetësi të drejtat dhe përfitimet të cilat ata kishin të drejtë t'i përfitonin, në mungesë të reciprocitetit, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet.
4. Shtetet Kontraktuese konsiderojnë në mënyrë të favorshme mundësinë e akordimit personave pa shtetësi, në mungesë të reciprocitetit, të të drejtave dhe përfitimeve përtej atyre të cilave ata kanë të drejtë sipas paragrafëve 2 dhe 3, dhe ndaj përjashtimeve që shtrihen nga reciprociteti ndaj personave pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë kushtet e ofruara në paragrafët 2 dhe 3.

Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 zbatohen ndaj të drejtave dhe përfitimeve të referuara në nenet 13, 18, 19, 21 dhe 22 të kësaj Konvente dhe të drejtave dhe përfitimeve të cilat nuk parashikohen nga kjo Konventë.

NENI 8

Përjashtim nga masat përjashtimore

Përsa u përket masave përjashtimore të cilat mund të merren kundër personit, pasurisë ose interesave të shtetasve ose ish-shtetasve të një shteti të huaj, Shtetet Kontraktuese nuk zbatojnë masa të tilla ndaj një personi pa shtetësi vetëm për arsye se ai kishte më parë shtetësinë e shtetit të huaj në fjalë. Shtetet Kontraktuese të cilat, sipas legjislacionit të tyre, janë të ndaluara të zbatojnë parimet e përgjithshme të shprehura në këtë nen bëjnë, në raste të përshtatshme, përjashtime në favor të personave të tillë pa shtetësi.

NENI 9

Masat e përkohshme

Asgjë në këtë Konventë nuk e pengon një Shtet Kontraktues, në kohë lufte ose rrethana të tjera të rënda dhe të pazakonta, nga marrja e masave të përkohshme, të cilat ai i konsideron si thelbësore për sigurinë kombëtare në rastin e një personi të veçantë, në pritje të përcaktimit nga Shteti Kontraktues se ai person është në fakt një person pa shtetësi dhe se vazhdimësia e masave të tilla është e nevojshme në këtë rast në interes të sigurisë kombëtare.

NENI 10

Vazhdimi i qëndrimit

1. Atje ku një person pa shtetësi është zhvendosur me forcë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe është vendosur në territorin e një Shteti Kontraktues, dhe është banor atje, periodha e një qëndrimi të tillë të detyruar konsiderohet të ketë qenë qëndrim i ligjshëm brenda atij territori.

2. Atje ku një person pa shtetësi ka qenë i detyruar të zhvendoset me forcë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga territori i një Shteti Kontraktues dhe është, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, kthyer atje për të qëndruar, periodha e qëndrimit përpara dhe pas një zhvendosjeje të tillë me forcë do të konsiderohet si një periudhë e pandërprerë për çdo qëllim për të cilin kërkohet qëndrim i pandërprerë.

NENI 11

Detarët pa shtetësi

Në rastin e personave pa shtetësi që shërbejnë rregullisht si anëtarë të ekuipazhit në bordin e një anije që mban flamurin e Shtetit Kontraktues, ai shtet duhet t'i japë konsideratë dashamirëse vendosjes së tyre në territorin e tij dhe çështja e dokumenteve të udhëtimit për ta ose pranimi i tyre i përkohshëm në territorin e tij veçanërisht, me qëllim që të lehtësojë vendosjen e tyre në një vend tjetër.

KAPITULLI II: STATUSI JURIDIK

NENI 12

Statusi personal

1. Statusi personal i një personi pa shtetësi do të rregullohet nga ligji i vendbanimit të tij të përhershëm ose, kur ai nuk ka vendbanim të përhershëm, nga ligji i vendit të qëndrimit të tij.

2. Të drejtat e fituara më parë nga një person pa shtetësi dhe të varura nga statusi personal, më veçanërisht të drejtat lidhur me martesën, respektohen nga një Shtet Kontraktues me kusht që të pajtohen, nëse kjo do të jetë e nevojshme, me formalitetet e kërkuara nga ligji i atij shteti,

me kusht që e drejta në fjalë është një e drejtë e cila duhet të kishte qenë njohur nga ligji i atij shteti, nëse ai nuk do të ishte bërë pa shtetësi.

NENI 13

Pasuria e tundshme dhe e patundshme

Shtetet Kontraktuese do të akordojnë ndaj një personi pa shtetësi trajtim sa më të favorshëm të jetë e mundur dhe, në asnjë rast, jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana, përsa i përket fitimit të pasurisë së tundshme dhe të patundshme dhe të drejtave të tjera që kanë të bëjnë me to, si dhe qirave dhe kontratave të tjera lidhur me pasurinë e tundshme dhe të patundshme.

NENI 14

Të drejtat artistike dhe pasuria industriale

Përsa i përket mbrojtjes së pasurisë industriale të tilla, si zbulimet, projektet ose modelet, markat tregtare, emrat tregtar dhe të drejtave në veprat letrare, artistike dhe shkencore, një personi pa shtetësi i akordohet në vendin në të cilin ai ka banimin e tij të zakonshëm e njëjta mbrojtje, siç u akordohet shtetasve të atij vendi. Në territorin e cilitdo Shteti tjetër Kontraktues, atij i akordohet e njëjta mbrojtje që i akordohet në atë territor shtetasve të vendit në të cilin ai ka banimin e tij të zakonshëm.

NENI 15

E drejta e asociimit

Përsa u përket shoqatave jopolitike dhe jofitimprurëse dhe sindikatave, Shtetet Kontraktuese do t'u akordojnë personave pa shtetësi, që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e tyre, trajtim sa më të favorshëm që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana.

NENI 16

Qasja në gjykata

1. Një person pa shtetësi do të ketë qasje të lirë në gjykatat e drejtësisë në territorin e të gjitha Shteteve Kontraktuese.

2. Një person pa shtetësi do të gëzojë në Shtetin Kontraktues në të cilin ai ka banimin e tij të zakonshëm të njëjtin trajtim si një shtetas për çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në gjykata, duke përfshirë ndihmën ligjore dhe përjashtimin nga cautio judicatum solvi.

3. Një personi pa shtetësi do t'i akordohet për çështjet e referuara në paragrafin 2 në vendet përveç atij në të cilin ai ka banimin e zakonshëm, trajtim që i jepet një shtetasi të vendit të tij të banimit të zakonshëm.

KAPITULLI III: PUNËSIMI FITIMPRURËS

NENI 17

Punësimi me pagë

1. Shtetet Kontraktuese i akordojnë personave pa shtetësi që kanë qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre trajtim sa më të favorshëm që të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më pak favorizues sesa ajo që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana, përsa i përket të drejtës për t'i përfshirë në punësimin me pagë.

2. Shtetet Kontraktuese i japin konsideratë dashamirëse asimilimit të të drejtave të të gjithë personave pa shtetësi lidhur me punësimin me pagë të atyre shtetasve dhe në veçanti të atyre personave pa shtetësi, që kanë hyrë në territorin e tyre në pajtim me programet e rekrutimit të punës ose sipas skemës së imigrimit.

NENI 18

Vetëpunësimi

Shtetet Kontraktuese i akordojnë personit pa shtetësi, që është i ligjshëm në territorin e tyre, trajtim sa më favorizues të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana, përsa i përket të drejtës për t'u përfshirë për llogari të tij në bujqësi, industri, punime me dorë dhe tregtare dhe për të krijuar shoqëri tregtare dhe industriale.

NENI 19

Profesionet e lira

Çdo Shtet Kontraktues i akordon personave pa shtetësi me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre, të cilët mbajnë diploma të njohura nga autoritetet kompetente të atij shteti dhe të cilët dëshirojnë të praktikojnë një profesion të lirë, trajtim sa më të favorshëm të jetë i mundur dhe, në çdo rast, jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana.

KAPITULLI IV: MIRËQËNIA

NENI 20

Racionimi

Atje ku ekziston një sistem racionimi, i cili zbatohet ndaj popullsisë në përgjithësi dhe rregullon shpërndarjen e përgjithshme të produkteve në mungesë, personave pa shtetësi i akordohet i njëjti trajtim si shtetasve.

NENI 21

Strehimi

Përsa i përket strehimit Shtetet Kontraktuese, për aq sa çështja është rregulluar nga ligjet ose rregullat, ose varet nga kontrolli i autoriteteve publike u akordon personave pa shtetësi me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre trajtim sa më favorizues që të jetë i mundur, në çdo rast, jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana.

NENI 22

Arsimimi publik

1. Shtetet Kontraktuese i akordojnë personave pa shtetësi të njëjtin trajtim që u akordohet shtetasve përsa i përket arsimit fillor.

2. Shtetet Kontraktuese u akordojnë personave pa shtetësi trajtim sa më të favorshëm që të jetë i mundur dhe, në çdo rast, jo më pak favorizues sesa ai që u akordohet të huajve zakonisht në të njëjtat rrethana, përsa i përket arsimimit, përveç edukimit fillor dhe, në veçanti, përsa i përket hyrjes për studime, njohjes së certifikatave, diplomave dhe gradave të shkollave të huaja, shlyerjes së kuotave dhe detyrimeve dhe akordimin e bursave.

NENI 23

Ndihma publike

Shtetet Kontraktuese u akordojnë personave pa shtetësi me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre të njëjtin trajtim lidhur me ndihmën dhe asistencën publike ashtu siç u jepet shtetasve të tyre.

NENI 24

Legjislacioni i punës dhe sigurimi shoqëror

1. Shtetet Kontraktuese u akordojnë personave pa shtetësi që janë me qëndrim të ligjshëm në territoret e tyre të njëjtin trajtim siç u akordohet shtetasve në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- (a) Për aq sa çështje të tilla rregullohen nga ligje ose rregulla ose janë të kushtëzuara nga kontrolli i autoriteteve administrative: shpërblimi, duke përfshirë fondet familjare ku këto janë pjesë e shpërblimit, orët e punës, marrëveshjet e orëve jashtë orarit të punës, pushimet me pagesë, kufizimet në punët e shtëpisë, mosha minimale e punësimit, periodha e të punuarit si çirak dhe trajnimi, puna e grave dhe puna e personave të rinj, dhe punësimi i përfitimeve të marrëveshjes kolektive.
- (b) Sigurimi shoqëror (dispozitat ligjore lidhur me punësimin, lëndimin, sëmundjet profesionale, maternitetin, sëmundjet, paaftësia, mosha e vjetër, vdekja, papunësia, përgjegjësitë familjare dhe çdo rast tjetër emergjence i cili, sipas ligjeve dhe rregullave kombëtare, është i mbuluar nga një skemë e sigurimit shoqëror), i kushtëzuar nga kufizimet e mëposhtme:
 - (i) Mund të ketë marrëveshje përkatëse të duhura për mbajtjen e të drejtave të fituara dhe të drejtave gjatë kohës së fitimit.
 - (ii) Ligjet dhe rregullat kombëtare të vendit të banimit mund të paracaktojnë marrëveshje të veçanta përsa u përket përfitimeve ose pjesëve të përfitimeve të cilat janë të pagueshme tërësisht nga fondet publike dhe përsa u përket fondeve të paguara ndaj personave të cilët nuk plotësojnë kushtet e kontributeve të paracaktuara për shpërblimin e një pensioni normal.

2. E drejta për kompensim për vdekjen e një personi pa shtetësi që rezulton nga lëndimi në punë ose nga sëmundje profesionale nuk do të ndikohet nga fakti që vendqëndrimi i përfituesit është jashtë territorit të Shtetit Kontraktues.

3. Shtetet Kontraktuese do t'u japin personave pa shtetësi përfitimet e marrëveshjeve të përfunduara midis tyre, ose të cilat mund të përfundohen ndërmjet tyre në të ardhmen, përsa i përket mbajtjes së të drejtave të fituara dhe të drejtave në procesin e fitimit lidhur me sigurimin shoqëror, lidhur vetëm me kushtet të cilat zbatohen ndaj shtetasve të shtetit nënshkrues të marrëveshjeve në fjalë.

4. Shtetet Kontraktuese konsiderojnë me dashamirësi dhënien personave pa shtetësi, sa më shumë të jetë e mundur, të përfitimeve të marrëveshjeve të njëjta, të cilat mundet në çdo kohë të jenë në fuqi ndërmjet shteteve të tilla kontraktuese dhe shteteve jokontraktuese.

KAPITULLI V: MASAT ADMINISTRATIVE

NENI 25

Ndihma administrative

1. Kur ushtrimi i të drejtës nga një person pa shtetësi kërkon normalisht ndihmën e autoriteteve të një vendi të huaj të cilave ai nuk mund t'u drejtohet, Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ai është duke banuar, organizon që një ndihmë e tillë t'i ofrohet atij nga autoritetet e tyre.

2. Autoriteti ose autoritetet e përmendura në paragrafin 1 i shpërndajnë ose bëjnë t'i shpërndajnë nën mbikëqyrjen e tyre personave pa shtetësi, dokumente ose certifikata të tilla, siç do t'i shpërndaheshin normalisht të huajve nga ose nëpërmjet autoriteteve të tyre kombëtare.

3. Dokumentet ose certifikatat, të shpërndara në këtë mënyrë, qëndrojnë në vend të dokumenteve zyrtare shpërndarë të huajve nga ose nëpërmjet autoriteteve të tyre kombëtare, dhe do të besohen në mungesë të provës së kundërt.

4. Lidhur me këtë trajtim përjashtues që mund t'u jepet personave nevojtarë, për shërbimet e përmendura këtu mund të vendosen tarifa, por këto tarifa janë modeste dhe në proporcion me ato që u ngarkohen shtetasve për shërbime të ngjashme.

5. Dispozitat e këtij neni nuk paragjykojnë nenet 27 dhe 28.

NENI 26

Liria e lëvizjes

Çdo Shtet Kontraktues i akordon personave pa shtetësi që janë të ligjshëm në territorin e tij të drejtën për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe për të lëvizur lirshëm brenda territorit të tij, në bazë të rregullave të zbatueshme për të huajt përgjithësisht në të njëjtat rrethana.

NENI 27

Dokumentet e identitetit

Shtetet Kontraktuese i japin dokumente identiteti çdo personi pa shtetësi në territorin e tyre, i cili nuk zotëron një dokument udhëtimi të vlefshëm.

NENI 28

Dokumentet e udhëtimit

Shtetet Kontraktuese u japin personave pa shtetësi me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre dokumente udhëtimi për të udhëtuar jashtë territorit të tyre, përveçse kur kërkohet ndryshe nga arsye shtrënguese të sigurisë kombëtare ose të rendit publik, dhe dispozitat e kalendarit të kësaj Konvente zbatohen në lidhje me dokumente të tilla. Shtetet Kontraktuese mund t'i japin një

dokument të tillë udhëtimi çdo personi tjetër pa shtetësi në territorin e tyre; ata në veçanti konsiderojnë me dashamirësi lëshimin e një dokumenti të tillë udhëtimi për personat pa shtetësi në territorin e tyre, të cilët nuk janë në gjendje të përfitojnë një dokument udhëtimi nga vendqëndrimi i tyre i ligjshëm.

ENI 29

Detyrimet fiskale

1. Shtetet Kontraktuese nuk imponojnë mbi personat pa shtetësi detyrime ose taksa, të çfarëdo përshkrimi, të tjera ose më të larta se ato taksa të cilat u janë ose mund t'u jenë vënë shtetasve të tyre në situata të ngjashme.

2. Asgjë në paragrafin e mësipërm nuk pengon zbatimin ndaj personave pa shtetësi të ligjeve dhe rregullave që kanë të bëjnë me detyrimet lidhur me dhënien të huajve të dokumenteve administrative përfshirë edhe dokumentet e identitetit.

ENI 30

Transferta e asetëve

1. Një Shtet Kontraktues lejon, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit të tij, personat pa shtetësi të transferojnë asetet, të cilat ata i kanë blerë në territorin e tij, në një vend tjetër ku ata janë pranuar për t'u rivendosur.

2. Një Shtet Kontraktues konsideron me dashamirësi aplikimin e personave pa shtetësi për lejet për të transferuar asetet kudo që ata mund të jenë dhe të cilat janë të domosdoshme për rivendosjen e tyre në një vend tjetër nga i cili ata janë pranuar.

ENI 31

Dëbimi

1. Shtetet Kontraktuese nuk dëbojnë një person pa shtetësi me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre, përveçse për arsye të sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

2. Dëbimi i një personi të tillë pa shtetësi bëhet vetëm në përputhje me një vendim të arritur në përputhje me një proces të drejtë ligjor. Përveç kur kërkohet nga arsye shtrënguese të sigurisë kombëtare, personi pa shtetësi lejohet të paraqesë prova për sqarim dhe të apelojë, dhe të përfaqësohet për këtë qëllim para autoriteteve kompetente ose një personi, ose personave, veçanërisht të emëruar nga autoritetet kompetente.

3. Shtetet Kontraktuese duhet t'i lejojnë një personi të tillë pa shtetësi një periudhë të arsyeshme brenda së cilës të kërkojë pranim ligjor në një vend tjetër. Shtetet Kontraktuese rezervojnë të drejtën për të zbatuar gjatë asaj periudhe masa të tilla të brendshme, nëse ato gjykohen të nevojshme.

NENI 32

Natyralizimi

Shtetet Kontraktuese lehtësojnë, sa më shumë të jetë e mundur, asimilimin dhe natyralizimin e personave pa shtetësi. Ata në veçanti bëjnë çdo përpjekje të lehtësojnë procedurat e natyralizimit dhe të zvogëlojnë sa më shumë të jetë e mundur detyrimet dhe kostot e procedurave të tilla.

KAPITULLI VI: KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

NENI 33

Informacion mbi legjislacionin kombëtar

Shtetet Kontraktuese i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ligjet dhe rregullat, të cilat mund t'i adaptojnë për të siguruar zbatimin e kësaj Konvente.

NENI 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve të kësaj Konvente lidhur me interpretimin ose zbatimin e saj, të cilat nuk mund të zgjidhen me mjete të tjera, i referohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e çdo njëres prej palëve në mosmarrëveshje.

NENI 35

Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në qarqet kryesore të Kombeve të Bashkuara deri në 31 dhjetor të vitit 1955.
2. Ajo do të jetë e hapur për nënshkrim në emër të:
 - (a) çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara;
 - (b) çdo shteti tjetër i ftuar për të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi statusin e personave pa shtetësi;
 - (c) çdo shteti të cilit mund t'i jetë adresuar një ftesë për të nënshkruar ose për të aderuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.
3. Ajo ratifikohet dhe dokumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
4. Ajo është e hapur për aderim nga shtetet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni. Aderimi ndikohet nga depozitimi i instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

NENI 36

Klauzola e zbatimit territorial

1. Çdo shtet mundet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, të deklarojë se kjo Konventë shtrihet në të gjitha ose në secilën prej territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës. Një deklaratë e tillë sjell pasoja kur konventa hyn në fuqi për shtetet në fjalë.

2. Në çdo kohë më pas kjo shtrirje bëhet nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe sjell pasoja nga dita e nëntëdhjetë pas ditës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të këtij njoftimi ose që nga dita e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë, cilado qoftë më e vonshme.

3. Lidhur me ato territore në të cilat kjo Konventë nuk shtrihet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet i interesuar konsideron mundësitë për marrjen e hapave të nevojshme në mënyrë që të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në territore të tilla, me pëlqimin, kur është e nevojshme për arsye kushtetuese, të qeverive të këtyre territoreve.

NENI 37

Klauzola federale

Në rastin e një shteti federal ose jounitar zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- (a) Lidhur me ato nene të kësaj Konvente që janë në juridiksionin legjislativ të autoriteteve federale legjislative, detyrimet e qeverisë federale në përmasa janë të njëjta me ato të Palëve të cilët nuk janë shtete federale.
- (b) Lidhur me ato nene të kësaj Konvente që janë në juridiksionin legjislativ të shteteve përbërëse, provincave ose kantoneve të cilat nuk janë të detyruara të ndërmarrin veprime legjislative, sipas sistemit kushtetues të federatës, qeveria federale do t'i sjellë këto nene, me një rekomandim të favorshëm, në vëmendjen e autoriteteve përkatëse të shteteve, provincave ose kantoneve sa më parë që të jetë e mundur.
- (c) Një Shtet federal Palë në këtë Konventë, me kërkesën e çdo Shteti tjetër Kontraktues të transmetuar nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, bën një deklaratë të ligjeve dhe praktikave të federatës dhe të njësive të saj përbërëse lidhur me çdo dispozitë të veçantë të Konventës duke treguar shtrirjen që i është dhënë asaj dispozite nëpërmjet ndonjë mase legjislative ose ndonjë veprimi tjetër.

NENI 38

Rezervat

1. Në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet mund t'u bëjë rezerva neneve të Konventës, përveç neneve 1, 3, 4, 16 (1) dhe 33 deri 42 të përfshira.

2. Çdo shtet duke bërë një rezervë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mundet në çdo kohë të tërheqë rezervën me anë të një komunikimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

NENI 39

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon në Konventë pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

NENI 40

Denoncimi

1. Çdo Shtet Kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Ky denoncim sjell pasoja për Shtetin Kontraktues të interesuar një vit nga data në të cilën ai është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Çdo shtet i cili ka bërë një deklaratë ose njoftim sipas nenit 36 mund të deklarojë, në çdo kohë pas kësaj, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se Konventa do të pushojë së shtriri në këtë territor një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

NENI 41

Rishikimi

1. Çdo Shtet Kontraktues mund të kërkojë rishikim të kësaj Konvente në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara bën rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë, nëse ka ndonjë, lidhur me një kërkesë të tillë.

NENI 42

Njoftimet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha Shtetet anëtare dhe joanëtare të Kombeve të Bashkuara duke iu referuar nenit 35 për:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet në përputhje me nenin 35;
- (b) deklaratat dhe njoftimet në përputhje me nenin 36;
- (c) rezervat dhe tërheqjet në përputhje me nenin 38;
- (d) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 39;
- (e) denoncimet dhe njoftimet në përputhje me nenin 40;
- (f) kërkesat për rishikim në përputhje me nenin 41.

Në mirëbesim të nënshkruarit, autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë në emër të qeverive të tyre përkatëse.

Përgatitur në New York, më 28 shtator 1954, në një kopje të vetme, prej të cilës tekstet anglisht, frëngjisht dhe spanjisht janë njëlloj autentike dhe të cilat do të mbeten të vendosura në arkivat e Kombeve të Bashkuara dhe kopje të vërteta të vërtetuara plotësisht të cilat do të shpërndahen tek të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare referuar në nenin 35.

KALENDARI

Paragrafi 1

1. Dokumenti i udhëtimit që referohet në nenin 28 të kësaj Konvente duhet të tregojë që mbajtësi është person pa shtetësi sipas parashikimeve të Konventës së 28 shtatorit 1954.
2. Dokumenti bëhet në të paktën dy gjuhë, njëra prej të cilave është anglisht ose frëngjisht.
3. Shtetet Kontraktuese konsiderojnë nëse dëshirojnë të adaptojnë modelin e dokumentit të udhëtimit që është bashkëngjitur.

Paragrafi 2

Bazuar në rregullat e përfuara në shtetin në fjalë, fëmijët mund të përfshihen në dokumentin e udhëtimit të njërit prej prindërve, ose në raste të jashtëzakonshme, të një të rrituri tjetër.

Paragrafi 3

Pagesa për lëshimin e dokumentit të udhëtimit nuk duhet të jetë më e lartë se çmimi më i ulët i pasaportave shtetërore.

Paragrafi 4

Përveç në raste të veçanta ose të jashtëzakonshme, dokumenti është i vlefshëm në numrin më të madh të mundshëm të shteteve.

Paragrafi 5

Dokumentit është i vlefshëm minimalisht për tre muaj dhe maksimalisht për dy vjet.

Paragrafi 6

1. Rinovimi ose zgjatja e vlefshmërisë së dokumentit është çështje e autoritetit që e lëshon atë, për sa kohë mbajtësi nuk ka siguruar një qëndrim të ligjshëm në territorin e autoritetit në fjalë. Lëshimi i dokumentit të ri, në të njëjtat kushte, është çështje e autoritetit që ka lëshuar dokumentin e mëparshëm.
2. Autoritetet diplomatike ose konsullore mund të autorizohen të zgjasin, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj, vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit të lëshuar nga shtetet e tyre.
3. Shtetet Kontraktuese konsiderojnë me dashamirësi rinovimin ose zgjatjen e vlefshmërisë së dokumenteve të udhëtimit ose lëshimin e dokumenteve të reja për personat pa shtetësi që nuk janë më me qëndrim të ligjshëm në territorin e tyre, të cilët nuk mund të marrin dokumentet e udhëtimit në vendin ku kanë vendqëndrim të ligjshëm.

Paragrafi 7

Shtetet Kontraktuese njohin vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara në përputhje me dispozitat e nenit 28 të kësaj Konvente.

Paragrafi 8

Autoritetet kompetente të shtetit në të cilin personi pa shtetësi dëshiron të procedojë vendosin, nëse ata janë të përgatitur për ta pranuar atë dhe nëse kërkohet vizë, një vizë në dokumentin që ai mban.

Paragrafi 9

1. Shtetet Kontraktuese ndërmarrin të lëshojnë viza tranzit për personat pa shtetësi që janë pajisur me viza për në territorin e destinacionit përfundimtar.
2. Lëshimi i këtyre vizave mund të refuzohet në rastet kur do të justifikohet refuzimi i dhënies së vizës për një të huaj.

Paragrafi 10

Pagesa për lëshimin e vizave të daljes, hyrjes ose transitit nuk është më e madhe se sa pagesa minimale për vizat në pasaportat e huaja.

Paragrafi 11

Kur një person pa shtetësi ka vendqëndrimin e ligjshëm në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues, përgjegjësia për lëshimin e një dokumenti të ri, sipas parashikimeve dhe kushteve të nenit 28, është e autoritetit kompetent të atij territori në të cilin personi pa shtetësi ka të drejtë të aplikojë.

Paragrafi 12

Autoriteti që lëshon dokumentin e ri tërheq dokumentin e vjetër dhe ia kthen atë vendit që e ka lëshuar, nëse është përcaktuar në dokument që duhet kthyer; në të kundërt ai e tërheq dhe anulon dokumentin.

Paragrafi 13

1. Një dokument udhëtimi i lëshuar sipas nenit 28 të kësaj Konvente, përveç rasteve kur ajo parashikohet ndryshe, i jep të drejtë mbajtësit të rihyjë në çfarëdo kohe në territorin e shtetit që e ka lëshuar, gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj. Në çdo rast, periudha gjatë së cilës mbajtësi mund të kthehet në vendin që e ka lëshuar dokumentin duhet të jetë jo më pak se tre muaj, përveçse kur vendi, të cilit personi pa shtetësi i kërkon të udhëtojë, nuk insiston në dokumentin e udhëtimit në përputhje me të drejtën e rihyrjes.

2. Shteti Kontraktues, subjekt i dispozitave të nënparagrafit paraardhës, mund t'i kërkojë mbajtësit të dokumentit të respektojë këto formalitete siç mund të përcaktohet në lidhje me daljen nga ose kthimin në territorin e tij.

Paragrafi 14

Bazuar vetëm në parashikimet e paragrafit 13, dispozitat e këtij plani, në asnjë mënyrë nuk prekin ligjet dhe rregulloret që përcaktojnë kushtet e pranimi, kalimit transit, qëndrimit dhe vendosjes dhe nisjes nga territoret e Shteteve Kontraktuese.

Paragrafi 15

Statusi i mbajtësit, veçanërisht në lidhje me kombësinë, nuk përcaktohet ose ndikohet nga lëshimi i dokumentit dhe as nga hyrjet e bëra në shtetin në fjalë.

Paragrafi 16

Lëshimi i dokumentit në asnjë mënyrë nuk i jep të drejtë mbajtësit të gëzojë mbrojtjen e autoriteteve diplomatike ose konsullore të vendit që e lëshon dhe nuk i jep ipso facto këtyre autoriteteve të drejtën e mbrojtjes.

MODELI I DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

[nuk është reprodukuar këtu]

SHTOJCA II - 1961 KONVENTA MBI REDUKTIMIN E PASHTETËSISË *

Shtetet Kontraktuese,

Duke vepruar në përputhje me rezolutën 896 (IX), adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 4 dhjetor të vitit 1954;

Duke e konsideruar të dëshirueshme për të reduktuar pashtetësinë me marrëveshje ndërkombëtare,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

NENI 1

1. Një Shtet Kontraktues duhet t'i japë shtetësinë e tij një personi të lindur në territorin e atij shteti, i cili ndryshe mund të jetë pa shtetësi. Kjo shtetësi i jepet:

- (a) me lindjen, nga veprimi i ligjit ose
- (b) në bazë të një aplikimi të paraqitur tek autoritetet përkatëse, nga ose në emër të një personi të interesuar, në mënyrën e parashikuar nga ligji i brendshëm. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, asnjë aplikim i tillë nuk mund të kundërshtohet.

Një Shtet Kontraktues, i cili merr masa për dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me nënparagrafin (b) të këtij paragrafi mundet gjithashtu të sigurojë dhënien e shtetësisë së tij në bazë të ligjit në një moshë të tillë dhe të kushteve të tilla, siç mund të jetë parashikuar nga e drejta e brendshme.

2. Një Shtet Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me nënparagrafin (b) të paragrafit 1 të këtij neni sipas një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

- (a) që aplikimi të jetë paraqitur gjatë një periudhe, të përcaktuar nga Shteti Kontraktues, duke filluar jo më vonë se mosha tetëmbëdhjetë vjeçe dhe duke mbaruar jo më herët se mosha njëzet e një vjeçe, kështu gjithsesi, personi i interesuar do të lejohet së paku një vit, gjatë të cilit ai mund të bëjë vetë aplikimin pa pasur nevojë të marrë autorizimin ligjor për të vepruar kështu;
- (b) që personi në fjalë të ketë banuar vazhdimisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë të tillë siç mund të përcaktohet nga ai shtet, pa kaluar pesë vjet menjëherë para paraqitjes së aplikimit dhe as dhjetë vjet në tërësi;

* Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara, vëll. 360, f. 1177

- (c) që personi i interesuar të mos ketë qenë dënuar për shkelje kundër sigurisë kombëtare dhe as të ketë qenë dënuar me burgim për një periudhë pesëvjeçare ose më shumë për një vepër penale;
- (d) që personi në fjalë të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1(b) dhe 2 të këtij neni, një fëmijë i lindur nga martesë në territorin e një Shteti Kontraktues, nëna e të cilit ka shtetësinë e atij shteti, përfiton në lindje atë shtetësi, nëse prindërshe mund të jetë pa shtetësi.

4. Një Shtet Kontraktues i jep shtetësinë e tij një personi i cili prindërshe mund të jetë pa shtetësi dhe i cili nuk është në gjendje të përfitojë shtetësinë e Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ai ka lindur, sepse ai ka kaluar moshën për të paraqitur aplikimin e tij ose nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara të banimit, nëse shtetësia e njërit prej prindërve të tij në kohën e lindjes së personit ishte ajo e Shtetit Kontraktues të përmendur më lart. Nëse prindërit e tij nuk mbanin të njëjtën shtetësi në kohën e lindjes së tij, çështja, nëse shtetësia e personit në fjalë ndjek atë të babait ose atë të nënës, vendoset nga e drejta e brendshme e këtij Shteti Kontraktues. Nëse kërkohet aplikimi për një shtetësi të tillë, aplikimi bëhet tek autoritetet përkatëse ose në emër të aplikantit në mënyrën e përshkuar nga e drejta e brendshme. Në bazë të dispozitave të paragrafit 5 të këtij neni, një aplikim i tillë nuk refuzohet.

5. Shteti Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

- (a) që aplikimi të jetë paraqitur përpara se kërkuesi të arrijë në moshë, e cila është më pak se njëzet e tre vjeçe, të caktuar nga Shteti Kontraktues;
- (b) që personi i interesuar të ketë banuar zakonisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë të tillë që i paraprin menjëherë paraqitjes së aplikimit, duke mos kaluar tre vjet, siç mund të jetë caktuar nga ai shtet;
- (c) që personi në fjalë të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

NENI 2

Një fëmijë i braktisur, i gjetur në territorin e një Shteti Kontraktues duhet, në mungesë të provave në të kundërt, të konsiderohet se ka lindur brenda atij territori të prindërve që mbajnë shtetësinë e atij shteti.

NENI 3

Për qëllimin e përcaktimit të detyrimeve të Shteteve Kontraktuese sipas kësaj Konvente, lindja në një anije ose në një avion gjykohet se ka ndodhur në territorin e atij Shteti të flamurit të anijes ose në territorin e atij shteti ku është regjistruar avioni, siç mund të jetë rasti.

NENI 4

1. Një Shtet Kontraktues i jep shtetësinë e tij një personi, që nuk ka lindur në territorin e një Shteti Kontraktues i cili ndryshe do të jetë pa shtetësi, nëse shtetësia e njërit prej prindërve të tij në kohën e lindjes së personit ishte e atij shteti. Nëse prindërit e tij nuk kishin të njëjtën shtetësi në kohën e lindjes së tij, çështja, nëse shtetësia e personit të interesuar duhet të ndjekë atë të babait ose atë të nënës, duhet të vendoset nga e drejta e brendshme e këtij Shteti Kontraktues. Shtetësia e dhënë në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi jepet:

- (a) në lindje, nga veprimi i ligjit ose
 - (b) në bazë të një aplikimi të paraqitur tek autoritetet përkatëse, nga ose në emër të vetë personit të interesuar, në mënyrën e parashikuar nga e drejta e brendshme. Bazuar në dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, asnjë aplikim nuk refuzohet.
2. Një Shtet Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:
- (a) që aplikimi të jetë paraqitur përpara se aplikanti të ketë arritur një moshë, që është jo më pak se 23 vjeç, të caktuar nga Shteti Kontraktues;
 - (b) që personi i interesuar të ketë banuar zakonisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë që të mos i kalojë tre vjet që i paraprin menjëherë paraqitjes së aplikimit, siç mund të caktohet nga ai shtet;
 - (c) që personi i interesuar të mos ketë qenë dënuar për një vepër penale kundër sigurisë kombëtare;
 - (d) që personi i interesuar të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

NENI 5

1. Nëse ligji i një Shteti Kontraktues kërkon humbjen e shtetësisë si pasojë e ndonjë ndryshimi në statusin personal të një personi të tillë, si martesë, mbarimi i martesës, legjitimimi, njohja ose adaptimi, një humbje e tillë kushtëzohet nga zotërimi ose fitimi i një shtetësie tjetër.

2. Nëse, sipas ligjit të një Shteti Kontraktues, një fëmijë i lindur jashtë martese humb shtetësinë e atij shteti si pasojë e njohjes së atësisë, atij i jepet një mundësi për ta rifituar atë shtetësi me anë të aplikimit me shkrim drejtuar autoriteteve përkatëse dhe kushtet që rregullojnë këtë aplikim nuk duhet të jenë më rigorozë, sesa ato të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 1 të kësaj Konvente.

NENI 6

Nëse ligji i një Shteti Kontraktues parashikon humbjen e shtetësisë së tij nga bashkëshorti ose fëmijët e një personi, për shkak se ai person e ka humbur ose është privuar nga ajo shtetësi, një humbje e tillë kushtëzohet nga zotërimi ose fitimi i një shtetësie tjetër.

NENI 7

1.(a) Nëse ligji i një Shteti Kontraktues e lejon heqjen dorë nga shtetësia, një veprim i tillë nuk rezulton në humbjen e shtetësisë, nëse personi i interesuar nuk zotëron ose fiton një shtetësi tjetër.

(b) Dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi nuk zbatohen atje ku zbatimi i tyre mund të mospërputhet me parimet e parashikuara në nenet 13 dhe 14 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut e miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

2. Një shtetas i një Shteti Kontraktues, i cili kërkon natyralizimin në një vend të huaj, nuk humb shtetësinë e tij po të mos ketë fituar ose po të mos i jetë dhënë siguria e fitimit të shtetësisë së atij vendi të huaj.

3. Bazuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, një shtetas i një Shteti Kontraktues nuk do ta humbë shtetësinë e tij, për t'u bërë pa shtetësi, për arsye të largimit, banimit jashtë vendit, mosregjistrimit ose për çdo arsye të ngjashme.

4. Një person i natyralizuar mund ta humbë shtetësinë e tij për shkak të banimit jashtë vendit për një periudhë, jo më pak se shtatë vjet rresht, të përcaktuar nga ligji i Shtetit Kontraktues, nëse ai nuk u deklaron autoriteteve përkatëse qëllimin e tij për të ruajtur shtetësinë e tij.

5. Në rastin e një shtetasi të një Shteti Kontraktues, të lindur jashtë territorit të tij, ligji i atij shteti mund të kushtëzojë ruajtjen e shtetësisë së tij, pas skadimit të një viti nga koha kur është bërë madhor me banimin në atë kohë në territorin e shtetit ose regjistrimit tek autoritetet përkatëse.

6. Përveç rrethanave të përmendura në këtë nen, një person nuk humb shtetësinë e një Shteti Kontraktues, nëse një humbje e tillë do ta bëjë atë pa shtetësi, pavarësisht se një humbje e tillë nuk ndalohet shprehimisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Konvente.

NENI 8

1. Një Shtet Kontraktues nuk privon një person nga shtetësia e tij, nëse një privim i tillë do ta bëjë atë pa shtetësi.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një person mund të privohet nga shtetësia e një Shteti Kontraktues:

- (a) në rrethanat në të cilat, sipas paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 7, është e lejueshme që personi ta humbasë shtetësinë e tij;
- (b) atje ku shtetësia është fituar nga keqpërfaqësimi ose mashtrimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një Shtet Kontraktues mund të fitojë të drejtën për të privuar një person nga shtetësia e tij, nëse në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit specifikon ndalimin e një të drejte të tillë në bazë të një ose më shumë prej arsyeve të mëposhtme, arsye të cilat ekzistojnë në ligjin e tij të brendshëm në atë kohë:

- (a) që në mospërputhje me detyrën e tij të besnikërisë ndaj Shtetit Kontraktues, personi:
 - (i) me mospërfillje ndaj një ndalimi të shprehur nga Shteti Kontraktues, ka dhënë ose vazhdon të japë shërbime ndaj, ose ka marrë apo vazhdon të marrë rrogë nga një shtet tjetër;
 - (ii) ka kryer një sjellje në një mënyrë seriozisht të dëmshme ndaj interesave vitale të shtetit;
- (b) që personi ka bërë një betim ose një deklaratë formale për besnikëri ndaj një shteti tjetër ose ka dhënë dëshmi të qartë të vendosmërisë së tij për të refuzuar njohjen e besnikërisë së tij ndaj Shtetit Kontraktues.

4. Një Shtet Kontraktues nuk duhet të ushtrojë funksionin e privimit të lejuar nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, përveçse në përputhje me ligjin, i cili do të sigurojë për personin në fjalë të drejtën për një dëgjim të drejtë nga një gjykatë ose një trup tjetër i pavarur.

NENI 9

Një Shtet Kontraktues nuk mund të privojë një person ose një grup personash prej shtetësisë së tyre për arsye raciale, etnike, fetare ose politike.

NENI 10

1. Çdo traktat ndërmjet Shteteve Kontraktuese që parashikon transferimin e territorit përfshin dispozita të hartuara për të siguruar që asnjë person nuk do të bëhet pa shtetësi si rezultat i transferimit. Një Shtet Kontraktues bën përpjekjet e tij më të mira për të siguruar që çdo traktat i tillë, i bërë prej tij me një shtet, i cili nuk është Palë e kësaj Konvente të përfshijë dispozita të tilla.

2. Në mungesë të dispozitave të tilla një Shtet Kontraktues, të cilit i është transferuar territori ose i cili përndryshe fiton territor do t'ua akordojë shtetësinë e tij personave të tillë të cilët mund të bëhen pa shtetësi si rezultat i transferimit ose i fitimit.

NENI 11

Shtetet Kontraktuese nxisin në kuadrin e Kombeve të Bashkuara, sa më shpejt që mund të jetë e mundur, pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit, krijimin e një

organizmi ku një person që pretendon të përfitojë nga kjo Konventë mund të aplikojë për shqyrtimin e pretendimit të tij dhe për ndihmë për t'ua paraqitur atë autoriteteve përkatëse.

NENI 12

1. Në lidhje me një Shtet Kontraktues, i cili nuk i jep, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 1 ose nenit 4 të kësaj Konvente, shtetësinë e tij në lindje me ligj, dispozitat e paragrafit 1 të nenit 1 ose 4, sipas rastit, zbatohen ndaj personave të lindur para, si dhe personave të lindur pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Dispozitat e paragrafit 4 të nenit 1 të kësaj Konvente zbatohen ndaj personave të lindur para, si edhe personave të lindur pas hyrjes në fuqi të saj.

3. Dispozitat e nenit 2 të kësaj Konvente zbatohen vetëm ndaj fëmijëve të braktisur, të gjetur në territorin e një Shteti Kontraktues pas hyrjes në fuqi të Konventës.

NENI 13

Kjo Konventë nuk interpretohet se ndikon ndaj ndonjë dispozite më ndihmuese ndaj reduktimit të pashtetësisë, e cila mund të përfshihet në të drejtën e brendshme të çdo Shteti Kontraktues, që është ose do të jetë në fuqi, ose që mund të përfshihet në çdo konventë tjetër, traktat ose marrëveshje që është ose do të jetë në fuqi midis dy ose më shumë Shteteve Kontraktuese.

NENI 14

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Kontraktuese lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet me mjete të tjera, i paraqiten Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e çdonjërës prej palëve në mosmarrëveshje.

NENI 15

1. Kjo Konventë zbatohet ndaj të gjitha territoreve jovetëqeverisëse, nën kujdestari, koloniale dhe të tjera territoreve jometropolitane, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një Shtet Kontraktues; Shteti Kontraktues në fjalë, në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, deklaron territorin ose territoret jometropolitane ndaj të cilave Konventa do të zbatohet ipso facto si rezultat i këtij nënshkrimi, ratifikimi ose aderimi.

2. Në çdo rast në të cilin, për qëllim të shtetësisë, një territor jometropolitan nuk trajtohet si i bashkuar me një territor metropolitan, ose në çdo rast në të cilin kërkohet pëlqimi paraprak i një territori jometropolitan nga ligjet ose praktikat kushtetuese të Shtetit Kontraktues ose të territorit jometropolitan për zbatimin e Konventës ndaj atij territori, ai Shtet Kontraktues përpiqet të sigurojë pëlqimin e nevojshëm të territorit jometropolitan brenda periudhës së dymbëdhjetë

muajve nga data e nënshkrimit të Konventës nga ai Shtet Kontraktues dhe, kur një pëlqim i tillë është arritur, Shteti Kontraktues njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Kjo Konventë zbatohet ndaj territorit ose territoreve të përmendura në këtë njoftim nga data e marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Pas skadimit të periudhës dymbëdhjetëmuajore të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, Shtetet Kontraktuese në fjalë informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për rezultatin e këshillimeve në ato territore jometropolitane, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ato janë përgjegjës dhe që pëlqimi i tyre ndaj zbatimit të kësaj Konvente mund të jetë mbajtur i fshehur.

NENI 16

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në selinë qendrore të Kombeve të Bashkuara nga 30 gushti 1961 deri në 31 maj 1962.

2. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në emër të:

- (a) çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara;
- (b) çdo shteti tjetër i ftuar për të ndjekur konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin ose reduktimin e pashtetësisë në të ardhmen;
- (c) çdo shteti, ndaj të cilit mund t'i jetë drejtuar një ftesë për të nënshkruar ose për të aderuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

4. Kjo Konventë është e hapur për aderimin nga shtetet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni. Aderimi kryhet me depozitimin e instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

NENI 17

1. Në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit çdo shtet mund t'u bëjë një rezervë neneve 11, 14 ose 15.

2. Asnjë rezervë tjetër ndaj kësaj Konvente nuk është e pranueshme.

NENI 18

1. Kjo Konventë hyn në fuqi dy vjet pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit, ajo hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit nga një shtet i tillë i instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit ose në datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, cilado është më e vonshme.

NENI 19

1. Çdo Shtet Kontraktues mund ta denoncojë këtë Konventë, në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të adresuar tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Një denoncim i tillë hyn në fuqi për Shtetin Kontraktues në fjalë një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Në rastet ku, në përputhje me dispozitat e nenit 15, kjo Konventë është bërë e zbatueshme në një territor jometropolitan të një Shteti Kontraktues, ai shtet mund në çdo kohë pas kësaj, me pëlqimin e territorit në fjalë, të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara duke e denoncuar këtë Konventë në mënyrë të veçuar në lidhje me atë territor. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili njofton të gjitha Shtetet e tjera Kontraktuese për një njoftim të tillë dhe datën ose marrjen e tij.

NENI 20

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njofton të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare, duke iu referuar nenit 16, për veçoritë e mëposhtme:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 16;
- (b) rezervat sipas nenit 17;
- (c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në zbatim të nenit 18;
- (d) denoncimet sipas nenit 19.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit më së voni, sjell në vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme çështjen e krijimit, në përputhje me nenin 11, të një trupi të tillë siç është përmendur aty.

NENI 21

Kjo Konventë regjistrohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në datën e hyrjes së saj në fuqi.

Në dëshmi nga ku nënshkruesit fuqiplotë kanë nënshkruar këtë Konventë.

Përgatitur në Neë York, më 30 gusht 1961 në një kopje të vetme, prej së cilës tekstet në gjuhën kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike dhe të cilat depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara dhe kopje të verifikuara të të cilave shpërndahen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare të referuara në nenin 16 të kësaj Konvente.

SHTOJCA III - LISTA E SHTETEVE PALË TË KONVENTËS SË VITIT 1954 LIDHUR ME STATUSIN E PERSONAVE PA SHTETËSI DHE TË KONVENTËS SË VITIT 1961 MBI REDUKTIMIN E PASHTETËSISË

Vendi	Konventa e vitit 1954*	Konventa e vitit 1961 *
Shqipëria	23 Qershor 2003 a	9 Korrik 2003 a
Algjeria	15 Korrik 1964 a	
Antigua dhe Barbuda	25 Tetor 1988 d	
Argjentina	1 Qershor 1972 a	
Armenia	18 Maj 1994 a	18 Maj 1994 a
Australia	13 Dhjetor 1973 a	13 Dhjetor 1973 a
Austria	8 Shkurt 2008 a	22 Shtator 1972 a
Azerbajxhani	16 Gusht 1996 a	16 Gusht 1996 a
Barbados	6 Mars 1972 d	
Belgjika	27 Maj 1960 r	
Belize	14 Shtator 2006 a	
Benini	8 Dhjetor 2011 a	8 Dhjetor 2011 a
Bolivia (Shteti shumëkombëtar i)	6 Tetor 1983 a	6 Tetor 1983 a
Bosnjë dhe Hercegovinë	1 Shtator 1993 d	13 Dhjetor 1996 a
Botsvana	25 Shkurt 1969 d	
Brazili	13 Gusht 1996 r	25 Tetor 2007 a
Bullgaria	22 Mars 2012 a	22 Mars 2012 a
Burkina Faso	1 Maj 2012 a	
Kanada		17 Korrik 1978 a
Çadi	12 Gusht 1999 a	12 Gusht 1999 a
Kina†		
Kosta Rika	2 Nëntor 1977 r	2 Nëntor 1977 a
Bregu i Fildishtë	3 Tetor 2013 a	3 Tetor 2013 a
Kroacia	12 Tetor 1992 d	22 Shtator 2011 a
Republika Çeke	19 Korrik 2004 a	19 Dhjetor 2001 a

* Aderim (a), Suksesion (d), Ratifikim (r)

† Me rifillimin e ushtrimit të sovranitetit mbi Hong Kongun, më 10 qershor 1997 Kina njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm se përgjegjësia për të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare të Hong Kongut në lidhje me Konventën e 1954-ës do të merret përsipër nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës.

Vendi	Konventa e vitit 1954	Konventa e vitit 1961
Danimarka	17 Janar 1956 r	11 Korrik 1977 a
Ekuadori	2 Tetor 1970 r	24 Shtator 2012 a
Fixhi	12 Qershor 1972 d	
Finlanda	10 Tetor 1968 a	7 Gusht 2008 a
Franca	8 Mars 1960 r	
Gjeorgjia	23 Dhjetor 2011 a	
Gjermania	26 Tetor 1976 r	31 Gusht 1977 a
Greqia	4 Nëntor 1975 a	
Guatemala	28 Nëntor 2000 r	19 Korrik 2001 a
Guinea	21 Mars 1962 a	
Hondurasi	1 Tetor 2012 r	18 Dhjetor 2012 a
Hungaria	21 Nëntor 2001 a	12 Maj 2009 a
Irlanda	17 Dhjetor 1962 a	18 Janar 1973 a
Izraeli	23 Dhjetor 1958 r	
Xhamajka		9 Janar 2013 a
Italia	3 Dhjetor 1962 r	
Kiribati	29 Nëntor 1983 d	29 Nëntor 1983 d
Letonia	5 Nëntor 1999 a	14 Prill 1992 a
Lesoto	4 Nëntor 1974 d	24 Shtator 2004 a
Liberia	11 Shtator 1964 a	22 Shtator 2004 a
Libia	16 Maj 1989 a	16 Maj 1989 a
Lihtenshtajni	25 Shtator 2009 r	25 Shtator 2009 a
Lituania	7 Shkurt 2000 a	22 Korrik 2013 a
Luksemburgu	27 Qershor 1960 r	
Madagaskar ^{‡117}	[20 Shkurt 1962 a]	
Malavi	7 Tetor 2009 a	
Meksika	7 Qershor 2000 a	
Mali i Zi	23 Tetor 2006 d	5 Dhjetor 2013 a
Holanda	12 Prill 1962 r	13 Maj 1985 r
Zelanda e Re		20 Shtator 2006 a
Nikaragua	15 Korrik 2013 a	29 Korrik 2013 a
Niger		17 Qershor 1985 a
Nigeria	20 Shtator 2011 a	20 Shtator 2011 a
Norvegjia	19 Nëntor 1956 r	11 Gusht 1971 a
Panamaja	2 Qershor 2011 a	2 Qershor 2011 a
Paraguaj		6 Qershor 2012 a
Peruja	23 Janar 2014 a	
Filipinet	22 Shtator 2011 r	
Portugalia	1 Tetor 2012 a	1 Tetor 2012 a

‡ Me një njoftim të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm më 2 prill 1965, Qeveria e Madagaskarit denoncoi Konventën; denoncimi hyri në fuqi më 2 prill 1966.

Vendi	Konventa e vitit 1954	Konventa e vitit 1961
Republika e Koresë	22 Gusht 1962 a	
Republika e Moldavisë	19 Prill 2012 a	19 Prill 2012 a
Rumania	27 Janar 2006 a	27 Janar 2006 a
Ruanda	4 Tetor 2006 a	4 Tetor 2006 a
Senegali	21 Shtator 2005 a	21 Shtator 2005 a
Serbia	12 Mars 2001 d	7 Dhjetor 2011 a
Sllovakia	3 Prill 2000 a	3 Prill 2000 a
Sllovenia	6 Korrik 1992 d	
Spanja	12 Maj 1997 a	
Shën Vincenti dhe Grenadinet	27 Prill 1999 d	
Svaziland	16 Nëntor 1999 a	16 Nëntor 1999 a
Suedia	2 Prill 1965 r	19 Shkurt 1969 a
Zvicra	3 Korrik 1972 r	
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	18 Janar 1994 d	
Trinidad dhe Tobago	11 Prill 1966 d	
Tunizia	29 Korrik 1969 a	12 Maj 2000 a
Turkmenistani	7 Dhjetor 2011 a	29 Gusht 2012 a
Uganda	15 Prill 1965 a	
Ukraina	25 Mars 2013 a	25 Mars 2013 a
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	16 Prill 1959 r	29 Mars 1966 r
Uruguai	2 Prill 2004 a	21 Shtator 2001 a
Zambia	1 Nëntor 1974 d	
Zimbabve	1 Dhjetor 1998 d	

SHTOJCA IV - FRAGMENTE NGA REZOLUTAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 23 dhjetor 1994 A/RES/49/169, 24 shkurt 1995

49/169, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Asambleja e Përgjithshme,...

20. U bën thirrje shteteve të ndihmojnë Komisioneren e Lartë për të përmbushur përgjegjësitë e saj, sipas rezolutës 3274 (XXIX) të Asamblesë së Përgjithshme të 10 dhjetorit 1974, në lidhje me reduktimin e pashtetësisë, duke përfshirë nxitjen e aderimeve dhe zbatimin e plotë të instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me pashtetësinë;

Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 21 dhjetor 1995

A/RES/50/152, 9 shkurt 1996

50/152, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Asambleja e Përgjithshme,

...

Me shqetësimin se pashtetësia, duke përfshirë pamundësinë për të përcaktuar shtetësinë e dikujt, mund të rezultojë në zhvendosje, dhe duke theksuar, në këtë drejtim, se parandalimi dhe reduktimi i pashtetësisë dhe mbrojtja e personave pa shtetësi janë gjithashtu të rëndësishme në parandalimin e situatave të mundshme të refugjatëve,

...

14. Inkurajon Komisioneren e Lartë të vazhdojë aktivitetet e saj në emër të personave pa shtetësi, si pjesë e funksionit të saj ligjor për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare dhe për të kërkuar veprime parandaluese, si dhe përgjegjësitë e saj sipas rezolutës 3274 (XXIV) të Asamblesë së Përgjithshme të 10 dhjetorit 1974 dhe 31/ 36 të 30 nëntorit 1976;

15. I kërkon Zyrës së Komisionerit të Lartë, duke pasur parasysh numrin e kufizuar të shteteve palë në këto instrumente, të promovojë në mënyrë aktive aderimin në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi¹ dhe Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë,² si dhe të ofrojë shërbime teknike dhe këshillimore përkatëse në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit të shtetësisë për shtetet e interesuara; ...

¹ Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vëll.360, Nr.5158.

² Po aty., vëllimi 989, nr. 14458.

Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 19 dhjetor 2006

A/RES/61/137, 25 janar 2007

61/137. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Asambleja e Përgjithshme,...

2. Mirëpret punën e rëndësishme të ndërmarrë nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe Komiteti Ekzekutiv i saj gjatë vitit, dhe vë në dukje në këtë kontekst miratimin e konkluzionit për gratë dhe vajzat në rrezik dhe konkluzionin për identifikimin, parandalimin dhe zvogëlimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi,³ të cilat synojnë forcimin e regjimit të mbrojtjes ndërkombëtare, në përputhje me Agjendën për Mbrojtje,⁴ dhe në asistimin e qeverive në përmbushjen e përgjegjësisë së tyre për mbrojtjen në mjedisin e sotëm ndërkombëtar në ndryshim, duke përfshirë promovimin e zbatimit progresiv të mekanizmave dhe standardeve përmes politikave përkatëse publike kombëtare të mbështetura nga komuniteti ndërkombëtar;...

4. Vë në dukje se gjashtëdhjetë e dy shtete janë tani palë në Konventën e 1954-ës në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi dhe se tridhjetë e tre shtete janë palë në Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë,⁵ inkurajon shtetet që nuk e kanë bërë këtë të marrin parasysh aderimin në këto instrumente, vë në dukje punën e Komisionerit të Lartë në lidhje me identifikimin e personave pa shtetësi,⁶ parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, dhe i kërkon Zyrës së Komisionerit të Lartë të vazhdojë të punojë në këtë fushë në pajtim me rezolutat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme dhe konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv;...

³ Po aty., kap. III, seksionet A dhe B.

⁴ Po aty., *Sesioni i pesëdhjetë e shtatë, Shtojca nr. 12A (A/57/12/Add.1)*, Shtojca IV.

⁵ Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vëll. 360, nr. 5158.

⁶ Po aty., vëll. 989, nr. 14458.

SHTOJCA V - FRAGMENTE NGA KONKLUZIONET E KOMITETIT EKZEKUTIV TË UNHCR-së

**Konkluzion për parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe
mbrojtjen e personave pa shtetësi**

Nr. 78 (XLVI) – 1995

20 tetor 1995

Komiteti Ekzekutiv,

Duke njohur të drejtën e secilit për një shtetësi dhe të drejtën për të mos u privuar arbitrarisht nga shtetësia e tij,

Me shqetësimin se pashtetësia, duke përfshirë pamundësinë për të përcaktuar shtetësinë e dikujt, mund të rezultojë në zhvendosje,

Duke theksuar se parandalimi dhe reduktimi i pashtetësisë dhe mbrojtja e personave pa shtetësi janë të rëndësishme në parandalimin e situatave të mundshme të refugjatëve,

(a) *njeh* përgjegjësitë që i janë besuar tashmë Komisionerit të Lartë për refugjatët pa shtetësi dhe në lidhje me reduktimin e pashtetësisë, dhe inkurajon UNHCR-në që të vazhdojë aktivitetet e saj në emër të personave pa shtetësi, si pjesë e funksionit të saj ligjor për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare dhe për të kërkuar veprime parandaluese, si dhe përgjegjësinë e saj të besuar nga Asambleja e Përgjithshme për të ndërmarrë funksionet e parashikuara në nenin 11 të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë;...

(c) Kërkon nga UNHCR-ja të promovojë në mënyrë aktive aderimin në Konventën e 1954-ës në lidhje me statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë, duke pasur parasysh numrin e kufizuar të shteteve palë në këto instrumente, si dhe të ofrojë shërbime teknike dhe këshillimore përkatëse që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit të shtetësisë për shtetet e interesuara;...

Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare

Nr. 95 (LIV) – 2003

10 tetor 2003

Komiteti Ekzekutiv, ...

(v) Inkurajon shtetet të bashkëpunojnë me UNHCR-në për metodat për zgjidhjen e rasteve të pashtetësisë dhe të marrin në konsideratë mundësinë e sigurimit të vendeve të rivendosjes ku situata e një personi pa shtetësi nuk mund të zgjidhet në vendin pritës aktual ose në një vend tjetër të banimit të mëparshëm të zakonshëm dhe mbetet e pasigurt;

Konkluzioni për identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi

Nr. 106 (LVII) – 2006

6 tetor 2006

Komiteti Ekzekutiv,

Duke mbetur thellësisht të shqetësuar me vazhdimësinë e problemeve të pashtetësisë në rajone të ndryshme të botës dhe shfaqjen e situatave të reja të pashtetësisë,...

Duke ripohuar përgjegjësitë e dhëna Komisionerit të Lartë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të kontribuar në parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe për të çuar më tej mbrojtjen e personave pa shtetësi,

Duke kujtuar Konkluzionin e tij nr. 78 (XLVI) për parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, si dhe Konkluzionet 90 (LII), 95 (LIV), 96 (LIV), dhe Konkluzionet 99 (LV) dhe 102 (LVI) në lidhje me zgjidhjen e situatave të zgjatura të pashtetësisë,

- (a) *I bën thirrje* UNHCR-së, në bashkëpunim me qeveritë, orgaizatat tjera të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe rajonale dhe joqeveritare përkatëse, të forcojë përpjekjet e saj në këtë fushë duke ndjekur aktivitete të shënjestruara për të mbështetur identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe për të shtyrë përpara mbrojtjen e personave pa shtetësi;

Identifikimi i pashtetësisë

- (b) *I bën thirrje* UNHCR-së të vazhdojë të punojë me qeveritë e interesuara për t'u angazhuar ose për të ripërtërirë përpjekjet për identifikimin e popullatave pa shtetësi dhe popullatave me shtetësi të pacaktuar që banojnë në territorin e tyre, në bashkëpunim me agjencitë e tjera të

Kombeve të Bashkuara, në veçanti UNICEF-in dhe UNFPA si dhe DPA, OHCHR dhe UNDP brenda kuadrit të programeve kombëtare, të cilat mund të përfshijnë, sipas rastit, procese të lidhura me regjistrimin e lindjeve dhe përditësimin e të dhënave të popullsisë;

- (c) *Inkurajon UNHCR-në të ndërmarrë dhe të shkëmbejë kërkime, veçanërisht në rajonet ku bëhen pak kërkime mbi pashtetësinë, me institucionet përkatëse akademike ose ekspertët dhe qeveritë, në mënyrë që të nxitet një kuptim më i madh i natyrës dhe fushës së problemit të pashtetësisë, për të identifikuar popullatat pa shtetësi dhe për të kuptuar arsyet që çuan në pashtetësinë, të cilat të gjitha do të shërbenin si bazë për hartimin e strategjive për trajtimin e problemit;*
- (d) *Inkurajon ato shtete që posedojnë statistika mbi personat pa shtetësi ose individët me shtetësi të pacaktuar që t'i ndajnë ato statistika me UNHCR-në dhe i bën thirrje UNHCR-së të krijojë një metodologji më formale, sistematike për mbledhjen, përditësimin dhe ndarjen e informacionit;*
- (e) *Inkurajon UNHCR-në të përfshijë në raportet e saj dyvjeçare mbi aktivitetet që lidhen me personat pa shtetësi drejtuar Komitetit Ekzekutiv, statistikën e ofruara nga shtetet dhe kërkimet e ndërmarra nga institucionet akademike dhe ekspertët, shoqëria civile dhe stafi i saj në terren për përmasat e pashtetësisë;*
- (f) *Inkurajon UNHCR-në të vazhdojë të ofrojë këshilla teknike dhe mbështetje operationale për shtetet, dhe të promovojë të kuptuarit e problemit të pashtetësisë, duke shërbyer gjithashtu për të lehtësuar dialogun ndërmjet shteteve të interesuara në nivel global dhe rajonal;*
- (g) *Merr parasysh bashkëpunimin e krijuar me Unionin Ndërparlamentar (IPU) në fushën e shtetësisë dhe pashtetësisë, dhe vë në dukje Doracakun e Shtetësisë dhe Pashtetësisë për Parlamentarët të vitit 2005, i cili po përdoret në parlamentet kombëtare dhe rajonale për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërtimin e kapaciteteve ndërmjet administratave shtetërore dhe shoqërisë civile; ...*

Mbrojtja e personave pa shtetësi

- (s) *Inkurajon shtetet që të marrin parasysh aderimin në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi dhe, në lidhje me Shtetet Palë, të marrin në konsideratë heqjen e rezervave;*
- (t) *Kërkon nga UNHCR-ja të shpërndajë në mënyrë aktive informacionin dhe, kur është e përshtatshme, të trajnojë homologët qeveritarë për mekanizmat e duhur për identifikimin, regjistrimin dhe dhënien e një statusi personave pa shtetësi;*

- (u) *Inkurajon* shtetet që nuk janë ende palë në Konventën e 1954-ës në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi që t'i trajtojnë personat pa shtetësi që banojnë ligjërisht në territorin e tyre në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut; dhe të marrin në konsideratë, sipas rastit, lehtësimin e natyralizimit të personave pa shtetësi me banim të zakonshëm dhe të ligjshëm në përputhje me legjislacionin kombëtar;
- (v) *Inkurajon* UNHCR-në të zbatojë programe, me kërkesë të shteteve të interesuara, të cilat kontribuojnë në mbrojtjen dhe ndihmën e personave pa shtetësi, veçanërisht duke ndihmuar personat pa shtetësi që të kenë qasje në mjete juridike për të korrigjuar situatën e tyre të pa shtetësisë dhe në këtë kontekst, të punojnë me OJQ-të në ofrimin e këshillimit ligjor dhe ndihmës tjetër sipas nevojës;
- (w) *U bën thirrje* shteteve që të mos ndalojnë personat pa shtetësi vetëm në bazë të të qenit pa shtetësi dhe t'i trajtojnë ata në përputhje me ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe gjithashtu u bën thirrje Shteteve Palë të Konventës së 1954-ës në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi që të zbatojnë plotësisht dispozitat e saj;
- (x) *I kërkon* UNHCR-së të përmirësojë më tej trajnimin e personelit të vet dhe të agjencive të tjera të Kombeve të Bashkuara për çështjet që kanë të bëjnë me pashtetësinë, për t'i mundësuar UNHCR-së t'u japë këshilla teknike Shteteve Palë për zbatimin e Konventës së 1954-ës në mënyrë që të sigurohet zbatimi i qëndrueshëm i dispozitave të saj.

INDEKSI

Numrat i referohen paragrafëve. [renditja alfabetike sipas versionit original në anglisht]

A

të drejtat e fituara, 149

Komiteti Ad Hoc për Pashtetësinë dhe Problemet e Ndërlidhura, 125, 135

Pranimi/ripranimi, 20, 160

- në një shtet tjetër, 117

- në shtetin e shtetësisë së mëparshme, 161

fitim/rifitim i shtetësisë, shih shtetësia,

fitim/rifitim i masave administrative.

- e drejta për, 129

birësim, 18, 92

mosha, 102, 118, 121

Procedurat e ankimit/shqyrtimit, 23, 47-49, 76, 77

- e drejta e ankimit, 71, 76

azilkërkuesit, 66, 79, 112, 114, 132, 145

autoritetet, shih gjithashtu autoritetet kompetente

- konsullore, roli i, 28, 39, 40

- të huaja, pyetjet të dhe përgjigjet nga, 96-99

B

nevojat bazë, 146

prezumimi si i besueshëm, 106

interesat më të mira të fëmijës, shih fëmija/fëmijët

certifikata e lindjes, 84, 121, 155

barra e provës, 89, 90

C

certifikatë

- lindje, 84, 121, 155

- e naturalizimit, 84

- e heqjes dorë nga shtetësia, 84

fëmija/fëmijët, 31, 39, 71, 113

- interesat më të mira të, 119

- person në ngarkim, 71

- drejta e çdo, për nënshtetësi, 122

- i pashoqëruar apo i ndarë, 71, 119

- *Udhëzues i UNHCR-së për përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijës*, 119 nënshtetësia, 33, 34, shih gjithashtu jo-nënshtetësia

të drejtat civile, ekonomike, sociale dhe kulturore, 129, 157

regjistri civil, 84

konfidencialiteti, 66, 79, 129

autoritetet kompetente

- Pyetjet te, 41
- identifikimi, 27-30
- trajtimi jo konsistent nga, 42-44
- vlerësimi i shtetësisë në mungesë të provave për pozicionin e, 38
- në mënyrat automatike të fitimit ose humbjes së shtetësisë, 34-36
- në mënyrat jo automatike të fitimit dhe tërheqjes së shtetësisë, 3 1-33 ndihma/mbrojtja konsullore, 7, 40, 123, 167

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të

Diskriminimit kundër Grave (1979), 55, 122

Konventa për Reduktimin e Pashtetësisë (1961), 3, 4, 161,

Shtojca II lista e shteteve palë, Shtojca III Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006), 120

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989), 122

Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve (1951), 2, 4, 6, 12, 15, 52, 78, 82, 125-128, 130, 132, 135, 145

- statusi i refugjatëve dhe personave pa shtetësi, paralelet ndërmjet, 125, 127, 128
- *Travaux Préparatoires*, 14, 125

Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi (1954), 5, 6,

Shtojca I lista e shteteve palë, Shtojca III shtetet jokontraktuese, 122-124, 166

- personat pa shtetësi në vendet që nuk janë të detyruara nga ky traktat, 122, 166-168
- objekti dhe qëllimi i traktatit, 14, 5 1, 56, 9 1, 135, 147, 157

vendi i origjinës, 79, 80, 101,

gjykatat, 6, 49, 133, 137

- e drejta e qasjes në, 129

besueshmëria, 101-107

krimi

- jopolitike, 111
- kundër paqes, 111
- kundër njerëzimit, 112
- lufta, 112

D

persona pa shtetësi / pashtetësia *de facto* 7, 8, 12, 123, 124, 167, 168

persona pa shtetësi *de jure*, 7

ndalimi, 112-115, 124

- arbitrar, 112, 122, 141, 146, 166

procedurat e përcaktimit, pashtetësia

- qasja në, 68-70
- kërkesat e konfidencialitetit, 79
- përcaktime të kordinuara të statusit të refugjatit dhe pashtetësisë, 78-82
- çështjet e besueshmërisë, shih besueshmëria
- projektimi dhe vendndodhja e, 62-67
- prova, shih prova
- përcaktimi grupor, 108-111
- individët në pritje të përcaktimit të pashtetësisë, 12, 16, 114, 132, 137, 144-146
- individët në "vendin e vet", 164, 165

- intervistë(at), 63, 71, 73, 80, 84, 100, 104, 105, 119, 121
- garancitë/masat mbrojtëse procedurale, shih garancitë/masat mbrojtëse procedurale
- e drejta për t'u dëgjuar, 71
- të drejtat në një shkallë graduale, të kushtëzuar, 134, 135, 137
- kur nuk zbatohet Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, 122, 123

mbrojtja diplomatike, 7, 13, 54, 123, 167

me aftësi të kufizuara, personat me, 120

diskriminimi, 104, 120, 121

- në bazë të mungesës së statusit të shtetësisë, 140
- kundër një grupi të caktuar, 37
- racore, 55, 164
- grave, 55, 121, 122

praktikat diskriminuese, 103

trajtimi diskriminues, 164

dinjiteti, 52, 146, 157

E

arsimi, 102, 121, 129, 133

punësim, e drejta për, 127, 129

- vetëpunësimi, 134, 145
- fitimprurëse, 129
- me rrogë, 129, 146

me gabim ose keqbesim, shtetësia e fituar në, 45, 46

grupi etnik, 49, 52

identiteti etnik, 102

përkatësia etnike, 103

prova

- vlerësimi i, 83-107
- autoritetet kompetente, që vlerësojnë shtetësinë në mungesë të provave për pozicionin e, 38
- të autoriteteve kompetente në mënyrat automatike të fitimit ose humbjes së shtetësisë, duke vlerësuar, 34-36
- të autoriteteve kompetente në mënyrat joautomatike të fitimit dhe tërheqjes së shtetësisë, duke vlerësuar, 31-33
- pasaporta, 36, 38, 40, 42, 44, 95
- llojet e, 83-86

përgjashtimi, 111

Komiteti Ekzekutiv, UNHCR

- Konkluzioni 44 (XXXVII) i vitit 1986 mbi ndalimin e refugjatëve dhe azilkërkesve, 112
- Konkluzioni 96 për kthimin e personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, 161
- Konkluzioni 103 (LVI) i vitit 2005 mbi format plotësuese të mbrojtjes, 15, 79
- Konkluzioni 106 (LV1) i vitit 2006 për identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, 112
- Konkluzionet e miratuara nga Komiteti Ekzekutiv për Mbrojtjen Ndërkombëtare të Refugjatëve, 1975-2009, 8

dëbimi, 129

- i një migranti të parregullt, 112
- urdhër, 135
- mbrojtja kundër, 72, 127, 134, 145

F

familja

- jeta, 149
- lidhjet, 163
- anëtarë(t), 71, 101
- uniteti, 151
- ndërhyrje të paligjshme ose arbitrare në, 163

mashttrim ose gabim në fitimin e shtetësisë, 46

mashtroese

- marrja e dokumenteve, 46
- aplikimi, 45
- dokumentimi, 112
- pasaporta, 95
- liria e lëvizjes, 129, 134, 135, 145

G

gjinore, 118

Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme

- 31/36 e vitit 1976, 4
- 3274 (XXIX) e vitit 1974, 4
- Rezoluta 50/152 e vitit 1995, 4
- Rezoluta 61/137 e vitit 2006, 4, 116

H

banimi i zakonshëm, 1, 18, 58, 81, 84, 92, 139, 152, 154, 157, 158, 162

Konventa e Hagës për çështje të caktuara që lidhen me konfliktin e ligjeve të shtetësisë (1930), 23

kujdesi shëndetësor, e drejta për qasje në, 150

shteti pritës, 126

strehimi, 129, 136

të drejtat e njeriut

- ligji, ndërkombëtar, 11, 122, 140
- detyrimet, ndërkombëtare, 53
- mbrojtje, 52
- të personave pa shtetësi, 9, 11, 14, 51
- traktatet, 6, 55, 131, 141, 143, 151
- traktate, ndalimet në, 55

Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara, 1, 58, 112, 135

I

dokumente identifikimi, 38, 40, 44, 57, 84, 112, 120, 121

e identitetit

-kartat, 44, 84

- dokumentet, 129, 133, 143, 145, 166

dokumentet e imigracionit, 84

pasiguria, 147, shih edhe siguria

Standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, 136

Konventa Ndërkombëtare për Gjendjen Civile, 57

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), 1, 6, 58, 112

e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shih të drejtat e njeriut

Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare, 13

- Nenet mbi Mbrojtjen Diplomatike me komente, 13

- Nenet mbi Shtetësinë e Personave Fizik në lidhje me Suksesionin e Shteteve, 34

mbrojtja ndërkombëtare, 15, 78, 157, 161

përkthyes, 119

- të së njëjtës gjini, 121

intervistues, 119, 121

intervista/t, 63, 71-73, 80, 83, 84, 100, 104, 105, 119

- e drejta për një [intervistë] individuale, 73

- me një zyrtar vendimmarrës, të drejtën për një, 71

migrimi i parregullt, kriminalizimin e, 111

J

shqyrtimi gjyqësor, 77, 112, shih gjithashtu procedurat e apelit/shqyrtimit

jurisdiksioni, 8, 12, 52, 53, 85, 132, 133, 145

jurisprudenca e gjykatave kombëtare, 6

jus sanguinis, 35

jus soli, 35

L

e punës, 129, 136

ligji(et)

- ndërkombëtare, 7, 9, 12, 17, 19-21, 52, 55, 56, 124, 161

- të drejtat ndërkombëtare të njeriut, shih edhe të drejtat e njeriut

- "ligji", kuptimi i, 22

- kombëtare, 135, 140, 164

ligjërish në, 132, 134, 135, 143, 145

me qëndrim të ligjshëm, 132, 136, 137, 150

- "Qëndrim në mënyrë të ligjshme" – Një shënim mbi interpretimin, 135, 137

përfaqësues ligjorë, 119

banimi afatgjatë, 1, 58, 142, 163, 164

M

margjinalizimi, 11
martesë, 18, 92
- certifikatë, 84
- për një të huaj, 55
elemente materiale, 107
mjekësore, shih edhe kujdesi shëndetësor
- certifikata/regjistra, 84
anëtarësimin
- të një grupi fetar, gjuhësor ose etnik, 52
migrantë, 111
migrator
- konteksti, individët në, 12, 58, 108, 117, 144-163
- lëvizje, të përziera 10
- situata, 1
dëshmi të shërbimit ushtarak, 84
Konventa e Montevideos për të drejtat dhe detyrat e shteteve (1933), 19

N

e drejta kombëtare, 135, 140, 164
shtetësia
- fitimi/rifitimi i, 44, 117, 155, 156, 159-161
- fituar me gabim ose keqbesim, 45, 46
- mënyrat automatike dhe joautomatike të fitimit ose tërheqjes së, 25, 26, 3 1-37
- koncepti i, 52-56
- privimi i, 25, 50, 55, 158-160
- arbitrarë, 164
- ligjet, 1, 23, 24, 29, 52, 6 1, 83, 86, 102, 116, 149, 158, 164
- humbja e, 44, 5 1, 55, 158-160
- heqja dorë nga, 25, 50,
shih gjithashtu heqje dorë vullnetare
- e drejta e opsionit për të fituar, 155
- e drejta në, 58-6 1, 161
- tërheqja e, 44, 5 1, 55, 56
- heqje dorë vullnetare nga, shih heqje dorë vullnetare
- fituar me gabim ose keqbesim, 45
- procedurat e verifikimit, 60, 61
natyralizimi, certifikata e, 84
jo nënshtetësia, 33, 137, shih edhe nënshtetësia
moskthimi, 127, 128
aktorë joshtetërorë, 86

P

prejardhjes, dëshmi e, 35
pasaportë, 38, 40, 42, 44, 57, 95-99, 155, shih edhe provat
dënimet për hyrje të paligjshme, 127
persekutimi, frika e bazuar nga, 52, 57, 8 1, 9 1, 96
prima facie, statusi i pashtetësisë, 109, 110

privatësi, 163
masat mbrojtëse /garancitë procedurale 68, 71-77, 143
- grupe specifike, shtesë, 118, 119
dëshmia e
- shtetësisë, 44, 84
- nga prejardhja, 35
- vendi i lindjes, 35
të drejta pronësore, 129
proporcionaliteti, 112, 113, 149
rendi publik, 112
ndihmë publike, 129, 136

R

raca, 53, 55
- kthimi, shih mos kthimi
refugjat
- përkufizimi, 52, 91
- Doracak dhe udhëzime për procedurat dhe kriteret për përcaktimin e statusit të refugjatit, 8
1, 9 1, 100, 107, 151
ligji për refugjatët, ndërkombëtar, 12
fe/fetar, 52, 53, 103, 121, 133
heqje dorë, shih shtetësia, heqje dorë nga, 84
banimi, shih edhe vendbanimi i zakonshëm
- lejet, 84, 135, 137, 139, 147-150, 154, 159, 160, 163, 168
- e drejta për të, 147-152
kthimi
- në shtetin e shtetësisë, 7, 123
- në vendin e tyre të shtetësisë, 123
rishikimi, shih procedurat e apelimit/rishikimit
e drejta
- për të qenë në një vend, 57
- civile, ekonomike, sociale dhe kulturore, 129, 157
- e hyrjes/për të hyrë në vendin e vet, 142, 161
- e hyrjes, rihyrjes dhe qëndrimit në territorin e shtetit, 53
- për lirinë dhe sigurinë e personit, 112
- për të qëndruar, 142, 147
- për të qëndruar në “vendin e vet”, 12, 164, 166 sundimi i ligjit, 47, 49

S

siguria, 52, 112, 157, shih edhe pasiguria
vetëvendosje, e drejta për, 13, 19, 145
ndihmë sociale, e drejta për qasje, 150
sigurime shoqërore, 129, 136
standardi i provës, 9 1-93
standardi/et e trajtimit, 3, 8, 128-130, 144, 145

shteti

- "Shteti", çfarë është, 19-21
- "nga asnjë shtet", 18-21

person pa shtetësi / pashtetësia,

përkufizim, 7, 8, 13, 14-22, 24, 28, 39, 45, 47, 50-54, 56, 88, 109, 111

dëshmi gojore nën betim, 84

T

dokumente udhëtimi, 84, 112, 129, 143, 166

- e drejta për, 136, 150, 160

territor

- lindja nën, 18, 26, 34, 54, 92, 161
- prania në, 132, 133, 137, 145

U

fëmijë të pashoqëruar, shih fëmijë/fëmijët

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

- *Takimi i ekspertëve – Koncepti i personave pa shtetësi sipas të drejtës ndërkombëtare ("Konkluzionet e Prato")*, 4, 74, 112
- Komiteti Ekzekutiv, shih Komiteti Ekzekutiv
- mandati, 4, 29, 116
- përgjegjësitë e, 4
- roli, 116

Kombet e Bashkuara

- Komiteti Ad Hoc për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi, 135
- Komiteti Ad Hoc për Pashtetësinë dhe Problemet e Ndërlidhura, 125, 135
- Komisioneri i Lartë për Refugjatët, 111
- Komiteti i të Drejtave të Njeriut, 1, 58, 112, 135
- Vendimet e Komitetit të të Drejtave të Njeriut në van Alpen kundër Holandës, 112
- Këshilli i Sigurimit, *Sundimi i Ligjit dhe Drejtësia Tranzicionale në Shoqëritë e Konfliktëve dhe Postkonfliktëve: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, 47

Raportuesi Special për të drejtat e joqytetarëve, 140

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 14, 164

Grupi Punues për Ndalimin Arbitrar, 111, 112

V

Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969), 14

heqja dorë vullnetare nga shtetësia, 5 1, 158-162

grupet e cenueshme, 3, 140

W

krimet e luftës, 112

mirëqenia, 129

gra, 121

- azilkërkues, shih azilkërkuesit
 - e drejta e, për të drejta/trajtim të barabartë 55, 122
- punë, e drejta për, 136, 150, 160



UNHCR
The UN Refugee Agency

© 2014 UNHCR.

Të gjitha të drejtat janë të
rezervuara për të gjitha vendet.